



**Save the Children**

# **ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS NË SHQIPËRI**

*Studim Analitik*

Botimi i këtij dokumenti u mundësua nga Save the Children.

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre dhe i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

TIRANË, 2013

Ky dokument publikohet në kuadër të projektit “Promovimi i Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri” të organizatës Save the Children të zbatuar në marrëveshje dhe bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit për zhvillim politikash dhe praktikash arsimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy institucioneve si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij publikimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.



**Save the Children**

# **ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS NË SHQIPËRI**

***Studim Analitik***

## Synopsis

---

<b>Projekti</b>	“Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara”
<b>Organizata zbatuese</b>	Save the Children
<b>Titulli i dokumentit</b>	ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS NË SHQIPËRI – Studim Analitik
<b>Lloji i dokumentit</b>	Studim mbi praninë, përfshirjen dhe mësimnxënien e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri.
<b>Përgatiti</b>	Oneda Çuko Menaxhere Florian Kulla Specialist Koordinoi Ema Kasapi
<b>Data</b>	Nëntor 2012

## Falënderime

---

Ky studim analitik nuk do të ishte bërë i mundur pa përkushtimin, këshillat dhe mbështetjen e shumë kolegëve dhe partnerëve.

Së pari, dëshirojmë t'i shprehim falënderime të veçanta grupit konsultues të studimit, znj. Pranvera Kamani, z. Fatmir Vejsiu dhe z. Robert Gjedia, për kohën, kritikën konstruktive, diskutimet dhe mbështetjen në dizenjimin dhe realizimin e studimit në të gjitha fazat e tij.

Gjithashtu, u jemi mirënjohës dhe falënderojmë të gjithë personat që lehtësuan realizimin në kohë dhe me cilësi të pyetësorëve dhe fokus-grupeve: përfaqësuesit e MAS-it, drejtuesit dhe specialistët e të gjitha DAR/ZA-ve në Shqipëri, drejtorët dhe mësuesit e shkollave të vlerësuara, prindërit dhe nxënësit. Jemi të bindur se angazhimi i tyre i sinqertë është një vlerë e shtuar e këtij studimi.



# Përmbajtja

---

AKRONIME .....	9
PËRKUFIZIME.....	10
PËRMBLEDHJE .....	12
PROBLEMATIKAT E HASURA:.....	13
HYRJE .....	16
Nevoja për këtë studim .....	16
Qëllimi i studimit.....	19
Struktura e Studimit .....	19
PJESA E PARË.....	21
Struktura konceptuale.....	21
Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara .....	21
Arsimi i Integruar për fëmijët me aftësi të kufizuara .....	22
Nevojat e veçanta - Arsimi special.....	22
Arsimi Cilësor .....	23
Modeli Mjekësor, Modeli Social dhe Modeli Biopsikosocial.....	23
PJESA E DYTË.....	26
Kuadri ligjor dhe politikat institucionale që rregullojnë arsimin gjithëpërfshirës	
në Shqipëri .....	26
Kushtetuta e Shqipërisë.....	26
Ligji Nr. 10 221, 2010, Për Mbrojtjen nga Diskriminimi .....	27
Kodi Civil.....	27
Ligji Nr. 9062, datë 8.5.2003. Kodi i Familjes .....	28
Ligji për Shëndetin Mendor, 2012 .....	28
Ligji Nr. 69/2012, Për Arsimin Para-universitar .....	28
Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 (ndryshuar në 2011) për Asistencën dhe Shërbimet Sociale.....	31
Dispozitat Normative për Arsimin Para-universitar, 2002 .....	32
Udhëzimi Nr. 31 për vitin shkollor 2011-2012 në sistemin arsimor para-universitar.....	33
Urdhër Nr. 362, 2007, Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar .....	33

PJESA E TRETË.....	34
Strategjitë dhe Planet e veprimit .....	34
Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2005-2015.....	34
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007) .....	35
Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013.....	35
Strategjia Kombëtare e Arsimit Para-universitar 2009-2013.....	36
Plani i Integruar i Ministrisë së Arsimit, 2010.....	36
Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015, MPCSSHB.....	37
PJESA E KATËRT .....	39
Konventat ndërkombëtare në fushën e Aftësisë së Kufizuar .....	39
Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Kombet e Bashkuara 2006 .....	39
Parime të përgjithshme:.....	39
Konventa e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950.....	40
Karta Sociale Evropiane, rishikuar më 1996.....	40
Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989), ratifikuar nga Shqipëria më 1990.....	40
Deklarata e Salamankës UNESCO, 1994 .....	40
PJESA E PESTË.....	42
Rekomandime të përgjithshme .....	42
ANEKS I: .....	45
Lista e materialeve të marra në shqyrtim për qëllim të studimit.....	45
PARATHËNIE.....	47
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	49
KAPITULLI I .....	52
Sistemi Arsimit Në Shqipëri.....	52
Zhvillimi i Arsimit Gjithpërfshirës Në Shqipëri – Një Vështrim Konciz .....	53
KAPITULLI 2.....	55
Dizajni dhe Metodologjia e Studimit.....	55
Qëllimi dhe objektivat e studimit .....	56



Kampioni i studimit.....	56
Kategoritë e përzgjedhura të fokus grupeve ishin:.....	57
Analiza e të dhënave.....	58
<b>KAPITULLI 3.....</b>	<b>59</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>59</b>
3.1. Të dhëna statistikore për fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare në Shqipëri.....	60
3.1.1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të zakonshme sipas të dhënave të DAR/ZA-eve.....	60
3.1.2 Fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte.....	62
3.1.3 Fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat 9-vjeçare të zakonshme...	62
3.1.4 Të dhëna statistikore për fëmijët me aftësi të kufizuara sipas kategorive të aftësisë së kufizuar.....	63
Besueshmëria e të dhënave statistikore .....	63
3.2. Barrierat kryesore në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme .....	64
3.2.1 Infrastruktura dhe mjedisi fizik.....	64
3.2.2 Gjendja fizike e godinave të kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare.....	66
3.2.3 Dokumentacioni .....	67
3.2.4 Cilësia e arsimimit në arsimin e detyruar .....	68
Stigma dhe diskriminimi .....	72
3.2.5 Faktorët pengues në gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme .....	72
3.2.6 Mungesat si barriera në gjithëpërfshirje.....	78
3.3 Saga e dështimit - Rrugëtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme .....	78
3.3.1 Mosha parashkollore.....	79
3.3.2 Regjistrimi dhe ditët e para në klasën e parë.....	85
3.4 Monitorimi .....	89
3.4.1 Monitorimi në nivel qendror.....	89
3.4.2 Monitorimi në nivel rajoni.....	90
3.4.3 Monitorimi në nivel shkolle.....	92
3.5 Profile të Shqipërisë në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.....	92
3.5.1 Cilësia e shërbimit në zonat urbane kundrejt zonave rurale.....	93

3.5.2 Dallimet mes kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar .....	94
3.5.3 Arsimi publik kundrejt arsimit privat.....	95
3.6 Shkollat speciale.....	97
3.6.1 Statistika për shkollat speciale.....	97
3.6.2 Institutet kombëtare të nxënësve që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë.....	98
3.6.3 Infrastruktura e shkollave speciale.....	99
3.6.4 Mjetet dhe pajisjet mësimore .....	99
3.6.5 Kurrikula, programet dhe tekstet lëndore .....	99
3.6.6 Stafi arsimor në shkollat speciale.....	100
3.6.7 Nevojat kryesore .....	100
3.6.8 Perceptime të stafit për rolin e shkollave speciale.....	100
3.7 Praktika pozitive në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara .....	101
3.7.1 Projekti “Arsimi gjithëpërfshirës – kërkesë e mijëvjeçarit të ri” .....	101
3.7.2 Projekte dhe nisma të tjera.....	102
3.7.3 Gjurmë të paharrueshme .....	104
 4. REKOMANDIME DHE SUGJERIME .....	 106
4.1 Rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës .....	106
4.2 Rekomandime për shkollat.....	115
 REFERENCAT KRYESORE .....	 117

## Akronime

---

<b>AK</b>	Aftësi e kufizuar
<b>DAR</b>	Drejtoria Arsimore Rajonale
<b>DN</b>	Dispozita Normative
<b>EFA</b>	Edukim për të Gjithë
<b>IKAP</b>	Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar
<b>IZHA</b>	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>KMCAP</b>	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
<b>KDF</b>	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
<b>KDPAK</b>	Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe e Sportit
<b>MEDPAK</b>	Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>OJF</b>	Organizatë jofitimprurëse
<b>PEI</b>	Plan Edukimi Individual
<b>PL</b>	Pushteti Lokal
<b>SKZHAP</b>	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Para universitar
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>ZA</b>	Zyrë Arsimore

# PËRKUFIZIME

**Aftësi e kufizuar intelektuale:** term që përdoret për personat me aftësi të kufizuar që karakterizohen nga kufizime të ndjeshme si në funksionimin intelektual ashtu edhe në sjelljen e përshtatshme.

**Aftësi e kufizuar zhvillimore:** është një term ombrellë i cili nënkupton çdo aftësi të kufizuar që shfaqet para moshës 22 vjeçare dhe që vazhdon gjatë gjithë jetës.

**Arsim i detyruar:** është arsimi bazë, i njësuar dhe i përgjithshëm. Shkolla e arsimit të detyruar përfshin dy cikle: ciklin fillor dhe ciklin e lartë. Shkolla e arsimit të detyruar mund të jetë shkollë me cikël të plotë ose shkollë me kohë të shkurtuar.

**Arsim gjithëpërfshirës:** mjedis mësimor që mundëson akses, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit. Arsim gjithëpërfshirës do të thotë që shkollat duhen përshtatur për të gjithë fëmijët, pavarësisht kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose kushte të tjera.

**Arsim integruar:** u referohet masave që merren për të siguruar arsim në sistemin e shkollave të zakonshme me pak mbështetje ekstra (p.sh. klasa burimore, mësues mbështetës etj.) për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Arsim special:** çdo fëmijë është i veçantë dhe çdo fëmijë ka nevojë për mbështetje në procesin e zhvillimit dhe të përshtatjes në jetë. Disa fëmijë kanë më shumë nevojë se të tjerët gjatë viteve të shkollës. Kjo ndihmë e veçantë, speciale, njihet ndryshe si arsim special.

**Autizëm:** është një çrregullim i zhvillimit që karakterizohet nga vështirësi të mëdha në komunikim dhe në formimin e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë si dhe në përdorimin e gjuhës dhe koncepteve abstrakte.

**Biopsikosocial:** ICF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, OBSH, 2001) përcakton modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, sipas të cilit shëndeti i një personi nuk ka të bëjë vetëm me veçoritë e tij anatomike dhe fiziologjike (pjesët e trupit dhe strukturën e tij). Ky model njeh faktin që shëndeti i një personi ndikohet gjithashtu nga (a) faktorë të tjerë të lidhur me vetë personin (d.m.th. me individin si i tërë, personalitetin e tij, përbërjen e tij sociale dhe kulturore) dhe (b) faktorët mjedisorë (që përfshijnë kontekstin fizik dhe social).

**Çrregullime të të nxënimit:** vështirësi në mësimin e aftësive specifike të tilla si leximi, gjuha apo matematika. Ato prekin aftësinë e njerëzve si në interpretimin e asaj që shohin dhe dëgjojnë, ashtu edhe në lidhjen e informacionit.

**Kornizë kurrikulare:** dokumenti themelor i kurrikulës ku përshkruhen synimet e përgjithshme të saj, kompetencat themelore, rezultatet e pritshme për nxënësit

për sa i përket dijeve, aftësive dhe qëndrimeve në fund të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë, synimet e fushave të të nxënësve dhe parimet e përgjithshme të procesit të mësimdhënies e të mësimnxënies e të vlerësimit të nxënësve.

**Kurrikula:** tërësia e dokumentacionit si korniza kurrikulare, plani shkollor, programi mësimor, teksti dhe materiale të tjera të një lënde apo fushe lëndore dhe gjithë veprimtaria e organizuar në mjedisin e të nxënësve për të siguruar një formim të caktuar të atyre që mësojnë.

**Mësues i arsimit special:** mësues i trajnuar për të ndihmuar nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

**Nxënës me aftësi të kufizuara:** nxënës i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara të cilat, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.

**Nxënës me nevoja të veçanta:** janë ata nxënës që kanë nevojë për shërbime të veçanta për të aksesuar arsimin dhe maksimalizuar potencialin e tyre të të nxënësve.

**Pajisje ndihmëse:** janë instrumente ndihmëse, aplikacione, teknologji dhe sisteme të tjera mbështetëse që shërbejnë për të lehtësuar të nxënësve e fëmijëve me aftësi të kufizuara në veçanti dhe atyre me nevoja të veçanta arsimore në përgjithësi.

**Shkollë speciale:** një shkollë që mundëson arsimim dhe shërbime të tjera të ngjashme vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përbëhet nga mësues të trajnuar specifikisht për të punuar me këta fëmijë.

*Faza e parë e studimit:*

# Faza e parë e studimit:

## Kuadri ligjor, politikat institucionale dhe aktet ndërkombëtare në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara

### Përmbledhje

---

*Organizata Save the Children, në punën e saj disaveçare në Shqipëri, i ka kushtuar vëmendje parësore nxitjes së arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët e përjashtuar, veçanërisht nxitjes dhe lehtësimit të arsimit cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara.*

*Save the Children dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MAS), prej vitit 2004, kanë bashkëpunuar fuqishëm në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në saje të eksperiencës shumëvjeçare të zbatimit të modeleve të Arsimit Gjithëpërfshirës, një numër i konsiderueshëm fëmijësh me aftësi të kufizuara janë mbështetur në procesin e regjistrimit dhe pjesëmarrjes së plotë, në përmirësimin e rezultateve mësimore dhe në shoqërizimin me shokët e tjerë të klasës në ambientin e shkollës publike.*

*Nxitja e arsimit gjithëpërfshirës është realizuar kryesisht përmes: (1) Mbështetjes së drejtpërdrejtë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në përfshirjen dhe edukimin në shkollat publike; identifikimit, regjistrimit dhe mbështetjes së përditshme përmes zhvillimit dhe zbatimit të Planeve Edukative Individuale (PEI); mbikëqyrjes dhe monitorimit të arritjeve mësimore dhe shoqërore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në përputhje me PEI-të specifike të përshtatura për nevojat e tyre. (2) Ngritjes së kapaciteteve të mësuesve, prindërve, specialistëve të arsimit në Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) dhe psikologëve të shkollës në lidhje me çështjet e Arsimit Gjithëpërfshirës. (3) Aktiviteteve ndërgjegjësuese, të shtrira në shkollat dhe kopshtet e përzgjedhura si dhe më gjerë, në komunitetin përreth, për sa i përket të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsimim gjithëpërfshirës dhe cilësor. (4) Përgatitjes dhe shpërndarjes së informacioneve të publikuara për qëllimet e fushatës ndërgjegjësuese.*

*Kjo eksperiencë disaveçare e bashkëpunimit të Save the Children dhe MAS në promovimin dhe mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës ka rezultuar efikase dhe ndihmuese për përmirësimin e procesit të politikëbërjes dhe kuadrit ligjor lidhur me çështjet e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Arritje e rëndësishme në fushën e hartimit të politikave është përgatitja e draft-ligjit për Arsimin Parauniversitar (miratuar në Korrik*

2012). *Save the Children* u angazhua në formulimin e disa pjesëve kyç të këtij legjislacioni, i cili parashikon lehtësira për Arsimin Gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar.

Qeveria Shqiptare, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile, është zotuar për garantimin e të drejtës për pjesëmarrje dhe arsim cilësor për çdo nxënës si një nga sipërmarrjet më serioze për zhvillimin e arsimit. Miratimi i Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (MAS), Plani i Veprimit për Fëmijë (MPCSSHB) ashtu si detyrimet për respektimin e akteve ndërkombëtare të nënshkruara dhe përpjekjet për përmbushjen e objektivit “Edukimi për të Gjithë” (Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit) janë tregues pozitivë të zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri.

Megjithatë, pavarësisht hapave pozitivë të ndërmarrë për përmirësimin e legjislacionit për arsimin gjithëpërfshirës, mbetet ende për të punuar në lidhje me zbatimin e tij. Problematikat e identifikimit dhe përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat publike kanë të bëjnë me pengesat dhe vështirësitë infrastrukturore të aksesit në shkollë, metodat dhe planet edukative ekzistuese, mungesën e ndihmës dhe mbështetjes profesionale për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin publik, ambientin e ngurtë shoqëror dhe emocional si dhe nevojën për përmirësime në kuadrin ligjor në fuqi.

Nevoja për realizimin e modeleve dhe parimeve të Arsimit Gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe prania e barrierave edukative, shoqërore, infrastrukturore e institucionale në sistemin arsimor aktual, nxit nevojën për angazhimin e aktorëve joqeveritarë në hartimin e politikave mbështetëse dhe në ndërhyrje konkrete në këtë fushë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qeveritare dhe grupet e interesit.

Studimi i legjislacionit, strategjive dhe planeve të veprimit institucionalë në fushën e të drejtës për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara synon të ofrojë një panoramë të përgjithshme të politikave gjithëpërfshirëse në arsim.

Metodologjia e këtij studimi, shtyllë e rëndësishme e punës sonë, është këqyrja e kuadrit ligjor, strategjive dhe planeve të veprimit ndërsektoriale si dhe akteve ndërkombëtare për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Gjetjet statistikore dhe cilësore, të nxjerra përmes pyetësorëve dhe fokus-grupeve, paraqiten në pjesën e dytë të Studimit Analitik.

## **Problematikat e hasura:**

---

Problemet dhe vështirësitë më të mëdha në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, të hasura gjatë studimit të kuadrit ligjor dhe politikave gjithëpërfshirëse në Shqipëri, janë:

- Paqartësia në përcaktimin e termit Arsim Gjithëpërfshirës si pjesë e Arsimit Cilësor, mbështetja në Modelin Mjekësor përkundrejt Modelit Social dhe Modelit Biopsikosocial, mungesa e qartësisë në përdorimin e termave Integrim dhe Gjithëpërfshirje dhe termave Nevoja të Veçanta dhe Aftësi të Kufizuara.

- *Mungesa e investimeve të drejtpërdrejta nga ana e qeverisë për zbatimin e strategjive për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara: Në të gjitha dokumentet e marra në konsideratë, vihet theksi tek cilësia në edukim por, në të vërtetë, duket se nxitja e regjistrimit në shkolla është prioriteti themelor në planet e veprimt. Vihen re ndërhyrje sporadike në fushën e arsimit gjithëpërfshirës (lidhur me braktisjen e shkollës nga fëmijët romë apo fëmijët e rrugës) por nuk ka ndërmarrje dhe strategji të qarta për arsimimin cilësor për të gjithë grupet e përjashtuar.*
- *Të dhënat e paqarta të ofruara nga institucionet përgjegjëse për sa i përket numrit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara: Shërbimi Social Shtetëror jep vetëm numrin total të personave me aftësi të kufizuara, rreth 17.786 ose afro 3.6 për qind e popullsisë. Kjo statistikë i referohet vetëm personave që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe, veç kësaj, mungojnë të dhëna të sakta për kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar. As Instituti i Statistikave nuk ofron të dhëna për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në sistemin arsimor publik. Mbledhja e të dhënave mbi problemet e aftësisë së kufizuar paraqitet e vështirë. Kjo për shkak të mungesës së kapaciteteve institucionale në lidhje me mbledhjen dhe përditësimin e statistikave. Kryesisht, mungon bashkërendimi i teknikave dhe metodologjisë së përdorur nga institucionet përgjegjëse në procesin e mbledhjes së të dhënave si dhe bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile dhe me grupet e interesit për përmirësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave mbi braktisjen e fshehtë të shkollës nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave ndërsektorale për identifikimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe mbledhjen e të dhënave lidhur me arsimimin e tyre janë shumë të nevojshëm.*
- *Mungesa e aftësimin të mësuesve dhe e organizimit të trajnimeve për ta lidhur me arsimin gjithëpërfshirës, me qëllimin për ta kthyer këtë të fundit në një normë në arsim: Reforma e bërë në edukimin e mësuesve për ngritjen e kapaciteteve të tyre lidhur me aftësitë e menaxhimit dhe teknikat novatore të mësimdhënies (që përfshijnë fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit) është e rëndësishme por duket se trajnimi i mësuesve në mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë procesit mësimor nuk zë një vend të rëndësishëm në këtë reformë.*
- *Mungesa e zhvillimit të kurrikulave fleksibël dhe në përputhje me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara: Kurrikulat ekzistuese nuk kanë informacionin e duhur për aftësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësimdhënia për ta është e bazuar në kurrikulën bërthamë e cila nuk parashikon asgjë për nevojat e veçanta të këtyre fëmijëve. Reforma kurrikulare është prioritet i edukimit*



*cilësor por mbetet ende një sfidë mbështetja e kësaj reforme në angazhimin dhe kontributin e grupeve të interesit (përpos aktiviteteve për përfshirjen e partnerëve në strategjitë dhe planet e veprimit për vitin 2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta).*

- *Mungesa e investimeve direkte dhe e planeve financiare për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës. Këqyrja e dokumenteve nxjerr në pah mungesën e qartësisë së burimeve financiare për qëllime të arsimit gjithëpërfshirës. Në planet e veprimit duket se, deri më tani, investimet e shtetit (bashkëfinancime dhe me projekte të OJF-ve të fushës) janë bërë në drejtim të plotësimit të nevojave në mënyrë të pjesshme dhe afatshkurtër (si p.sh. riparime shkollash apo trajnime mësuesish etj.). Por, sfida e realizimit të arsimit gjithëpërfshirës qëndron në sigurimin e një mbështetjeje të gjerë financiare, e cila të mbulojë nevojat dhe kërkesat për përmbushjen e standardeve.*

## Hyrje

---

### **Nevoja për këtë studim**

Regjistrimi dhe përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin parashkollor dhe atë të detyruar mbetet ende një problem shqetësues në Shqipëri. Probleme të tilla si: vështirësia në identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndërtesat e papërshtatshme dhe infrastruktura e varfër e shkollave dhe kopshteve publike, programet dhe kurrikulat e papërshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesa e përgatitjes së mësuesve për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesa e mësuesve mbështetës në klasa, këndvështrimi i ngurtë i shoqërisë dhe informacioni i pakët mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara nxisin kërkesën dhe nevojën për ndryshime dhe përmirësime të domosdoshme në sistemin arsimor dhe ambientin shoqëror.

Mbështetur në të dhënat e marra nga Shërbimi Social Shtetëror, numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara mbërrin në **17,786 fëmijë** dhe afro 60 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në zonat rurale. Një numër prej 4,776 fëmijësh janë të grup moshës 0-6 vjeç, 8,845 fëmijë të grup moshës 6-15 vjeç dhe 4,165 fëmijë të grup moshës 15-18 vjeç. Fëmijë me aftësi të kufizuara që duhet të ndjekin arsimin parashkollor llogariten të jenë 2,289, **ndërsa 5,477 fëmijë duhet të ndjekin arsimin 9-vjeçar** dhe 1,356 fëmijë duhet të ndjekin arsimin e mesëm.

Sipas tabelave analitike për 38 Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore për vitin 2011 mbi përfshirjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë vendi, (tabela të siguruar nga burime të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës) **numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollë është 1,058**. Fëmijët që ndjekin shkollën e zakonshme janë 965. 237 prej tyre janë fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ndërkohë që fëmijë me aftësi të kufizuara fizike janë 145, fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike 187, fëmijë me aftësi të kufizuara pamore 172, fëmijë me aftësi të kufizuara dëgjimore 57, fëmijë me vështirësi në të folur 91 dhe fëmijë autikë 41. Fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët kanë braktisur shkollën janë gjithsej 75. Ka edhe 26 fëmijë të cilëve u ofrohet mësimi në shtëpi.

Procesi i mbledhjes së të dhënave mbi fëmijët me aftësi të kufizuara paraqitet i vështirë për arsye të mungesës së shifrave të sakta zyrtare, të përfuara nga dokumentet administrative, dhe paqartësisë së statistikave të ofruara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Arsimit. Sjellim në vëmendje që Instituti i Statistikave në Shqipëri nuk jep të dhëna specifike për grupin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në analizat dhe statistikave që ofron mbi numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe në shkollat 9-vjeçare.

Nëse u referohemi të dhënave të mësipërme, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin kopshtet dhe shkollat e zakonshme zë një vend të vogël në

numrin e përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Raportet mbi progresin e Shqipërisë në zhvillimin e arsimit për fëmijët me AK dhe mbrojtjen e personave me AK gjatë periudhës 2008-2011 vënë në dukje se përparimi i bërë në fushën e trajtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera më të cenueshme të shoqërisë është i pamjaftueshëm.

Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar 2008 i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar i shihte ende qëndrimet dhe mentalitetin e ngurtë të shoqërisë përkundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu specialistët e edukimit e madje edhe familjarët e këtyre fëmijëve, si pengesa për gjithëpërfshirjen e tyre në arsim dhe në shoqëri.

Në Progres Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2009<sup>1</sup> *Shqipëria paraqiste shqetësim për sa i përket regjistrimit në shkollën e zakonshme dhe ndjekjes së saj nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Arsimimi i tyre kryesisht mbështetet në shkollat speciale. Megjithatë Ministria e Arsimit kishte investuar në ndërgjegjësimin e mësuesve dhe specialistëve të arsimit për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin publik, mbetet ende problem mungesa e infrastrukturës dhe e trajnimeve të nevojshme për mësuesit dhe specialistët e fushës.*

Progres Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2010<sup>2</sup> shpreh që, në sajë të fushatës nxitëse dhe përpjekjeve të organizatave joqeveritare për fuqizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, Qeveria Shqiptare ka përmirësuar standardet dhe shërbimet ndihmëse për grupet në nevojë. Në fushën e arsimit, kurrikulat shkollore janë rishikuar dhe kanë njëfarë fleksibiliteti për plotësimin e nevojave të grupeve të minoriteteve dhe atyre vulnerabël. Megjithatë, duhet të zbatohet legjislacioni për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për grupet vulnerabël dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Disa masa për sigurimin e cilësisë janë ndërmarrë apo forcuar, si p.sh. hartimi i librave të rinj shkollorë dhe inspektimet në shkollat<sup>3</sup>. Cilësia e arsimit ndikohet nga nevoja për rehabilitimin e vazhdueshëm të shkollave, përmirësimin e pajisjeve, trajnimin e mësuesve dhe mbështetjen e veprimtarive shkollore tek burimet e të dhënave të tilla si banka e të dhënave e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën-UNESCO (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization) e cila ofron strategji dhe mjete për krijimin e mjediseve praktike dhe gjithëpërfshirëse që lehtësojnë të nxënëit.

Progres-Raporti i Komisionit Evropian 2011<sup>4</sup> thekson se kuadri ligjor nuk është plotësuar dhe implementimi i strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuara

1. Progres-Raport - Shqipëria, Komisioni Evropian, 2009. [http://ec.europa.eu/enlargement/press\\_corner/key-documents/reports\\_nov\\_2009\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/reports_nov_2009_en.htm)
2. Progres-Raport - Shqipëria, Komisioni Evropian, 2010. [http://ec.europa.eu/enlargement/press\\_corner/key-documents/reports\\_nov\\_2010\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/reports_nov_2010_en.htm)
3. Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit dhe i shkollës, Udhëzues i Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.
4. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/al\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf)

ka vazhduar të jetë i ngadaltë.

Në fushën e shërbimeve sociale, numri i personave që përfitojnë shërbimet është më i ulët sesa numri i atyre që realisht kanë nevojë për këto shërbime dhe kjo për shkak të mungesës së mekanizmave gjithëpërfshirës dhe hezitimit të personave me aftësi të kufizuara për të deklaruar aftësinë e tyre të kufizuar si pasojë e mendësisë së ngushtë të shoqërisë. Qendrat e rehabilitimit për fëmijët me aftësi të kufizuara janë të pakta<sup>5</sup>, mungon mbështetja psikosociale për familjet dhe nuk ka programe të mjaftueshme ndërgjegjësimi për integrimin e këtyre fëmijëve në jetën shkollare dhe jashtë saj.

Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013 e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i vlerëson fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët romë dhe egjiptianë si grupi më i pambrojtur në Shqipëri. Për shkak të programeve të papërshtatshme mësimore, mungesës së pajisjeve të duhura në shkolla, diskriminimit dhe mësuesve të pa trajnuar, fëmijët me aftësi të kufizuara dallojnë për nivelin më të ulët të aksesit dhe pjesëmarrjes në shkollë.

Pavarësisht se në Shqipëri zhvillimi i legjislacionit ka shënuar ritëm pozitiv për sa i përket politikave gjithëpërfshirëse, ende mbetet punë për të bërë për zbatimin e praktikave të mira. Arsimi gjithëpërfshirës ende nuk njihet në kurrikulat universitare të mësuesisë (përveç Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, ku aftësia e kufizuar është futur në programin master të Fakultetit të Shkencave të Edukimit si lëndë më vete). Metodologjia e mësimdhënies "me fëmijën në qendër" kërkon profesionalizëm, kurrikula të përshtatura (duke filluar që nga përgatitja e mësuesve dhe përshtatja e kurrikulës bazë në arsimin bazë, përfshirë atë parashkollor) dhe mbështetje shumë-disiplinare në shkollë.

Si nënshkruese e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Kombet e Bashkuara), nënshkruar nga Shqipëria në 22 dhjetor 2009<sup>6</sup>, Qeveria Shqiptare është angazhuar të ndër marrë një sërë reformash në fushën e aftësisë së kufizuar, të cilat përfshijnë të drejtat e njeriut, gjithëpërfshirjen në arsim dhe shoqëri dhe përmirësimin e jetesës së personave me aftësi të kufizuara. Nënshkrimi i Konventës i detyron shtetet palë të përmirësojnë legjislacionin ekzistues në përputhje me Konventën si dhe të përqafojnë politika dhe iniciativa për krijimin e shoqërisë gjithëpërfshirëse.

Duke qenë se, gjatë këtyre viteve të fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje të mëdha në kuadrin legjislativ për arritjen e objektivave ndërkombëtare të krijimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse, vlen të përmenden këtu parimet dhe vlerat e një shoqërie të tillë.

Vizioni i shoqërisë gjithëpërfshirëse është ai i një shoqërie të barabartë, në të cilën shkaqet e përjashtimit janë të identifikuar dhe të adresuara në mënyrë cilësore. Kështu, nga ky këndvështrim, aftësia e kufizuar nuk konsiderohet si shqetësim (funksional apo ndërpersonall/shoqëror) por si përpjekje e shoqërisë për të krijuar një ndërveprim midis

5. Sipas Shërbimit Social Shtetëror, në Tiranë janë gjithsej 13 qendra rehabilituese që ofrojnë shërbim për personat me aftësi të kufizuara; 4 prej tyre janë qendra të specializuara edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara (personat me aftësi të kufizuara për moshat 6-40 vjeç, fëmijët me aftësi të kufizuara mendore për moshat 0-12 vjeç).

6. [www.un.org/disabilities/documents/.../crpd\\_albanian.pdf](http://www.un.org/disabilities/documents/.../crpd_albanian.pdf).

individit dhe shoqërisë/mjedisit rrethues<sup>7</sup>.

Deklarata Botërore e Edukimit për të Gjithë (EFA) për vitin 2020, e cila synon edukimin për të gjithë fëmijët, thekson qartësisht arsimin gjithëpërfshirës si një strategji thelbësore për zhvillim. Deklarata e Salamankës (1994) pohon që çdo fëmijë ka karakteristika, interesa, aftësi dhe nevoja për të mësuar specifike dhe që fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën për të mësuar në shkolla të zakonshme, të cilat duhet t'i mirëpresin ata me parimin "fëmija në qendër" dhe të jenë të afta të përmbushin nevojat e tyre. Deklarata e Salamankës pohon gjithashtu që sistemi arsimor që merr në konsideratë shumëllojshmërinë e karakteristikave dhe nevojave të fëmijëve është mjeti më efikas për të luftuar qëndrimet diskriminuese si dhe për krijimin e ambienteve mirëpritëse, ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse, përmbushjen e arsimit për të gjithë dhe, mbi të gjitha, përmirësimin e sistemit arsimor në përgjithësi.

Sipas kësaj deklarate, arsimi gjithëpërfshirës mbështetet në parimin themelor që të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, pavarësisht vështirësive apo ndryshimeve që ata mund të kenë. Shkollat gjithëpërfshirëse duhet të njohin dhe t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të nxënësve, të përshtatin të gjitha nivelet e të nxënësve dhe të sigurojnë arsimim cilësor për të gjithë përmes kurrikulave të përshtatura, strukturave organizative, strategjive të mësimdhënies, bashkëpunimit me komunitetet në shkollë dhe një sërë shërbimeve në përputhje me nivelet e nevojave të hasura në shkollë<sup>8</sup>.

Duke e konsideruar arsimin gjithëpërfshirës si hallkën kryesore të reformave të qeverisë për edukim cilësor, vlen të rishikojmë cilat janë ndërmarrjet kryesore, kuadri ligjor dhe reforma bazë për respektimin e të drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje në arsim dhe zhvillim akademik të përshtatshëm.

## **Qëllimi i studimit**

Qëllimi kryesor i këtij studimi të kuadrit ligjor, politikave institucionale dhe akteve ndërkombëtare është përmirësimi i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në mënyrë që të nxiten të drejtat e tyre për pjesëmarrje dhe arsim cilësor.

## **Struktura e Studimit**

**Pjesa e parë**, për qëllim të studimit, shpjegon terminologjinë dhe konceptet e përdorura në pothuajse të gjitha dokumentet e marra në shqyrtim: arsimi gjithëpërfshirës, arsimi i integruar, arsimi special, modeli mjekësor, modeli social dhe modeli biopsikosocial.

**Pjesa e dytë** paraqet kuadrin ligjor në fuqi, strategjitë dhe planet e veprimit

---

7. Bazuar në Klasifikimin e Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit – Organizata Botërore e Shëndetit.

8. Deklarata e Salamankës për Parimet, Politikat dhe Praktikën në Arsimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe Plani për Veprim [http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA\\_E.PDF](http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF)

ekzistuese të ndërmarra nga qeveria për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës.

**Pjesa e tretë** paraqet konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare më të rëndësishme në fushën e të drejtave për arsim gjithëpërfshirës.

**Pjesa e katërt** paraqet rekomandime dhe konkluzione për fuqizimin e arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri.

Një listë e dokumenteve të marrë në analizë është paraqitur në Aneksin bashkëngjitur studimit.

# Pjesa e Parë

## Struktura konceptuale

*Konceptet dhe përkufizimet e hasura pothuajse në të gjitha dokumentet e studiuar janë ato të arsimit gjithëpërfshirës, arsimit të integruar, arsimit special, arsimit cilësor, modelit mjekësor, modelit social dhe modelit biopsikosocial.*

*Kuptimi i këtyre koncepteve varion dhe nuk ka ndonjë marrëveshje të përbashkët në nivel ndërkombëtar lidhur me të. Përkufizimet e përdorura për qëllim të këtij studimi bazohen në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe në botimin “Disability Equality in the Classroom: A human Right Issue” (Barazia e Aftësisë së kufizuar në Klasë: Një Çështje e të Drejtave të Njeriut) të Richard Rieser dhe Micheline Mason.*

### **Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara**

---

*Fëmijët me aftësi të kufizuara janë të ndryshëm por të bashkuar nga eksperiencia e përbashkët e përballjes me barrierat ndaj gjithëpërfshirjes në shkollë dhe shoqëri. Deri më sot, nuk është arritur në një përkufizim universal të termit aftësi e kufizuar por, në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara, e cila mbështetet në Standardet e Klasifikimit dhe Funksionimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar, citohen elementet kryesorë të analizës së këtij termi: “Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë ata njerëz që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo ndijore të cilat, në ndërveprim me barrierat e ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe cilësore në shoqëri në të njëjtat kushte me të tjerët”.*

**Arsimi Gjithëpërfshirës** për fëmijët me aftësi të kufizuara është procesi i rritjes së pranisë (aksesit në arsim), pjesëmarrjes dhe arritjeve mësimore (cilësia e arsimit) të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Arsimi Gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk vendos karakteristikat personale apo aftësitë në qendër të “përrjashtimit” nga arsimi i rregullt.

Vështirësitë në arsimin gjithëpërfshirës konsistojnë në: qëndrimet e mësuesve dhe metodat e ngurta të mësimdhënies, kurrikulat jo të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesën e pajisjeve didaktike të përshtatura dhe mjeteve mësimore, të qenët e ambienteve fizikisht të paarritshme, mos përfshirjen e prindërve dhe faktin që mësuesit dhe shkollat nuk mbështeten në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Reforma për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës përfshin ndryshime dhe përmirësime në mentalitetin dhe qëndrimin e shoqërisë ndaj diversitetit si dhe përmirësim të politikave dhe praktikave të shkollës dhe mbarë sistemit arsimor në

mënyrë që ky të jetë i gatshëm të mirëpresë dhe të edukojë çdo fëmijë.

Arsimi Gjithëpërfshirës krijon kushte për arsim të barabartë dhe cilësor, ofron metoda të përshtatura mësimore që synojnë përmbushjen e nevojave të veçanta si dhe trajnime shtesë për mësuesit dhe orientohet drejt përfshirjes së prindërve si partnerë të nevojshëm në arsimimin e fëmijës.

Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara konsiderohet, para së gjithash, si një proces vazhdimisht në përmirësim i cili kërkon kohë si dhe angazhimin e të gjithë aktorëve institucionalë dhe partnerëve/shoqërisë civile në ndërtimin e një sistemi të suksesshëm.

### **Arsimi i Integruar për fëmijët me aftësi të kufizuara**

---

*Arsimi i Integruar për fëmijët me aftësi të kufizuara synon integrimin e këtyre fëmijëve në arsimin e zakonshëm. Ndryshe nga Arsimi Gjithëpërfshirës, ai përpiqet ta shohë problemin e përjashtimit të fëmijës me aftësi të kufizuara tek gjendja fizike/intelektuale e tij. Në procesin e të mësuarit të fëmijës reflektohet kryesisht modeli mjekësor i trajtimit të aftësisë së kufizuar. Për këtë arsye, arsimi i integruar fokusohet në zgjidhje të tilla si “përshtatja” e fëmijës në sistemin arsimor ekzistues. Problematikat në arsimin e integruar qëndrojnë në faktin që fëmija me aftësi të kufizuara ka nevoja të veçanta, ka nevojë për ambient të veçantë, ka nevojë për pajisje të veçanta, ka nevojë për mësues të veçantë, është ndryshe nga fëmijët e tjerë, nuk i përgjigjet procesit të të nxënës, ka vështirësi të shkojë në shkollë etj.*

Me një qasje të tillë, fëmija mund të përfitojë vetëm për një kohë të kufizuar. Arsimi i integruar nuk çon në një sistem arsimor të qëndrueshëm dhe cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Shpesh, arsimi i integruar është i përshtatshëm për të nxitur praninë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme por nuk siguron pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në të gjitha aspektet e shkollës dhe/ose arritjet e tyre akademike.

Vlen të përmendet që shpesh nuk ka një perceptim të qartë të përkufizimeve të arsimit të integruar dhe arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nuk bëhet dallimi midis tyre.

### **Nevojat e veçanta - Arsimi special**

---

*Termi “nevojë e veçantë” për disa shoqëri ka të njëjtin kuptim me termin “aftësi e kufizuar”, ndërsa, në raste të tjera, i referohet fëmijëve të cilët janë “ndryshe” për shkak të aftësisë së kufizuar, sjelljes apo të qenit të pambrojtur dhe të dobët në shoqëri.*

*Megjithatë, pavarësisht nëse përdoret emërtimi “fëmijë me aftësi të kufizuara” apo*



“fëmijë me nevoja të veçanta arsimore” kemi të bëjmë me një mënyrë të papërshtatshme për të dalluar një grup të caktuar pasi mund të themi që të gjithë fëmijët kanë nevoja të veçanta apo individuale (për shembull sepse kanë vështirësi në një lëndë të caktuar, kanë dhunti të veçanta, e kanë të vështirë të zënë shoqëri etj). Nuk është e thënë që fëmija të ketë një dëmtim të caktuar ose ndonjë aftësi të kufizuar fizike dhe/ose intelektuale të diagnostikuar për të pasur nevoja të veçanta arsimore.

## **Arsimi Cilësor**

---

Gjatë shqyrtimit të ligjeve në fuqi, politikave dhe praktikave institucionale në Shqipëri, nuk shquhet një lidhje e qartë mes të drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim dhe edukimit cilësor por është e rëndësishme të vërehet se edukimi cilësor është pashmangshmërisht i pandarë nga e drejta për pjesëmarrje të plotë dhe cilësore në arsimin publik.

Në këtë studim, koncepti i arsimit cilësor i referohet interpretimeve të këtij koncepti në Kuadrin për Veprim të Dakarit<sup>9</sup> ku pohohet se “Cilësia është thelbësore për arsimin dhe [...] arsim cilësor është ai që përmbush nevojat bazë të të mësuarit dhe pasuron jetën e nxënësve dhe të gjithë eksperiencën e tyre të të jetuarit.”

Faktorët kryesorë që përcaktojnë arsimin cilësor janë:

- Nxënës të shëndetshëm, të mirë ushqyer dhe të motivuar
- Mësues të mirë trajnuar dhe teknika nxitëse të mësimit
- Pajisje dhe mjete didaktike të përshtatshme
- Kurrikula të përshtatura për nevojat dhe aftësinë e të nxënësve të fëmijëve dhe të bazuara në eksperiencën e mësuesve dhe nxënësve.
- Një ambient jo vetëm që nxit të mësuarit por edhe mirëpritës, i shëndetshëm dhe i sigurt.
- Një përcaktim i qartë dhe i detajuar i vlerësimit dhe pritshmërive akademike.
- Respektim i bashkëpunimit me komunitete dhe kultura të ndryshme.

## **Modeli Mjekësor, Modeli Social dhe Modeli Biopsikosocial**

---

**Modeli mjekësor** i mëshon parimit se njerëzit janë “objekte individuale” që duhen “trajtuar”, “ndryshuar”, “përmirësuar” dhe bërë më “normalë”. Qasja mjekësore e aftësisë së kufizuar ngre pikëpamjen se aftësia e kufizuar është “problem individual patologjik” dhe janë njerëzit me aftësi të kufizuara ata që duhet të përshtaten me shoqërinë.

---

9. Kuadri për Veprim i Dakarit, Kombet e Bashkuara, 2000: <http://unesdoc.unesco.org/images/0012/001211/121147e.pdf>

Ndërsa, **modeli social** i trajtimit të aftësisë së kufizuar mbështetet në pikëpamjen që, pavarësisht kushteve mjekësore, të cilat kanë ose jo nevojë për trajtim, është shoqëria ajo që duhet t'u mundësojë personave me aftësi të kufizuara kushtet e nevojshme për një jetë cilësore. Pra, është vullneti social që duhet të ndryshojë dhe të përshtatet dhe jo aftësia e kufizuar në vetvete<sup>10</sup>.

*Tabela e mëposhtme përshkruan ndikimet e modelit mjekësor dhe atij social në rastet e zbatimit të tyre në shkollën e zakonshme<sup>11</sup>.*

<b>Nr.</b>	<b>Modeli mjekësor</b>	<b>Modeli Social</b>
1.	♦ “Fëmija është fajtor”	♦ “Fëmija është vlerë”
2.	♦ Përqendrimi tek diagnoza	♦ Kapacitete dhe nevoja të përcaktuara nga vetë fëmijët dhe të tjerët në ambientin e shkollës dhe jashtë saj.
3.	♦ Emërtimet/etiketimet	♦ Njohja e pengesave dhe gjetja e zgjidhjeve
4.	♦ Vënia e dëmtimit në qendër të vëmendjes	♦ Hartimi i programeve të bazuara te pritshmëritë
5.	♦ Përqendrimi vetëm në vlerësimin dhe monitorimin e ecurisë së fëmijës në kontekstin mjekësor	♦ Ofrimi i burimeve
6.	♦ Mënjanimi dhe shërbimet e veçanta	♦ Trajnime për prindërit dhe profesionistët
7.	♦ Fokusimi tek përmbushja e nevojave të zakonshme personale	♦ Krijimi i marrëdhënieve miqësore
8.	♦ Rifutja në shoqëri nëse fëmija konsiderohet “normal” ose përjashtim i përkohshëm i tij.	♦ Mirëpritja e të qenit ndryshe dhe e nevojave dhe prirjeve të veçanta të fëmijës
9.	♦ Shoqëria mbetet e pandryshueshme	♦ Shoqëria përfshin

10. Rieser and Mason, 1992, fq. 15,

11. Rieser, The Social Model of Disability. 2001, fq. 139

### ***Modeli Biopsikosocial***

Siç e përmendëm më lart, modelet më të njohura të trajtimit të aftësisë së kufizuar janë modeli mjekësor, i cili e sheh aftësinë e kufizuar si tipar të personit, të shkaktuar nga sëmundje, trauma ose ndonjë kusht tjetër mjekësor, që kërkon trajtim mjekësor të veçantë për të “rregulluar problemin individual patologjik”, dhe modeli social, i cili, nga ana tjetër, e sheh aftësinë e kufizuar si problem shoqëror, duke theksuar që mos përfshirja e personave me aftësi të kufizuara shkaktohet nga qëndrimet dhe ambienti i ngurtë shoqëror.

Aftësia e kufizuar është një fenomen shumëdimensional që përcaktohet nga marrëdhënia ndërmjet tipareve dhe cilësive individuale të personave me aftësi të kufizuara dhe tipareve dhe veçorive të ambientit shoqëror.

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF), OBSH, 2011, ka përcaktuar një teori të re të trajtimit të aftësisë së kufizuar e cila përfaqëson një ndërthurje të këtyre dy modeleve. Modeli Biopsikosocial<sup>12</sup> mbështetet në harmonizimin dhe përqasjen e pikëpamjeve të ndryshme biologjike, individuale dhe sociale. Kjo teori gërsheton elementët e qartë dhe të zbatueshëm të modelit mjekësor (që fokusohet në dëmtimet dhe kufizimet në kapacitetin e personit për të vepruar) dhe modelit social (që ka në qendër kufizimet në pjesëmarrjen e personit me aftësi të kufizuara në aktivitetet arsimore, ekonomike, shoqërore, kulturore apo politike), duke mënjanuar aspektet e panevojshme dhe jocilësore të tyre.

---

12. <http://www.who.int/classifications/icf/en/>

# Pjesa e Dytë

## Kuadri ligjor dhe politikat institucionale që rregullojnë arsimin gjithëpërfshirës në Shqipëri

*Legjislacioni në fuqi ka pësuar përmirësime dhe pasurim të mëtejshëm për sa i përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe veçanërisht arsimin gjithëpërfshirës, reflektuar kjo në nënshkrimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2009), Ligjin nr. 69/2012, Për Arsimin Parauniversitar, Strategjinë e Arsimin Parauniversitar 2008-2013 (MAS, 2008), Planin e Integruar të MAS, 2010, Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015, MPCSSHB etj.*

*Me gjithë hapat pozitivë në legjislacion dhe zotimet e Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me zhvillimin e strategjive dhe planeve të veprimit ku adresohen çështjet e aftësisë së kufizuar dhe gjithëpërfshirjes, shqyrtimi i sistemit ligjor ekzistues paraqet një sërë hapësirash dhe nevojash për përmirësim për sa i përket përputhjes me Rregullat Standarde mbi Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara (Kombet e Bashkuara 1993), Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Arsimin për të Gjithë (Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit) dhe akte të tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.*

### Kushtetuta e Shqipërisë

---

*Në nenin 18 të Kushtetutës së Shqipërisë, paragrafi 2, citohet: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, kushtet ekonomike, arsimore, shoqërore ose përkatësia prindërore”.*

*Duke qenë se Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar për integrimin në Bashkimin Evropian dhe ka detyrime ligjore të cilat burojnë nga një sërë aktesh ndërkombëtare të nënshkruara prej saj, lind nevoja për përfshirjen po në këtë Nen të termit “aftësi e kufizuar”. Neni cilëson shumë kategori që nuk duhen diskriminuar, por nuk përfshin ndër to “personat me aftësi të kufizuara”. Për këtë arsye, personat me aftësi të kufizuar nuk e gjejnë veten të mbrojtur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kushtetuta. Legjitimimi në Kushtetutë i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara do të siguronte baza të forta për realizimin e gjithëpërfshirjes së tyre në jetën shoqërore dhe arsimore.*

*Neni 27,2 deklaron: “Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: [...] d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë”. Termi “i paaftë mendërisht” i përdorur në këtë nen nuk u përmbahet standardeve të gjithëpranuara të ICF-së së OBSH-së,*

të cilat mbështeten në modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar. Ndaj, përputhja e gjuhës me këtë model rekomandohet si një hap pozitiv drejt respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin shqiptar.

## **Ligji Nr. 10 221, 2010, Për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

---

**Neni 1:** “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në mënyrë që ky nen të jetë në përputhje të plotë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të njohura në aktet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara, akte në të cilat Shqipëria është palë, të tilla si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe ajo për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, ndër “shkaqet e tjera” mund të përmenden pengesat e mentalitetit dhe të shoqërisë si barrierat më të mëdha në respektimin e personave me aftësi të kufizuar.

## **Kodi Civil**

---

**Neni 9** citon që të miturve nga mosha 14 deri në 18 vjeç të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten për shkak të ndonjë sëmundjeje mendore ose prapambetjeje mendore, sipas një vendimi gjyqësor, mund t’u hiqen të drejtat për veprime ligjore. Këto veprime mund të kryhen vetëm nga përfaqësuesit e tyre ligjorë.

Përdorimi i termave “shëndet mendor” dhe “prapambetje mendore” është normë e modelit të vjetër mjekësor, model i cili është eliminuar nga të gjitha Konventat Evropiane dhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe që, së fundi, është zëvendësuar me modele të reja biopsikosociale. Teoria biopsikosociale synon të paraqesë një sërë faktorësh që ndikojnë në përmbushjen e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara të tillë si faktorët biologjikë, faktorët psikologjikë (gjendja emocionale, vetëvlerësimi) dhe faktorët socialë, duke e vënë theksin tek ndryshimi i qëndrimeve të shoqërisë, diversiteti, stigma dhe paragjykimi.

Edhe për të drejtat e tjera, të cituara në **Nenin 613**, që i referohen përgjegjshmërisë së fëmijëve me handicap fizik dhe mendor për veprimet e kryera,

terminologjia mund të rregullohet. Në radhë të parë duhet ndryshuar gjuha e përdorur, e cila bazohet tek modeli mjekësor, dhe duhet përmirësuar neni për sa i përket përgjegjshmërisë për veprimet në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, i zbatueshëm edhe në Shqipëri.

Duhet thënë se, pothuajse në të gjitha nenet e Kodit Civil në të cilat rregullohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, terminologjia e përdorur, e cila i referohet kryesisht modelit shëndetësor të trajtimit të aftësisë së kufizuar, duhet të përmirësohet dhe të njëjtësohet me atë të modelit social të praktikave të mira të gjithëpërfshirjes dhe atë të përkufizimeve të përdorura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

### **Ligji Nr. 9062, datë 8.5.2003. Kodi i Familjes**

---

**Neni 267** rregullon të drejtën e kujdestarisë në rastin e mungesës së prindërve. Në këtë nen thuhet që gjykatësi, përpara se të vendosë kujdestarinë, merr në konsideratë mendimin e punonjësit social.

Përfshirja e shërbimeve sociale dhe angazhimi i shërbimeve shumë-sektoriale në vendimmarrje është një akt i rëndësishëm dhe është në një linjë me parashikimet e akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; madje, mbështetja e vlerësimit të nevojat e fëmijës, bazuar në modelin social, është një hap i suksesshëm për sa i përket respektimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

### **Ligji për Shëndetin Mendor, 2012**

---

*Parimet e përgjithshme në ligjin e ri të miratuar në vitin 2012 janë në përputhje me aktet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë që lidhen me trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim në funksion të respektimit të dinjitetit njerëzor. Në ligj, citohen qartë të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve për riaftësim profesional, kur kushtet e tyre shëndetësore e lejojnë arsimimin.*

*Përkufizimet e përdorura në këtë ligj janë në përputhje me terminologjinë e ICF-së së Organizatës Botërore të Shëndetësisë.*

### **Ligji Nr. 69/2012, Për Arsimin Para-universitar**

---

*Ligji i ri, miratuar në Korrik të vitit 2012, shënon një hap të rëndësishëm për sa i përket të drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për qasje, pjesëmarrje të plotë dhe arsim cilësor në arsimin e detyruar dhe atë parashkollor.*

**Neni 2** i ligjit përkufizon: “Nxënës me aftësi të kufizuara është personi që ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara të cilat, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore”.

Përkufizimi në këtë nen u referohet standardeve të Klasifikimit dhe Funksionimi Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Në **Nenin 5, “E Drejta për Arsimim”**, citohet që: “Në Republikën e Shqipërisë, garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar”.

Në **Nenin 6, “Parime të përgjithshme”**, theksohet se në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve, çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor dhe shanse të barabarta për arsimim dhe nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme.

Në **Pikën 8 të këtij neni** garantohet e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe e përfaqësuesve ligjorë të fëmijëve për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t’u dëgjuar për këto pikëpamje.

Në këto nene, sanksionohet qartë e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për askes në arsim dhe edukim cilësor dhe e drejta e prindërve për t’u përfshirë në çështjet e arsimimit të fëmijëve dhe të shërbimeve të ofruara.

Në **Nenin 19**, për **Përkujdesjen për kategori të veçanta të nxënësve**, sigurohet kujdesi i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në këtë rast, ofrimi i shërbimeve ndërsektoriale rregullohet me akte normative/ dispozita normative të cilat duhet të përcaktojnë shërbimet e nevojshme për arsimimin e fëmijëve në të gjitha mjediset gjithëpërfshirëse.

**Neni 20**, për “Shërbimin psikosocial në institucionet arsimore”, thekson mbështetjen nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psikosociale dhe hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

Është i nevojshëm hartimi dhe institucionalizimi i standardeve dhe rregullave të funksionimit të këtyre shërbimeve përmes akteve normative apo udhëzimeve.

**Neni 44**, “Kurrikula. Parime të përgjithshme”, përcakton që kurrikula duhet të jetë në përputhje me ecurinë e zhvillimit fizik, mendor, shoqëror dhe etik të nxënësve dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënësve dhe duhet të hartohet dhe zbatohet në bazë të kompetencave themelore të nxënësve.

Po në këtë nen, vendoset që kurrikula, sipas niveleve arsimore dhe klasave,

hartohet dhe zhvillohet në bazë të kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar, “mishëron parimin e integritit nëpërmjet fushave të të nxënësve dhe lëndore” dhe u mundëson nxënësve “zgjedhje individuale sipas nevojave dhe interesave të tyre”.

Ky nen respekton parimet dhe praktikën e mira të arsimit gjithëpërfshirës në lidhje me zbatimin e kurrikulës së zakonshme dhe, në rastet në të cilat është e nevojshme, përshtatjen e programeve lëndore sipas fushave të të nxënësve me zhvillimin dhe nevojat e veçanta të fëmijëve dhe zbatimin e tyre në bazë të aftësive themelore të nxënësve.

**Në Kreun XI, Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, Neni 63,** Parime të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, parashikohet zhvillimi i plotë i potencialit intelektual e fizik të këtyre fëmijëve dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së tyre me qëllimin për t’i përgatitur për integrimin e plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. Po në këtë nen, citohet që përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. **Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.** Nxënësve që nuk dëgjojnë e nuk flasin u garantohej drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Braille.

Në këtë nen garantohej zhvillimi i plotë dhe cilësor i potencialit fizik dhe intelektual të tyre por vihet re konfuzion mes termave integrim dhe përfshirje në arsimin e zakonshëm.

**Neni 64,** për “Ndjekjen e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara”, paraqet kriteret dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin special dhe/ose në arsimin e zakonshëm.

Kriteret dhe standardet duhet të rregullohen përmes hartimit të dispozitave normative dhe udhëzimeve përkatëse.

**Neni 65,** për “Organizimin e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”, shpreh që nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara. Programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision në përbërje të të cilit ka mësues të institucionit të cilët u përkasin fushave të ndryshme të të nxënësve dhe psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues si dhe mjedise të përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënësve, sipas kriterëve dhe standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Përmirësimet e ndjeshme në lidhje me përfshirjen e Planeve Edukative Individuale në programet mësimore, përcaktimi i kriterëve për hartimin e tyre, përfshirja e prindërve dhe nxënësve në përshtatjen e programeve në përputhje me nevojat e veçanta të nxënësve dhe sigurimi i mësuesve ndihmës e i shërbimeve



rehabilituese janë masa reformuese për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri. Megjithatë, krahas reformimit legjislativ, duhet punuar ende edhe për hartimin e akteve normative dhe udhëzimeve përkatëse nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilat do të mbështesin zbatimin e saktë të ligjit.

### **Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 (ndryshuar në 2011) për Asistencën dhe Shërbimet Sociale**

---

Në kontekstin e këtij ligji, **Neni 4**, “Person me aftësi të kufizuara është një individ me aftësi të kufizuara për shkak të një dëmtimi fizik, shqisor, intelektual, dëmtime fiziko-mendore dhe dëmtime të tjera, të trashëguara ose të zhvilluara gjatë jetës, si rezultat i aksidenteve dhe sëmundjeve të përkohshme ose të përhershme të cilat nuk lidhen me punësimin”.

Përkufizimi i aftësisë së kufizuar duhet të jetë më i gjerë dhe të pasqyrojë shkaqe të tjera të krijuara nga shoqëria. Formulimi i termit “Aftësi e Kufizuar” sipas Rregullave dhe Standardeve mbi Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuar, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1993, si dhe në përputhje me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar vendos theksin në barrierat shoqërore të ndërveprimit dhe ato ambientale (aksesibiliteti fizik). Trajtimi i aftësisë së kufizuar jo si pengesë por si një kusht thelbësor për ndryshimin e mendësisë në shoqëri sjell nevojën për përditësimin e gjuhës së përdorur në këtë ligj.

**Neni 15** thotë që “Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit, [...] pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij”.

Në këtë nen, përcaktohet që shërbimi u ofrohet personave në bazë të vlerësimit të “gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tyre” pa përfshirë këtu aftësinë e kufizuar. Për më tepër, vihet re drejtimi mjekësor i vlerësimit të nevojës për shërbim të individit.

Organet multidisiplinare të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore<sup>13</sup> duhet të aplikojnë në metodologjinë e vlerësimit të nevojave të veçanta modelin biopsikosocial të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

---

13. Ligji nr. 8652, datë 30.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

## **Dispozitat Normative për Arsimin Para-universitar, 2002**

---

*Miratimi i ligjit të ri për arsimin parauniversitar bën të nevojshëm hartimin e dispozitave dhe akteve të reja normative në përputhje me këtë ligj.*

### **Kreu XIII, Arsimimi i Nxënësve me Nevoja të Veçanta**

**Në nenin 57, pika 1 (c)** jepet përkufizimi i nxënësit me aftësi të kufizuara: “të gjithë ata fëmijë apo të rinj që paraqesin veçori anatomo-funksionale specifike dhe për edukimin dhe arsimimin e të cilëve shkolla publike ndesh vështirësi”.

Vendosja e veçorive anatomo-funksionale të fëmijës në qendër të problematikës së arsimimit e vë theksin te modeli mjekësor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar; për më tepër, vështirësia e shkollimit të barabartë dhe cilësor të këtyre fëmijëve, ndryshe nga shokët e tjerë, shihet pikërisht në veçoritë e tyre anatomo-funksionale.

**Pika 2** thotë se arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuara realizohet në dy forma: nëpërmjet integritit të tyre në shkollat e arsimit publik (shkollat e zakonshme), në kuadrin e gjithëpërfshirjes, dhe nëpërmjet trajtimit të tyre në shkolla apo klasa publike të veçanta (speciale), sipas kategorive e specifikave që ata paraqesin, të cilat janë pjesë e rrjetit të institucioneve shkollore parauniversitare publike të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë pikë kemi përplasje të termave integrim dhe gjithëpërfshirje. Vetë neni nuk jep një orientim të qartë për mënyrën e shkollimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**Në pikën 17**, thuhet që, në zbatimin e teksteve e programeve mësimore, mbahen parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve. Zbatimi i tyre bëhet në mënyrë krijuese, sipas vështirësive që paraqesin nxënësit. Ndërsa, për nxënës të veçantë gjendja e të cilëve është nën nivelin minimal të programit mësimor ose kur nxënësi paraqet specifika krejtësisht të veçanta, do të punohet me plane edukative individuale.

Megjithëse plani edukativ individual është i përfshirë në planin mësimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, nuk ofrohen modalitetet e hartimit të tij. Gjithashtu, përveç mësuesve me eksperiencë të gjatë në arsim, është e nevojshme edhe përfshirja e psikologëve dhe/ose punonjësve socialë.

**Pika 18:** “Integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara me nxënësit e shkollave të zakonshme është një proces i domosdoshëm bashkëkohor që zbatohet në praktikën e shkollave të veçanta dhe vlerësohet si një proces i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve. Ky proces është i ndërsjellë dhe, **për raste të veçanta**, mund të kalohet në integrim të plotë”.

Ashtu si më lart, edhe në këtë pikë të nenit vihen re paqartësi në përdorimin e termave Integrim dhe Arsim Gjithëpërfshirës. Në këtë rast, “Integrimi” është përdorur në kuptimin e veçimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa të veçanta

brenda shkollës së zakonshme ndërsa “integrimi i plotë” i referohet gjithëpërfshirjes në klasat e zakonshme, duke ndarë të njëjtat aktivitete mësimore me shokët e tjerë edhe jashtë klase. Gjithashtu, nuk qartësohet në cilat raste të veçanta fëmija me aftësi të kufizuara mund të kalojë nga niveli i integritit në atë të gjithëpërfshirjes.

### **Udhëzimi Nr. 31 për vitin shkollor 2011-2012 në sistemin arsimor para-universitar**

---

**KREU IV:** “Në zbatim të objektivit të MAS-it për të siguruar të paktën një vit përgatitor për fëmijët 5-vjeçarë, përfshirë fëmijët romë, egjiptianë dhe ata nga shtresa të marginalizuara, në vitin e ri shkollor të hapen 200 klasa të reja përgatitore”.

Në këtë kapitull, nuk përmenden fëmijët me aftësi të kufizuara; kjo kategori thjesht nënkuptohet të “shtresa të marginalizuara”. Përcaktimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar si prioritet i arsimit parashkollor dhe programet ndërgjegjësuëse mbi këtë fushë janë të rëndësishme për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre fëmijëve për arsimim.

### **Urdhër Nr. 362, 2007, Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar**

---

*Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë që bën Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar aktualisht është i përbërë nga mjekë të specialiteteve të ndryshme dhe nuk përfshin në strukturën e vet profesionistë të disiplinave të ndryshme të tillë si: psikologë, punonjës socialë, terapisë etj. Kriteret dhe rregullat e vlerësimit të aftësisë së kufizuar janë të bazuara në modelin e vjetër mjekësor (që sheh si shkak të saj dëmtimin dhe paaftësinë e personit) dhe nuk marrin parasysh modelin biopsikosocial, adoptuar rishtas nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, i cili fokusohet në zvogëlimin dhe eliminimin e barrierave të mentalitetit dhe shoqërisë.*

# Pjesa e Tretë

## Strategjitë dhe Planet e veprimit

### **Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2005-2015**

---

*Strategjia për Personat me Aftësi të Kufizuara, iniciativë e Qeverisë Shqiptare dhe e shoqërisë civile, identifikon një sërë fushash prioritare dhe vendos shtatë objektiva strategjike lidhur me to:*

1. Inkurajimi dhe edukimi për një shoqëri që mundëson pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.
2. Realizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Sigurimi i arsimit optimal për personat me aftësi të kufizuara.
4. Sigurimi i mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik për njerëzit me aftësi të kufizuara.
5. Promovimi i një shërbimi publik të përgjegjshëm dhe transparent ndaj personave me aftësi të kufizuara.
6. Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara për një jetë cilësore në komunitet.
7. Mbledhja dhe përdorimi i informacionit lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe çështjet e aftësisë së kufizuar.

*Plani i Veprimit bashkëshoqërues i Strategjisë shtrihet në një hark kohor prej 10 vjetësh dhe parashikon 95 masa për rritjen e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar në fushën e edukimit, punësimit, mbështetjes dhe shërbimeve dhe krijimit të mundësive të barabarta për akses duke u përqendruar tek potencialet e tyre dhe jo te dëmtimet. Plani i Veprimit përcakton qartë shpërndarjen e përgjegjësisë dhe detyrimeve të institucioneve përgjegjëse.*

*Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të parashikuara janë Ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi, pushteti lokal dhe organizatat joqeveritare. Janë përcaktuar burimet e mundshme financiare por nuk ka një buxhet të detajuar për mbështetjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara.*

*Progros-Raportet e Komisionit Evropian për vitin 2009, 2010 dhe 2011 shprehin se zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara ka qenë i ngadaltë dhe plani i veprimit nuk është përmbushur. Ndërtimi i kapaciteteve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mekanizmave për të respektuar Strategjinë është theksuar aty si detyrë parësore e Qeverisë Shqiptare.*

## **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007)**

---

*Strategjia përfshin njëmbëdhjetë strategji ndërsektorale dhe synon nxitjen dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit në planin ekonomik, shoqëror dhe njerëzor. Strategjia përcakton qartë objektivin e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian dhe parashtron një sërë detyrash për t'u përmbushur. Integrimi në Evropë kërkon, ndër të tjera, përmirësimin e legjislacionit dhe politikave lidhur me aftësinë e kufizuar, në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe standardet evropiane për sigurimin e shanseve të barabarta dhe jetës cilësore për personat me aftësi të kufizuara. Ndaj, përmbushja e këtyre detyrave është një prioritet i qeverisë për integrim dhe zhvillim.*

## **Strategjia Ndërsektorale e Përfshirjes Sociale 2007-2013**

---

*Kjo strategji përfshin politikat dhe masat institucionale ndërsektorale dhe fokusohet në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e përjashtimit social. Strategjia parashikon një paketë masash të cilat synojnë asistencë për grupet në nevojë, shërbime komunitare për mbështetjen e familjeve si dhe fuqizimin dhe zhvillimin e personave të grupeve të përjashtuar nga shoqëria, në mënyrë që ata të shfrytëzojnë plotësisht kapacitetet e tyre dhe të kenë të drejta të barabarta, si gjithë të tjerët. Përparësi të tjera janë ngritja e kapaciteteve institucionale për hartimin e politikave për aftësinë e kufizuar, përmirësimi i legjislacionit dhe ndërgjegjësimi mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Strategjia vë theksin në fushën e grupeve në nevojë, me vëmendje të veçantë në aftësinë e kufizuar, duke planifikuar masa në drejtim të rritjes së mundësive të individëve për gjenerimin e të ardhurave (“Pagesa bazë e PAK-ut do të indekskohet çdo vit me rritjen e pagës minimale, në shkallë vendi<sup>14</sup>”) dhe duke lehtësuar aksesin për marrjen e shërbimeve dhe për përfitimin nga infrastruktura përmes ngritjes dhe vënies në funksionim të nëntë shërbimeve komunitare ditore për personat me aftësi të kufizuar në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore.*

*Në raportin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Përfshirjes Sociale 2007-2013, në lidhje me lehtësimin e qasjes ndaj shërbimeve bazë, thuhet: “Numri i individëve si fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, që kanë përfituar shërbime sociale në qendra rezidenciale ose ditore publike, është rritur me 26% në krahasim me 2007, ndërsa në qendrat jopublike ky numër pothuajse është trefishuar” si dhe “janë nxitur forma shërbimesh alternative si shtëpi-familje, shërbimi i këshillimit social etj.<sup>15</sup>”*

*Por, me gjithë shtimin në numër të qendrave sociale, numri i fëmijëve që*

---

14. Strategjia Ndërsektorale e Përfshirjes Sociale 2007-2013

15. Raporti i Monitorimit të Strategjisë Ndërsektorale të Përfshirjes Sociale, MPCSSHB, 2010.

arsimohen në shkollat e zakonshme është ende shumë i ulët dhe infrastruktura në ambientet publike dhe në shkolla është e papërshtatshme.

### **Strategjia Kombëtare e Arsimit Para-universitar 2009-2013**

---

Objektivat strategjikë të MAS-it synojnë të sigurojnë në të njëjtën kohë barazinë e shanseve dhe efektivitetin për të gjithë nxënësit dhe veçanërisht për grupet e marginalizuara si romët, fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijëve të minoriteteve<sup>16</sup>.

Po aty (Krijimi i shanseve të barabarta), thuhet në vijim: “Me mjaft kujdes duhet të trajtohen në dokumentacionin shkollor dhe në procesin mësimor zhvillimet lidhur me ratifikimin e dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare si Ligji për Barazinë Gjinore, Ndryshimet në Kodin e Familjes, natyrisht të lidhura me problematikat që i shoqërojnë”.

Në parashtrimin e këtyre objektivave, në asnjë pikë, nuk gjejmë të përmendur fëmijët me aftësi të kufizuara si grup në nevojë, përveçse në zotimin e Ministrisë së Arsimit për përmbushjen e detyrimit të projektit “Arsimi për të Gjithë” (Education For All), të miratuar edhe në rang ndërkombëtar.

Në kontekstin e përshtatjes së sistemit arsimor për diversitetin theksohet nevoja për përmirësimin e mjediseve shkollore, krijimin e kushteve optimale mësimore dhe pajisjen e shkollave me laboratorë, mjete didaktike dhe mjete të nevojshme shkollore si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për arsimimin e shtresave të marginalizuara.

Por, as këtu, nuk përcaktohen mjete dhe burime të përshtatshme për nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

### **Plani i Integruar i Ministrisë së Arsimit, 2010**

---

Plani i Integruar ka si qëllim themelor krijimin e mundësive të barabarta për çdo nxënës. Çdo fëmijë, pa përjashtim, ka të drejtë të shkollohet. Drejtimi kryesor i planit është cilësia e arsimimit e cila planifikohet të arrihet nëpërmjet masave në vijim: (1) Reformimit të kurrikulave në të gjitha nivelet me qëllim përshtatjen e tyre me realitetin ekonomik e shoqëror të vendit dhe standardet evropiane, (2) Kualifikimit të vazhdueshëm të mësuesve dhe pedagogëve - ky është një nga përcaktuesit e cilësisë, i cili do të realizohet nëpërmjet programeve mbështetëse për zhvillimin e burimeve njerëzore në arsim.

Në këtë plan janë parashikuar disa masa konkrete për realizimin e të drejtës për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit:

- Shanse të barabarta për arsimim për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë;
- Arsimim bazë për të gjithë,

---

16. Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013, fq. 32.

- Cilësi gjithnjë e më e lartë e arsimit publik dhe privat në të gjitha nivelet;
- Arsim cilësor sipas nevojave dhe interesave të individit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi e sipas standardeve evropiane.

Për sa u përket pritshmërive në vitin 2010 për arsimin bazë dhe parashkollor, nuk parashikohen indikatorë të matshëm për vlerësimin e shërbimeve lehtësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore.

## **Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015, MPCSSHB**

---

Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015 synon **(a)** Forcimin e strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve, në nivel kombëtar e rajonal dhe **(b)** Nxitjen e hartimit të politikave gjithëpërfshirëse, të koordinuara e të harmonizuara, të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve.

Objektivat dhe masat e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015 lidhur me të drejtat për mbrojtje dhe përfshirje sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të përcaktuara qartë. Në këtë dokument, shprehet dukshëm nevoja që politikat për përfshirjen e fëmijëve në procesin e hartimit të programeve mësimore vjetore të parashikohen edhe nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse, për të krijuar kushte që ata të jenë pjesë aktive e grupit të punës gjatë hartimit të kurrikulës dhe planeve të mësimin. **Disa politika dhe masa konkrete për rishikimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore do të parashikohen, duke i afruar këto më shumë me fëmijët nëpërmjet programeve integruese dhe sociale në shkolla, me synim eliminimin e plotë të braktisjes shkollore.** Kjo do të arrihet përmes përfshirjes në arsimim të të gjithë grupeve të fëmijëve, pavarësisht gjendjes social-ekonomike të familjeve të tyre, aftësive të kufizuara dhe përkatësisë në një grup etnik apo minoritar, gjë që është parashikuar të realizohet nëpërmjet përcaktimit të disa masave konkrete në përgjegjësi të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Politikat institucionale duhet të përfshijnë ndryshimet që nevojitet të kryhen në infrastrukturën shkollore dhe në përgatitjen e stafit pedagogjik për përshtatjen e kurrikulave dhe mënyrave të reja të mësimdhënies.

Plani i Veprimit parashikon masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës shkollore në zonat rurale për të siguruar që procesi mësimdhënës në këto zona të jetë në cilësinë e duhur.

Për sa i përket mësimdhënies si një tjetër prioritet i arsimit cilësor të fëmijëve, parashikohen disa masa reformuese për karrierën dhe rritjen e nivelit të kualifikimit të mësuesve si profesionistë jo vetëm të fushës së arsimit por edhe të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, reformë kjo që ndikon thellësisht në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe gjithëpërfshirjes. Informimi dhe



sensibilizimi i fëmijëve e i stafit mësimdhënës nëpër shkolla lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara konsiderohet si pikë e rëndësishme në reformën arsimore.

Objektivat dhe nënobjektivat strategjike për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës janë:

1. Krijimi i një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme.
2. Ngritja e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor për fëmijët.
3. Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin vendimmarrës në shkollë dhe jashtë saj.

*Objektivi strategjik “Krijimi i një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme” do të arrihet nëpërmjet nxitjes së qeverisjes vendore për të promovuar zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Masat për të nxitur zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme do të përqendrohen në studimin e situatës aktuale të zhvillimit të fëmijëve nga mosha 0-3 vjeç si dhe në ndërmarrjen e programeve këshilluese në lidhje me shërbimet që u ofrohen fëmijëve të kësaj moshe në çerdhe.*

*Objektivi strategjik “Ngritja e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor për fëmijët” do të arrihet përmes: (1) Përmirësimit dhe konsolidimit të vazhdueshëm të sistemit arsimor publik cilësor dhe falas në nivelet e parashkollorit dhe arsimit të detyruar; (2) Gjithëpërfshirjes në mësimnxënie, pavarësisht gjendjes social-ekonomike të familjes, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar apo vendndodhjes gjeografike; (3) Uljes së nivelit të braktisjes së shkollës.*

*Objektivi strategjik “Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin vendimmarrës në shkollë dhe jashtë saj” kushtëzohet nga nën-objektivat: (1) Pjesëmarrja e vazhdueshme dhe cilësore e fëmijëve në vendimmarrjet mbi mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor si dhe në veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës; (2) Promovimi i të drejtave të fëmijëve.*

Plani ndërsektorial i veprimit për fëmijë është një reformë e rëndësishme në procesin e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara por Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministritë e Linjës (Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme) sikurse edhe Pushteti Lokal duhet të ofrojnë fonde të mjaftueshme dhe plane të qarta monitorimi dhe vlerësimi dhe të bashkëpunojnë me Organizatat Jofitimprurëse për zbatimin konkret të tij<sup>17</sup>.

---

17. Plani i Masave për Zbatimin e Objektivave Strategjike, pjesë përbërëse e “Planit të Integruar për Fëmijë 2012-2015”, u referohet përgjegjësi të institucioneve bashkëpunuese dhe burimeve financiare të zbatimit, shpeshherë të pasaktësuara në shifra.



# Pjesa e katërt

## Konventat ndërkombëtare në fushën e Aftësisë së Kufizuar

### Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Kombet e Bashkuara 2006

---

*Konventa ka për qëllim të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe respektin për dinjitetin e tyre.*

*Shqipëria është shtet palë i Konventës prej vitit 2009 dhe, si e tillë, respekton parimet e shpallura në të dhe ka si detyrim parësor ndërmarrjen e politikave institucionale dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në përputhje të plotë me Konventën.*

Duke qenë se e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për një **arsim të barabartë dhe cilësor** është e theksuar në këtë Konventë, qeveria Shqiptare duhet të garantojë që arsimi në vend të jetë i bazuar në këto parime.

### Parime të përgjithshme:

---

Parimet konsistojnë në: respektin për dinjitetin dhe pavarësinë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale; mos diskriminimin; pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri; respektin për të qenët ndryshe dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor; mundësitë e barabarta; aksesin; barazinë ndërmjet burrave dhe grave; respektin për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar si dhe respektimin e të drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre si dhe në parimin e gjithëpërfshirjes që nënkupton zhvillimin e një shoqërie që ofron mundësi të barabarta për të gjithë.

Procesi i gjithëpërfshirjes bazohet në instrumentet ligjorë dhe politikat institucionale që u sigurojnë personave me aftësi të kufizuar përfshirjen në vend të përjashtimit dhe lehtësimin e qasjes në arsim dhe në shoqëri mbi baza barazie dhe cilësie.

Në **Nenin 24** që flet për arsimin thuhet shprehimisht: “Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Me qëllim realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, Shtetet Palë do të garantojnë një sistem arsimor përfshirës në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe

arsimin gjatë gjithë jetës me synim **(a)** Zhvillimin e plotë të potencialit njerëzor dhe ndjenjës së dinjitetit dhe vetëvlerësimit, fuqizimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe diversitetit njerëzor; **(b)** Zhvillimin nga ana e personave me aftësi të kufizuar të personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë së tyre, si edhe të aftësive të tyre mendore dhe fizike, në potencialin e tyre të plotë; **(c)** Mundësimin e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë”.

Ndërmarrja e një fushate ndërgjegjësimiti lidhur me respektimin e të drejtave të njohura nga Konventa është masë e domosdoshme për institucionet përgjegjëse në Shqipëri.

### **Konventa e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950**

---

*Konventa mbron të drejtat e çdokujt, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.*

### **Karta Sociale Evropiane, rishikuar më 1996<sup>18</sup>**

---

*Në veçanti në nenet 15, 16 dhe 17, garanton të drejtën për pavarësi, të drejtën për integrim dhe pjesëmarrje në jetën shoqërore, të drejtën e familjeve për të përfituar mbrojtje ekonomike, sociale dhe ligjore dhe të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për t'u rritur në një ambient që nxit zhvillimin e plotë fizik, mendor dhe të personalitetit.*

### **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989), ratifikuar nga Shqipëria më 1990**

---

*Ky dokument cilëson se çdo fëmijë ka të drejtën për një arsim të lirë, të barabartë dhe cilësor.*

### **Deklarata e Salamankës UNESCO, 1994**

---

*Deklarata cilëson që çdo fëmijë ka të drejtën themelore për arsim dhe duhet t'i jepet atij mundësia për të arritur dhe për të ruajtur një nivel të pranueshëm të nxëni; çdo fëmijë ka karakteristika, interesa, aftësi dhe nevoja në të nxënë unike; në hartimin e sistemeve arsimore dhe zbatimin e programeve mësimore duhet marrë parasysh larmia e madhe*

---

18. Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar këtë Akt Ndërkombëtar me Ligjin nr.8960, datë 24.10.2002, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 75, datë 22 nëntor 2002, faqe 2087.

e këtyre karakteristikave dhe nevojave. Shkollat duhet të kenë mekanizmat e duhur për luftën ndaj diskriminimit dhe arritjen e gjithëpërfshirjes.

Shqipëria është angazhuar të plotësojë të gjitha Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të OKB-së si dhe Objektivin e UNESCO-s “Arsimi për të Gjithë” brenda vitit 2015. Deklarata e Salamankës dhe Kuadri për Veprim mbi Nevojat e Veçanta në Arsim<sup>19</sup> është një tjetër dokument i rëndësishëm në këtë kontekst. Kjo deklaratë ripohon angazhimin për arritjen e Arsimit për të Gjithë, duke njohur në mënyrë të veçantë nevojën urgjente për të siguruar arsim për të gjithë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit si dhe parimin që shkollat e zakonshme duhet të mirëpresin të gjithë fëmijët.

---

19. UNESCO. (1994). Deklarata e Salamankës dhe kuadri për veprim mbi nevojat e veçanta në arsim, adoptuar nga konferenca botërore për nevojat e veçanta në arsim: Aksesi dhe cilësia, Paris.

# Pjesa e Pestë

## Rekomandime të përgjithshme

- **Legjislacioni, politikat institucionale dhe protokollin e Qeverisë Shqiptare duhet të jenë të bashkërenduar** dhe të përputhen me legjislacionin dhe rekomandimet ndërkombëtare për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për gjithëpërfshirje sociale dhe arsimore.
- **Duhet të nxitet një fushatë kombëtare ndërgjegjësimi** për informimin e prindërve, familjeve, shoqërisë dhe institucioneve përgjegjëse (institucionet arsimore, institucionet shëndetësore, shërbimet sociale, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve etj.) mbi të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të pasur një arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës në të njëjtat kushte me shokët e tjerë.
- **Infrastruktura e godinave të institucioneve arsimore** duhet të përmirësohet dhe të përmbushë standardet bashkëkohore të Dizenjos Universale<sup>20</sup> për aksesin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- **Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) duhet të ndryshojë formën dhe metodologjinë e punës**, duke përfshirë një ekip shumëdisiplinor profesionistësh. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar nuk duhet të mbështetet vetëm në diagnozat mjekësore por dhe në nevojat për arsim, rehabilitim, përfshirje socio-kulturore dhe aspekte të tjera të jetës. Për këto arsye, është i nevojshëm zbatimi i modelit biopsikosocial<sup>21</sup> për diagnostikimin dhe trajtimin e aftësisë së kufizuar. Komisioni duhet të hartojë edhe politika informuese për të informuar familjet, kopshtet, shkollat, njësitë e shërbimit social dhe mbarë opinionin publik mbi çështjet e aftësisë së kufizuar.

---

20. "Dizenjo Universale ka kuptimin e dizenjos së produkteve, ambienteve, programeve dhe shërbimeve, në mënyrë të tillë që ato të jenë të përdorshme nga të gjithë, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo për dizenjo të veçantë". Nga "dizenjoja universale" nuk do të përjashtohen pajisjet ndihmëse për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme. - Ky standard është adoptuar nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e Kombeve të Bashkuara.

21. Modeli i përcaktuar nga Klasifikimi i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit. Modeli është përqafuar edhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

- **Duhen marrë masa konkrete për rritjen e numrit të mësuesve të kualifikuar për arsimin gjithëpërfshirës.** Aftësimi i mësuesve për përfshirjen në mënyrë të barabartë dhe cilësore të çdo nxënësi, pavarësisht nevojave, mund të arrihet përmes moduleve të trajnimit për aftësinë e kufizuar, bashkëpunimit me specialistë të fushës, psikologë dhe/ose punonjës socialë, fushatave ndërgjegjësuese, hartimit dhe zyrtarizimit të procedurave dhe udhëzuesve për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme dhe vendosjes së bashkëpunimit pozitiv me mësuesit e shkollave speciale për shkëmbim eksperiencash dhe informacioni lidhur me praktikën e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara. Një parakusht i rëndësishëm për përgatitjen e mësuesve dhe specialistëve të edukimit të aftë për të punuar në shkollat gjithëpërfshirëse është përfshirja e çështjeve të aftësisë së kufizuar në kurrikulat universitare (programet 3-vjeçare dhe master) të fakulteteve të mësuesisë.
- **Ministria e Arsimit duhet të marrë masa për caktimin e mësuesve ndihmës**<sup>22</sup> në shkollat e zakonshme, të cilët të ofrojnë mbështetje dhe shërbim të specializuar për lehtësimin e pjesëmarrjes së plotë e cilësore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor dhe në veprimtaritë jashtëshkollore.
- **Decentralizimi i shkollave** në lidhje me vendimmarrjen dhe menaxhimin është një proces që lehtëson rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Decentralizimi bën të mundur që shkollat, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore, prindërit dhe grupet e interesit, të hartojnë plane të përmirësimit të procesit mësimor. Në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e shërbimeve dhe politikave arsimore, shkolla duhet të sigurojë burimet e nevojshme për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës. Për rritjen e cilësisë së arsimit, institucionet arsimore duhet të integrojnë në programet e tyre përdorimin e materialeve ndihmëse të tilla si “Indeksi për Gjithëpërfshirjen” dhe “Paketë Mjetesh për Krijimin e Mjedisve Gjithëpërfshirëse dhe Miqësore ndaj të Nxënësve (Toolkit for Creating Inclusive, Learning-friendly Environments) i UNESCO-s të cilat janë të rekomanduara edhe nga Progres-Raporti – Shqipëria 2010. Përafrimi me praktikën e mira të shkollave gjithëpërfshirëse të tilla si aplikimi i Indeksit të Gjithëpërfshirjes<sup>23</sup> është një element thelbësor në sigurimin e cilësisë dhe barazisë në arsim. Indeksi i Gjithëpërfshirjes është një paketë udhëzuese për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës duke ndërtuar struktura mbështetëse dhe nxitëse në shkollat e zakonshme. Përfshirja e Indeksit të Gjithëpërfshirjes si pjesë integrale e politikave

22. Ligji i Arsimit Parauniversitar, miratuar më Korrik 2012, Neni 65, pika 3.

23. **Indeksi për Gjithëpërfshirjen** – Mundësimi i një Rrjeti Arsimor [www.eenet.org.uk/index\\_inclusion/index\\_inclusion](http://www.eenet.org.uk/index_inclusion/index_inclusion)

(ekzistuese apo të reja) u bënë të mundur shkollave të analizojnë kulturat, politikat dhe praktikat për identifikimin e pengesave në gjithëpërfshirje si dhe të vendosin në mënyrë të pavarur prioritetet e ndryshimit dhe mënyrën e vlerësimi të progresit. Reforma e decentralizimit siguron që llogaridhënia e institucioneve arsimore<sup>24</sup> lidhur me respektimin e të drejtave dhe realizimin e arsimit cilësor për fëmijët me fëmijë të kufizuar do të jetë më transparente dhe e prekshme për përfituesit e shërbimit të arsimit.

- **Reforma kurrikulare** duhet të synojë nxitjen e aftësive/prirejve personale e intelektuale si dhe përmbushjen e nevojave të veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara. MAS duhet të rrisë kapacitetet për të siguruar mekanizmat institucionalë të nevojshëm për përfshirjen e arsimit gjithëpërfshirës në kurrikulat e përshtatura. Kurrikula bazë në shkollat e zakonshme, kur është e nevojshme, duhet të përshtatet me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kjo duhet bërë në përputhje me ecurinë e zhvillimit fizik, mendor, shoqëror dhe etik të nxënësve dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënësve<sup>25</sup>. Hartimi i Planeve Individuale Mësimore (PEI) krijon kushte lehtësuese për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përmirësimi i bashkëpunimit midis specialistëve të edukimit, të Institutit të Zhvillimit të Arsimit, të DAR-eve, ZA-ve, psikologëve, punonjësve socialë, mësuesve me eksperiencë dhe studiuesve të fushës do të mundësonte një kurrikul fleksibël, të aksesueshme nga të gjithë nxënësit, e cila të mund të plotësonte nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- **Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave** për fëmijët me aftësi të kufizuara është kusht parësor për identifikimin e barrierave përjashtuese dhe vlerësimin e treguesve të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Monitorimi i mjeteve dhe i zbatimit të masave të veprimit për përmirësimin e arsimit gjithëpërfshirës kërkon ngritjen e një sistemi të dhënash, të bashkërenduar prej të gjithë institucioneve në ngarkim. Ngritja e një sistemi të dhënash për arsimin gjithëpërfshirës duhet të mbështetet edhe në bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe aktorët e shoqërisë civile të angazhuar në fushë.

---

24. Ligji Për Arsimin Universitar, miratuar më 2012

25. Ligji për Arsimin Universitar, miratuar më 2012, Kreu VII, Neni 44

# Aneks I:

## Lista e materialeve të marra në shqyrtim për qëllim të studimit.

- *Progres-Raport – Shqipëria, Komisioni Evropian, 2009.*  
[http://ec.europa.eu/enlargement/press\\_corner/key-documents/reports\\_nov\\_2009\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/reports_nov_2009_en.htm)
- *Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar - Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2008.*
- *Progres-Raport – Shqipëria, Komisioni Evropian, 2010.*  
[http://ec.europa.eu/enlargement/press\\_corner/key-documents/reports\\_nov\\_2010\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/reports_nov_2010_en.htm)
- *Tabelat e regjistrimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri (Burimi: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës).*
- *Klasifikimi Ndërkombëtar për Funksonimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin, Organizata Botërore e Shëndetësisë.*
- *Rregullat Standarde mbi Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara, Kombet e Bashkuara, 1993.*
- *Deklarata e Salamankës për Parimet, Politikat dhe Praktikën në Arsimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.*  
[www.unesco.org/education/pdf/SALAMA\\_E](http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E)
- *Enabling Education Network (EENET)*
- *“Disability Equality In the Classroom: A human Right Issue” - Richard Rieser dhe Micheline Mason.*
- *Dakar Framework for Action - Kuadri për Veprim, Kombet e Bashkuara, 2000.*  
[www.unesco.org/education/wef/en-conf/dakfram](http://www.unesco.org/education/wef/en-conf/dakfram)
- *The Social Model of Disability – Rieser, 2001.*  
[www.inclusive-solutions.com/childrensattitudestoinclude.asp](http://www.inclusive-solutions.com/childrensattitudestoinclude.asp)
- *Kushtetuta e Shqipërisë, 2007.*
- *Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010, Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*
- *Kodi Civil, i azhurnuar në 2009.*

- *Ligji Nr. 9062, datë 8.5.2003, Kodi i Familjes.*
- *Ligji për Shëndetin Mendor, 2012.*
- *Ligji Nr. 69/2012, Për arsimin Para-universitar.*
- *Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005, i azhurnuar me Ligjin nr. 10 399, datë 17.3.2011, Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore.*
- *Dispozitat Normative për Arsimin Para-universitar, 2002.*
- *Udhëzim Nr. 31 për vitin shkollor 2011-2012 në sistemin arsimor para-universitar.*
- *Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2005.*
- *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2007.*
- *Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale, 2007-2013.*
- *Raporti i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale, 2007-2013.*
- *Strategjia Kombëtare e Arsimit Para-universitar 2009-2013.*
- *Plani i Integruar i Ministrisë së Arsimit, 2010.*
- *Plani i Veprimit për Fëmijë, 2012 2015 MPCSSHB.*
- *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Kombet e Bashkuara 2006.*
- *Konventa e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.*
- *Karta Sociale Evropiane, rishikuar më 1996.*
- *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989).*
- *Deklarata e Salamankës UNESCO, 1994.*
- *Indeksi për Gjithëpërfshirjen, ENNET.  
[www.eenet.org.uk/index\\_inclusion/index\\_inclusion](http://www.eenet.org.uk/index_inclusion/index_inclusion)*
- *Toolkit for Creating Inclusive, Learning-friendly Environments, UNESCO  
[www.unescobkk.org/education/inclusive./ilfe-toolkit/](http://www.unescobkk.org/education/inclusive./ilfe-toolkit/)*



# Faza e dytë e studimit

## Të pranishëm fizikisht në shkollë por jo pjesëmarrës në të: situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të Shqipërisë

### Parathënie

---

Pavarësisht se një vëmendje gjithnjë e më e madhe po u kushtohet të gjithë faktorëve që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara si kategoria e fëmijëve me situatën më të vështirë në grupin e përgjithshëm të fëmijëve me nevoja të veçanta, aktualisht numri i studimeve në këtë fushë është i pakët. Ky studim synon të analizojë kuadrin ligjor si dhe të mbledhë prova objektive për pasqyrimin e situatës aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla në gjithë Shqipërinë. Ai gjithashtu synon të analizojë gjetjet, prurje këto të cilat synojnë t'u vijë në ndihmë institucioneve përkatëse në hedhjen e hapave drejt përmirësimit të situatës nëpërmjet hartimit të politikave, strategjive dhe dokumenteve cilësore si masa të domosdoshme për zbatimin real të ligjit të ri për arsimin para-universitar të miratuar në qershor 2012.

Ky studim është gjithashtu mjaft aktual, sidomos sot që prioritetet e shumta të MAS-it janë në konkurrencë për burimet e kufizuara buxhetore në dispozicion. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për hartuesit e politikave në këtë ministri dhe në komunitetin joqeveritar që të kenë të dhëna empirike që orientojnë për një ndarje më objektive të këtyre burimeve. Grupi i punës që ndërmori këtë studim shpreson dhe beson se rekomandimet e tij do të kontribuojnë për një orientim më të qartë në këtë drejtim.

Studimi, në të njëjtën kohë, u shërben edhe organizatave të tjera të kësaj fushe duke i ndihmuar të kuptojnë se çfarë funksionon dhe çfarë jo, në mënyrë që ato të fokusojnë energjitë dhe burimet e tyre në çështjet e duhura.

Fokusi kryesor i studimit janë shkollat e zakonshme pasi, në përvojën e Save the Children, ato janë vendet më të përshtatshme për të plotësuar nevojën për arsim të barabartë për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Siç edhe do të sqarohet në brendësi të këtij studimi, më shumë se për shtimin e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, gjë që nuk e zgjidh përfundimisht çështjen, materiali na vjen në ndihmë për të kuptuar se, në rast se këta fëmijë ndihen të

padëshiruar e të padashur në shkollë ose nuk arrijnë të përballojnë programin, herët a vonë ata do të “dorëzohen” duke e braktisur shkollën. Për këtë ne na duhet të kuptojmë më thellë barrierat e pjesëmarrjes së plotë dhe suksesit në shkollë dhe mënyrat me të cilat ato mund të kapërcehen.

Save the Children, në bashkëpunim me një sërë organizatash të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare që veprojnë në fushën e arsimit dhe të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, prej disa vitesh është e angazhuar në punën për ndryshimin e situatës arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe krijimin e mundësive të barabarta për arsim për ta.

Ky studim, është një ndër aktivitetet kryesore në fazën hyrëse të projektit “Arsimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, një projekt i financuar nga Rajoni Friuli-Venezia Giulia dhe Save the Children Italy dhe i zbatuar në bashkëpunim nga Save the Children, Medpak dhe MAS. Projekti kërkon të adresojë dy nevoja kryesore - nevojën për të garantuar zbatimin e të drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës si dhe nevojën për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për t’u përgjigjur kësaj nevoje – prandaj, ai ndihmon në pasqyrimin e situatës aktuale të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Gjetjet e këtij studimi do të ndihmojnë në planifikimin dhe dizejnimin e studimeve të mëtejshme e ky mund të shihet si hapi i parë i një rrugëtimi të gjatë. Sigurisht, kemi përzgjedhur të paraqesim vetëm një përmbledhje të shkurtër të të dhënave dhe informacionit të mbledhur, më shumë një panoramë të situatës së përgjithshme të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin, duke u fokusuar kryesisht në zonat urbane por duke sjellë edhe një pasqyrë të dinamikave dhe realitetit të shkollave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat rurale.

Megjithatë, qëllimi kryesor i studimit nuk është pasqyrimi i situatës por analiza e saj, si e kuadrit ligjor ashtu edhe e të dhënave të terrenit, ndaj dhe të gjitha të dhënat e skanuara i janë “nënshtruar” një analize objektive dhe kjo është bërë për të kuptuar prioritetet në ndërhyrje dhe lidhjen mes faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në rritjen e cilësisë së arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, në pasqyrimin e situatës, studimi nuk identifikon vetëm barrierat dhe vështirësitë por edhe arritjet, praktikat dhe pikat pozitive të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme si dhe disa nga çështjet dhe shkaqet që i çojnë këta fëmijë drejt largimit dhe braktisjes së shkollës apo humbjes së mundësisë për arsimim.

Prurjet në studim nuk janë të natyrës konkluduese por janë një fillim i mbarë që nxit dhe gjeneron rrugë të ndryshme për ndërtimin e hulumtimeve më cilësore në të ardhmen.

Me këto të dhëna të marra në studim, do të jemi në gjendje të kuptojmë se çfarë ndodh në mjedisin përreth nxënësve me aftësi të kufizuara e më konkretisht çfarë mendon komuniteti i shkollës në përgjithësi, duke përfshirë këtu jo vetëm

stafin dhe nxënësit por edhe prindërit, si ata të fëmijëve me aftësi të kufizuara ashtu edhe ata të fëmijëve të tjerë në klasë; si shkon fëmija në shkollë; ç'ndodh me të në shkollë; si mëson ai; a gjen ndihmë në mjedisin rreth tij; a i kupton stafi kërkesat dhe nevojat e tij; a i jepet mundësi reale për pjesëmarrje; si e shohin atë nxënësit e tjerë etj. Përmbledhtazi, ne mendojmë se, për hartuesit dhe zbatuesit e politikave dhe strategjive, ky punim është “syçelje” për sa ka të bëjë me realitetin dhe faktorët që kontribuojnë në suksesin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, ai do të shërbejë për të kuptuar “zonat e errëta”, gjë që do të na ndihmojë në kryerjen e një pune më të mirë në planifikimin për këta nxënës.

Ky studim është me rëndësi edhe në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, tendenca e natyrshme e arsimit jo vetëm në vendin tonë por edhe në të gjitha vendet e tjera të rajonit dhe botës. Sigurisht që janë thelbësore, sidomos në vendet në zhvillim si Shqipëria që nuk kanë përmbytur ende cilësisht nevojat e nxënësve të tillë, kryerja e studimeve të ngjashme dhe rishikimi i këtij studimi.

## **Përmbledhje Ekzekutive**

---

Ky studim synon të përshkruajë dhe analizojë me elementë sasiorë dhe cilësorë situatën e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Me anë të analizimit të dokumentacionit dhe investigimit të përvojave dhe mjediseve arsimore në të gjitha rajonet e vendit, ky studim u jep përgjigje disa pyetjeve.

**Pyetjet kryesore** që marrin përgjigje në këtë studim janë:

- Cili është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme dhe ato speciale në Shqipëri?
- Cili është niveli i cilësisë së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara?
- Cilat janë barrierat kryesore të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme?
- Cili është niveli, organizimi dhe nevojat kryesore të strukturave dhe personave përgjegjës për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend?
- Cili është niveli i pjesëmarrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në shkolla?
- Cilat janë arsyet e braktisjes së shkollës nga fëmijët me aftësi të kufizuara?
- Cilat janë praktikat e mira, pikat e forta, sfidat dhe mundësitë për arsim gjithëpërfshirës?

**Metodologjia** e studimit ndërthur metodat sasimore me ato cilësore, meqenëse qëllimi i studimit dhe objektivat e synuar janë mjaft të gjerë dhe mbulojnë një numër të madh çështjesh.

**Gjetjet** e studimit janë të shumta. Disa nga gjetjet më të rëndësishme në studim janë:

- Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin e detyruar është shumë i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend. Në përgjithësi, ka paqartësi dhe mungesë të dhënash në lidhje me statusin arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat speciale është thuajse i barabartë me numrin e fëmijëve që ndjekin shkollat e zakonshme. Të dy sistemet e shkollave punojnë të izoluar nga njëri-tjetri, secili duke u përpjekur në mënyrë të pavarur për identitet dhe përmirësim të cilësisë.
- Në përgjithësi ka një ndryshim të dukshëm mes kërkesave të ligjit për arsimin e fëmijëve me AK dhe realitetit të zbatimit të këtij ligji në praktikë.
- Ka një numër të madh barrierash, në të gjitha nivelet, për përfshirjen e fëmijëve me AK në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.
- Cilësia e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara si në shkollat e zakonshme ashtu edhe në ato speciale është e ulët.
- Strukturat monitoruese të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë mangësi në strukturë, fonde, organizim dhe nivel njohjeje të aftësive të kufizuara.
- Edhe pse, fizikisht, një numër i konsiderueshëm fëmijësh me AK janë duke frekuentuar shkollat, niveli real i pjesëmarrjes në shkollë është mjaft i ulët dhe kjo pjesëmarrje është e vështirë.
- Ka një sërë praktikash të mira në disa shkolla pilot, të ideuara dhe zbatuara nga OJF në bashkëpunim me MAS-in.

Studimi **dhe gjetjet e tij** i nënshtrohen një analize më të thelluar në të gjitha nivelet e arsimit, nga ai monitorues në atë implementues, nga niveli i institucioneve vendimmarrëse dhe strukturave në varësi deri në nivel shkolle. Analiza përqipet të bëjë lidhjen mes fakteve dhe faktorëve kryesorë ndikues në përmirësimin e cilësisë së arsimimit të fëmijëve me AK.

**Rekomandimet** kryesore në studim:

- Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të punës ndërmjet ministrive të linjës (MAS, MPÇSSHB, MSH) dhe institucioneve lokale me qëllim koordinimin e të gjitha shërbimeve për këta fëmijë dhe familjet e tyre.
- Krijimi dhe/ose zhvillimi i mëtejshëm i dokumentacionit (hartimin e dispozitave të reja normative, hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit për përfshirjen, përmirësimin e kurrikulës etj.).
- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit që punon me fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla dhe ndërtimi i moduleve të qëllimita të trajnimit.
- Angazhimi i mësuesve mbështetës në çdo shkollë që ka fëmijë me aftësi të

kufizuara, duke i përcaktuar orët e punës së tij në bazë të nivelit të aftësisë së kufizuar dhe vështirësisë së fëmijës.

- Përshtatja e programeve nga departamentet përkatëse në universitete për t'i pajisur mësuesit e ardhshëm me njohuritë dhe praktikat e nevojshme për punën me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme.
- Ngritja në nivel rrethi e komisioneve të përbashkëta me specialistë nga njësitë shëndetësore dhe shkollat speciale dhe të zakonshme.
- Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme për aftësinë e kufizuar.
- Përfshirja, monitorimi dhe stimulimi i kopshteve dhe shkollave private në zbatimin e ligjit për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla të zakonshme.
- Realizimi i një fushate sensibilizuese në drejtim të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Realizimi i anketimeve dhe studimeve të ndryshme me qëllim krijimin e një banke të plotë të dhënash mbi nivelin dhe statusin arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara në raport me tipin e aftësisë së kufizuar, moshën, gjininë, vendin etj.

# Kapitulli I

## Sistemi Arsimor në Shqipëri

Parimet themelore të sistemit arsimor shqiptar mishërohen në Kushtetutën e Shqipërisë e cila, bashkë me ligjet kryesore, aktet ligjore dhe dokumente të tjera të rëndësishme, e konsideron sektorin e arsimit si prioritet kombëtar. Çdo qytetar në Shqipëri ka të drejtën e arsimimit në të gjitha nivelet, pavarësisht nga statusi, kombësia, gjuha, gjinia, feja, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe gjendja ekonomike.

Baza ligjore që rregullon arsimin e detyruar dhe atë të mesëm përmbledhet në ligjin për arsimin para-universitar, nr. 62/2012, miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë më 21 qershor 2012.

MAS-i është institucioni më i lartë publik administrativ në sektorin e arsimit. Ky institucion është përgjegjës për administrimin e sistemit arsimor në nivel kombëtar. MAS-i miraton dispozitat bazë për institucionet arsimore, programet shkollore dhe kurrikulën dhe jep udhëzimet për vitin e ri shkollor.

Sistemi arsimor parauniversitar në Shqipëri ka këtë strukturë:

- 1. Arsimi parashkollor** përfshin grupmoshën 3-6 vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u jepet mundësia të ndjekin klasën përgatitore. Ndjekja e kësaj klase edhe pranë shkollave të arsimit bazë ka si synim integrimin në arsimin e detyruar.
- 2. Arsimi bazë** përfshin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët. Ai zgjat 9 vjet dhe është i detyrueshëm me ligj. Arsimi fillor përbëhet nga gjashtë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë. Arsimi i mesëm i ulët përbëhet nga tri klasa, nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë. Në klasën e parë regjistrohen fëmijë që mbushin moshën 6-vjeçare deri ditën e fillimit të shkollës.
- 3. Arsimi i mesëm i lartë.** Në klasën e dhjetë të arsimit me kohë të plotë pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se 18 vjeç. Nxënësi deri në moshën njëzet e një vjeç lejohet të ndjekë arsimin e mesëm të lartë trevjeçar, kurse deri në moshën njëzet e dy vjeç arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar. Nxënësi që ka mbushur përkatësisht moshën njëzet e një vjeç në arsimin e mesëm të lartë 3-vjeçar apo njëzet e dy vjeç në atë 4-vjeçar dhe nuk ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë lejohet të vazhdojë klasën

që është duke ndjekur deri në fund të atij viti shkollor. Llojet e arsimit të mesëm të lartë janë gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi i mesëm i orientuar (“Shkolla të arsimit të orientuar” janë shkollat artistike, shkollat sportive, shkollat për gjuhët e huaja dhe shkollat për fusha të tjera të të nxënësve).

Ky sistem arsimor është i shtrirë në të gjithë vendin dhe vlerësohet si integral, në kuptimin që çdo nivel arsimor është një vijim logjik dhe i natyrshëm i ciklit të mëparshëm.

Arsimi i detyruar bazë përfshin edhe institutet e shkollat e specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

Në shumë fshatra me numër të vogël banorësh, ekzistojnë ato që quhen shkolla në varësi, të cilat kanë drejtorin të përbashkët me shkollën më të afërt 9-vjeçare. Në ciklin fillor, një mësues mbulon mësimdhënien në të gjitha lëndët. Në ato shkolla ku mësimi zhvillohet në mënyrë kolektive për shkak të mungesës së nxënësve, mësimi zhvillohet njëkohësisht në dy klasa paralele nga i njëjti mësues (p.sh. klasa e parë dhe e tretë ose klasa e dytë dhe e katërt).

Cikli më i lartë mbulon klasat 7 deri 9. Me përfundimin e tij, nxënësit i nënshtrohen provimeve në lëndët bazë dhe marrin dëftesën e lirishtimit.

Arsimi i mesëm konsiderohet mjaft i rëndësishëm në sistemin arsimor. E drejta e pjesëmarrjes në këtë nivel shkollor është një e drejtë kushtetuese. Ai zgjat në përgjithësi 3 vjet, përveç shkollave profesionale që zgjasin 4 vjet. Vitet e fundit, arsimi profesional po merr një rëndësi dhe hapësirë gjithnjë e më të madhe në këtë cikël. Me përfundimin e këtij cikli, nxënësit pajisen me certifikatën e pjekurisë.

## **Zhvillimi i Arsimit Gjithëpërfshirës në Shqipëri – Një Vështrim Konkret**

---

Përpjekjet e para për arsimin gjithëpërfshirës në Shqipëri datojnë në fillimin e viteve 1990. Në periudhën kohore 1994-2000, falë mbështetjes së një numri të madh organizatash ndërkombëtare, u aplikuan edhe projektet e para në kopshtet dhe shkollat e vendit. Edhe pse rezultatet e para ishin premtuese, për shkak të mungesës së ndihmës financiare të qeverisë, këto projekte e ulën gradualisht impaktin që kishin deri sa u ndalën krejtësisht. Në këtë periudhë, në ndryshim nga organizatat, përpjekjet më të mëdha të institucioneve drejtuese të arsimit u përqendruan në ngritjen dhe përmirësimin e kushteve në institutet dhe shkollat speciale siç ishin instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë dhe instituti i nxënësve që nuk shikojnë e shkollat speciale në rrethe të ndryshme, shkolla dhe institute të hapura që në vitet '60.

Në Dispozitat Normative për Arsimin Publik të vitit '96, për herë të parë u theksua ideja se integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme

konsiderohej një proces i pakthyeshëm dhe bashkëkohor për më të mirën e fëmijëve dhe të vetë shkollave. Gjithçka do të varej nga natyra e kurrikulës, organizimi i shkollës, gatishmëria e mësuesve dhe aftësia për t'iu përgjigjur diversitetit të nxënësve.

Në vitin '97, Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve në Tiranë ndërmoi një projekt që synoi integrimin e fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme. Paralelisht me praktikën e para integruese, u zgjua interesi për identifikimin e fëmijëve me AK në shkollë vendi dhe për njohjen reale të problemeve të tyre lidhur me arsimimin.

Në vitet 2000-2001 nis fazën e tij të parë projekti “Arsimi Special i Integruar” nga MEDPAK. Projekti arriti të ndërthurë me sukses modelin bashkëkohor të arsimit gjithëpërfshirës me përvojën tonë të edukimit në përgjithësi duke gjeneruar në këtë mënyrë një variant shqiptar të gjithëpërfshirjes. Falë tij u arrit më në fund të bëhet realitet gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme pranë vendbanimeve të tyre<sup>26</sup>.

Suksesi i projektit të mësipërm e nxiti MAS-in që, në dhjetor 2002, të aprovonte Dispozitat Normative të Arsimit Parashkollor ku përfshihet për herë të parë koncepti i arsimit gjithëpërfshirës dhe një sërë rregullash për ta bërë të mundur zbatimin e tij në praktikë. Megjithatë, këto dispozita nuk mundësonin disa nga kërkesat dhe shërbimet bazë për këta nxënës, si p.sh. prania e mësuesit ndihmës, e ekipit të hartimit të PEI-t etj.

Në korrik 2003, Save the Children dhe shoqata “Ndihamoni Jetën” nisnin një projekt që synon krijimin e një përvoje të ndërhyrjes edukative gjithëpërfshirëse më të hershme sesa arsimit i detyruar.

Në vitin 2004 miratohet Strategjia Kombëtare për PAK ku politikat për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara zënë një vend të rëndësishëm.

Me plotësimin e kuadrit ligjor, morën hov një sërë nisMAS dhe përpjekjesh për arsimin gjithëpërfshirës.

Save the Children, në bashkëpunim me Shoqatat “Ndihamoni Jetën” e MEDPAK, Drejtorinë Arsimore Rajonale të Beratit si dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, që nga viti 2004 e në vazhdim ka mbështetur procesin e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e arsimit të detyruar. Në sajë të kësaj mbështetjeje, një numër i konsiderueshëm fëmijësh me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë në qytetet Tiranë, Berat dhe Librazhd kanë përfituar një arsimim më cilësor dhe të përshtatur me veçoritë e tyre individuale. Që nga viti 2008, me kërkesën dhe mbështetjen e MAS-it, ky projekt është shtrirë edhe në tre rajone të tjera: Vlorë, Gjirokastër e Korçë.

Një tjetër hap i madh në rrugën e gjatë drejt arsimit gjithëpërfshirës ishte edhe ligji i ri, miratuar më 21 qershor 2012, që premtonte të çojë në një fazë të re përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.

---

26. Ndrio, M. “Vlerësimi i faktorëve që kontribuojnë në zbatimin praktik të arsimit gjithëpërfshirës” World Vision Tiranë 2012.



# Kapitulli 2

## Dizajni dhe Metodologjia e Studimit

*Metodologjia e studimit ndërthur metodat sasiore me ato cilësore meqenëse qëllimi i studimit dhe objektivat e synuar janë mjaft të gjerë dhe mbulojnë një numër të madh çështjesh.*

Metodologjia e përzgjedhur në këtë studim përbëhet nga dy pjesë apo faza të cilat mund të shihen edhe si dy studime më vete:

Gjatë **fazës së parë** u shqyrtua dhe analizua i gjithë kuadri ligjor si dhe programet strategjike në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Sinteza e të dhënave në këtë fazë u ndërtua duke analizuar materialet e mëposhtme:

- a. Burimet zyrtare me të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri.
- b. Legjislacionin dhe dispozitat normative që lidhen me gjithëpërfshirjen.
- c. Studimet e kryera kryesisht gjatë viteve të fundit mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri.
- d. Të dhënat/raportet nga organizma të ndryshëm mbi nivelin dhe barrierat e fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë gjithëpërfshirjes.
- e. Burime të tjera ndërkombëtare (studime a raporte rajonale ku Shqipëria është pjesë).

**Faza e dytë** e studimit u ndërtua me instrumente që synonin mbledhjen e të dhënave në terren. Me këtë qëllim u ndërtuan instrumentet e mëposhtme:

- a. Një pyetësor i strukturuar për drejtoritë dhe zyrat arsimore të rretheve kryesore në Shqipëri që synoi të marrë informacion mbi gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo rreth (infrastruktura, burimet etj). Të dhënat e marra nga ky pyetësor ishin kryesisht të natyrës sasiore.
- b. Dy pyetësorë gjysmë të strukturuar për realizimin e fokus-grupeve me një numër të madh njerëzish.
- c. Një pyetësor i strukturuar për të marrë informacion sasiore dhe cilësor nga shkollat speciale në vend.

Pyetësorët e strukturuar u pilotuan fillimisht në qytetin e Tiranës. Ata u ndërtuan me qëllim marrjen e të dhënave sasiore në një kohë të shkurtër në të gjitha shkollat e arsimit të detyruar në vend duke përfshirë këtu edhe shkollat speciale. Me anë të tyre u morën një sërë të dhënash mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla, llojet e aftësisë së kufizuara në kopshte dhe shkolla, barrierat infrastrukurore dhe nevojat.

Mbledhja e të dhënave cilësore (nga disa kategori/grupe të përfshirë në gjithëpërfshirje) mbi realitetin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla të zakonshme të vendit synoi një të kuptuar më të thellë të realitetit duke eksploruar pyetje të tilla si: çfarë ndodh në mjedisin rreth nxënësve me aftësi të kufizuara? Cilat janë barrierat kryesore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme? Cilat janë nevojat kryesore në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara? Cili është qëndrimi i faktorëve të ndryshëm në shkollë lidhur me përfshirjen e këtyre fëmijëve në të? Cilat janë perceptimi, roli, sjellja dhe njohuritë e stafit për sa i përket edukimit dhe arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollën e tyre? Cilat janë pikat pozitive të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme? Në ç'mënyra ndikon te të tjerët prania e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme?

## **Qëllimi dhe objektivat e studimit**

---

Qëllimi i studimit është eksplorimi dhe analizimi i situatës së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri duke u fokusuar kryesisht në barrierat dhe vështirësitë e kësaj situatë. Për arritjen e këtij qëllimi u ndërtuan objektivat e mëposhtëm:

- a. Të evidentohet numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme dhe speciale në Shqipëri.
- b. Të eksplorohet niveli i cilësisë së arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- c. Të eksplorohen barrierat kryesore të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.
- d. Të identifikohen niveli, organizimi dhe nevojat kryesore të strukturave dhe personave përgjegjës për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend.
- e. Të vlerësohet niveli i pjesëmarrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në shkolla.
- f. Të identifikohen arsyet e braktisjes së shkollës nga fëmijët me aftësi të kufizuara.
- g. Të identifikohen praktikat e mira, pikat e forta, sfidat dhe mundësitë për arsim gjithëpërfshirës.

## **Kampioni i studimit**

Në studim morën pjesë një numër i madh personash. Pyetësi i parë i strukturuar u shpërnda në të gjitha DAR/ZA-të në vend. Pyetësi i dytë i strukturuar

u shpërnda në të gjitha shkollat speciale në vend.

Në kampionimin e fokus grupeve, për një përfaqësim sa më cilësor u përdor “Teknika e Përfshirjes në Shkallë të Gjerë” (Broad Involvement Design)<sup>27</sup>.

Në bazë të kësaj teknike kampionimi, **përzgjedhja e kampionit të fokus-grupeve u realizua në bazë të numrit të kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare për çdo qark dhe 8 kategorive të përzgjedhura të fokus-grupeve (të listuara më poshtë).**

Numri i përgjithshëm i fokus grupeve të realizuara në të gjithë vendin ishte 29. Ky numër i fokus grupeve nuk është bazuar vetëm tek numri i kopshteve dhe shkollave por edhe tek numri i përgjithshëm i mësuesve dhe nxënësve në çdo qark.

Pjesëmarrësit në fokus-grupe ishin drejtorë shkollash, mësues, nxënës dhe prindër. Në bazë të hartës dhe të dhënave për shkollat publike 9-vjeçare, në çdo fokus-grup u përzgjedh një numër maksimal prej 10 pjesëmarrësish. Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bë në bashkëpunim me DAR-et duke i dhënë prioritet shkollave dhe pjesëmarrësve që kanë një përvojë të konsiderueshme në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara.

#### **Kategoritë e përzgjedhura të fokus grupeve ishin:**

- **Kategoria nr. 1** – Mësuesit e kopshteve dhe shkollave të zakonshme
- **Kategoria nr. 2** – Nxënësit e shkollave të zakonshme
- **Kategoria nr. 3** – Prindërit e nxënësve pa aftësi të kufizuar
- **Kategoria nr. 4** - Drejtorët e shkollave të zakonshme
- **Kategoria nr. 5** – Përfaqësues të DAR/ZA-ve përkatëse
- **Kategoria nr. 6** – Prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- **Kategoria nr. 7** – Përfaqësues të MAS + IKAP + IZHA
- **Kategoria nr. 8** – Specialistë që punojnë me fëmijët me AK

Për mbledhjen e të dhënave cilësore, autorët intervistuan edhe një numër personash kyç (specialistë arsimit, drejtues dhe specialistë pranë MAS-it dhe institucioneve në varësi të tij) në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe vizituan edhe 12 shkolla të zakonshme dhe speciale, të përzgjedhura rastësisht ose që ishin pjesë e projekteve pilot për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të zakonshme.

---

27. Teknika e Përfshirjes në Shkallë të Gjerë është një ndër katër tipat e dizenjimit të fokus grupeve. Ky tip dizenjimi përdoret kryesisht në studime me interes të gjerë publik. Ai mundëson pjesëmarrje të të gjithë grupeve që kanë lidhje me fenomenin në studim duke i dhënë prioritet grupit që është burimi kryesor i mbledhjes së të dhënave. Edhe grupet e tjera përfshihen në fokus grupe por në një shkallë më të vogël.

## **Analiza e të dhënave**

---

Studimi sjell një numër të konsiderueshëm të dhënash me natyrë sasiore dhe cilësore. Të dhënat e mbledhura gjatë studimit janë analizuar në këtë mënyrë:

- Të dhënat sasiore, të mbledhura me anë të pyetësorëve të strukturuar, me ndihmën e programit SPSS janë analizuar duke përdorur elementë të statistikës deskriptive.
- Të dhënat me natyrë cilësore, të mbledhura kryesisht me anë të fokus-grupeve dhe intervistave, janë analizuar duke përdorur metodën e analizës së përmbajtjes.

# Kapitulli 3

## Gjetje të studimit – një vështrim i situatës nga terreni

### Hyrje

---

Ky kapitull reflekton gjetjet më të rëndësishme që ekipi kërkimor arriti të nxirrte nëpërmjet përdorimit të një sërë metodave për mbledhjen e informacionit gjatë procesit të kërkimit:

Aktualisht në Shqipëri praktikohen sistemet e arsimit gjithëpërfshirës, integrues dhe special për fëmijët me aftësi të kufizuara, edhe pse dallimet mes arsimit gjithëpërfshirës dhe atij integrues në disa raste nuk njihen as nga drejtues e specialistë të DAR/ZA-ve. MAS-i, prej shumë vitesh, ka ndërtuar një sistem shkollash speciale ndërsa disa OJF po zbatojnë projekte për promovimin e sistemit gjithëpërfshirës. Aktualisht, në Shqipëri ka 7 shkolla speciale dhe 2 institute respektivisht për nxënësit që nuk shikojnë dhe ata që nuk dëgjojnë. Sistemi i shkollave gjithëpërfshirëse është prezantuar vetëm gjatë viteve të fundit në vend dhe po aplikohet në formë pilotimi nga OJF-të. Sipas të dhënave të MAS, një numër i vogël shkollash gjithëpërfshirëse janë duke u pilotuar nga Save the Children dhe Medpak. Gjatë viteve të fundit, ka pasur edhe përpjekje të tjera të organizatave të ndryshme, kryesisht në nivel lokal, për kategori të përziera ose vetëm për një kategori specifike të aftësisë së kufizuar por të dhënat mbi këto projekte shpesh mungojnë ose nuk janë gjithmonë plotësisht të besueshme.

Ekipi kërkimor mësoi shumë mbi barrierat në gjithëpërfshirje, sistemin monitorues, veçoritë dhe dinamikat kryesore të përfshirjes në zona dhe vende të ndryshme të vendit si dhe praktikat më të mira të pilotuara në Shqipëri në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Të dhënat sasiore të studimit janë bazuar kryesisht në të dhënat e marra nga Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e politikave të zhvillimit për arsimin para-universitar në nivel rajonal, menaxhimin e burimeve njerëzore, sigurimin e cilësisë në shkollat publike dhe jopublike si dhe organizimin e certifikimit të mësuesve në rajon përmes bashkëpunimit me institucionet e specializuara. Numri i tyre është 14 dhe shtrihen në 12 qarqe të vendit. Për një përfaqësim sa më mbarëkombëtar të të dhënave si dhe për të kuptuar veçoritë e zonave urbane dhe atyre rurale, pyetësorët u shpërndanë edhe në Zyrat Arsimore (ZA), të vendosura në 24 bashki të vendit, që janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ, menaxhimin e burimeve njerëzore,

grumbullimin e informacionit statistikor, mbikëqyrjen e klasave dhe veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare dhe menaxhimin e burimeve financiare.

### **3.1. Të dhëna statistikore për fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare në Shqipëri**

Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e detyrueshëm është 2,400 (duke përfshirë edhe nxënësit me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollat speciale). Ky numër përbën vetëm 0.5% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar<sup>28</sup>.

Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dallohen kategoritë e mëposhtme të aftësisë së kufizuar: mendore, fizike (lëvizore), mendore dhe fizike, pamore, dëgjimore, e të folurit dhe autizëm.

Bazuar në kategorizimin e mësipërm dhe në të dhënat e marra nga pyetësi i shpërndarë pranë çdo DAR/ZA-je për fëmijët e regjistruar në arsimin parashkollor dhe atë 9-vjeçar për vitin shkollor 2011-2012, kemi mundur të ofrojmë statistikën e mëposhtme lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara:

#### **3.1.1 Numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të zakonshme sipas të dhënave të DAR/ZA-eve.**

*Tabela 1. Në këtë tabelë paraqitet numri dhe përqindja e fëmijëve me AK në raport me numrin e përgjithshëm të fëmijëve që ndjekin arsimin e zakonshëm.*

<b>Numri dhe përqindja e fëmijëve me AK në raport me numrin total të fëmijëve që ndjekin arsimin e zakonshëm</b>	
Numri i fëmijëve me AK në kopshtet e zakonshëm	511/103,492 0.49%
Numri total i fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme 9-vjeçare	3167/472891 0.64%
Numri total i fëmijëve me AK në arsimin e zakonshëm	3678/576383 0.63%

28. <http://www.instat.gov.al>

**Tabela 2. Tabela e shpërndarjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e zakonshëm (kopshte dhe shkolla) – paraqitur në përqindje**


<b>Shpërndarja e fëmijëve me AK që ndjekin arsimin e zakonshëm në kopshte dhe shkolla (%)</b>	
Numri i fëmijëve me AK në kopshte	13,89%
Numri i fëmijëve me AK në shkolla	86,11%
Total	100%

Siç edhe shihet në tabelat e mësipërme, numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të vendit është 3678 nga të cilët 511 në kopshte dhe 3167 në shkolla 9-vjeçare.

Fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshte përbëjnë 0.49% të të gjithë fëmijëve të regjistruar në kopshte për vitin shkollor 2011-2012. Fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën 9-vjeçare në vitin shkollor 2011-2012 përbëjnë 0.64% të të gjithë nxënësve të regjistruar.

Në grafikët e mëposhtëm, kemi dhënë këtë raport mes numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe numrit total të fëmijëve në kopshte dhe shkolla sipas DAR/ZA-ve.


**Grafiku Nr. 1:** Numri i fëmijëve me AK përkundëjt numrit total të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe shkolla sipas DAR-eve



### 3.1.2 Fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte, sipas të dhënave të raportuara nga DAR/ZA-të, është **511**. Në këto të dhëna bie në sy që fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshtet e qytetit të përbëjnë Tiranës 29% të të gjithë fëmijëve me AK të regjistruar në të gjithë vendin.

**Grafiku 2 .** Grafiku i shpërndarjes së fëmijëve më AK në kopshtet e zakonshme




### 3.1.3 Fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat 9-vjeçare të zakonshme

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat 9-vjeçare të zakonshme, i raportuar nga DAR/ZA-të, është 3167.

Përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat 9-vjeçare në të gjithë vendin, sipas DAR/ZA-eve, është:


**Grafiku 3 .** Grafiku i shpërndarjes së fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme





### 3.1.4 Të dhëna statistikore për fëmijët me aftësi të kufizuara sipas kategorive të aftësisë së kufizuar

**Grafiku nr. 4:** Numri dhe përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla 9-vjeçare sipas kategorive të aftësisë së kufizuar



Ky kategorizim, i raportuar nga ekspertët përgjegjës të DAR-eve në vend, merr në konsideratë ata fëmijë me aftësi të kufizuara që janë diagnostikuar zyrtarisht nga komisionet mjeko-ligjore dhe jo numrin e dyshuar të fëmijëve që paraqesin aftësi të kufizuara por nuk janë të diagnostikuar. Sipas të dhënave të marra nga pyetësorët dhe fokus grupet, numri i fëmijëve që paraqesin tregues të aftësisë së kufizuar por që nuk janë të diagnostikuar është më i madh se numri i fëmijëve të raportuar si të tillë në grafikët e mësipërm.

Ndërkohë, mungojnë të dhënat mbi fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët nuk ndjekin arsimin parashkollor dhe atë të detyruar as në shkollat e zakonshme e as në shkollat speciale.

#### **Besueshmëria e të dhënave statistikore**

Pjesa më e madhe e specialistëve që plotësuan pyetësorët u pyetën, gjatë intervistave dhe fokus-grupeve, mbi mënyrën e plotësimit të të dhënave dhe besueshmërinë e tyre. Në përgjithësi, specialistët e intervistuar u shprehën se kanë pasur shumë vështirësi dhe pasiguri në plotësimin e të dhënave. Mënyra me të cilën ata i kanë mbledhur të dhënat na vjen nga raportet e drejtuesve të çdo kopshti dhe shkolle të rrethëve të përfshira në studim. Në shumë rrethe, kategorizimi i aftësisë së kufizuar i dhënë nga MAS është i paqartë dhe ka mbivendosje të dhënash sidomos për kategori të tilla si aftësia e kufizuar mendore dhe fizike, aftësia e kufizuar në të folur dhe autizmi. Një pjesë e drejtuesve të shkollave p.sh.

kanë numëruar të njëjtin fëmijë si në kategorinë e autizmit ashtu edhe në atë të aftësisë së kufizuar në të folur dhe asaj mendore. Shpesh, drejtuesit e shkollave por edhe specialistët përkatës në DAR/ZA nuk i njohin specifikat dhe kriteret e çdo kategorie. Një tjetër faktor i rëndësishëm në uljen e besueshmërisë është fakti që termat diagnostikues të përdorur nga komisionet mjeko-ligjore që vlerësojnë kategorinë e aftësisë së kufizuar janë të ndryshëm nga kategoritë e aftësisë së kufizuar që aplikohen nga MAS-i.

Megjithatë, të dhënat e mësipërme statistikore sjellin informacione të reja në fushën e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe synojnë të nxjerrin në pah treguesit bazë, tendencën dhe përhapjen e aftësisë së kufizuar në kopshtet dhe shkollat e zakonshme në Shqipëri.

### **3.2. Barrierat kryesore në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme**

---

Arsimimi i fëmijëve në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të vendit pengohet nga një numër i madh barrierash në mësim dhe pjesëmarrje. Këto barriera janë strukturore, pedagogjike, konceptuale, profesionale, financiare dhe sjellore. Ato gjenden brenda vetë nxënësve, brenda shkollave, brenda sistemit arsimor, brenda familjeve dhe brenda kontekstit më të gjerë ekonomik, politik dhe social.

Barrierat e manifestojnë veten në mënyra të ndryshme dhe bëhen më të qarta vetëm kur shfaqet dështimi i mësimin, kur nxënësit braktisin shkollën apo kur nuk hyjnë fare në të.

Ndërthurja e instrumenteve sasiorë dhe cilësorë të përdorur në këtë studim ka mundësuar përfitim të një numri të madh gjetjesh lidhur me barrierat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e detyruar.

Aksesi në kontekstin e shkollës ka të bëjë me aksesin fizik (rampa, tualete dhe nevoja të tjera aksesit), aksesin në komunikim (gjuha e shenjave, materialet mësimore në Braille) si dhe aksesin në kurrikul. Gjetjet, në këtë studim përpiqen të pasqyrojnë të tre këta tipa të aksesit.

#### **3.2.1 Infrastruktura dhe mjedisi fizik**


Edhe pse ka pasur përshtatje në infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave (kryesisht në qytete), gjë që ka si qëllim lehtësimin e aksesit në mjediset e klasës dhe të shkollës, në përgjithësi, infrastruktura ekzistuese nuk është mikpritëse dhe e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në pjesën më të madhe të shkollave, kjo përshtatje e infrastrukturës ka mbetur te vendosja e rampave në hyrjen e shkollës dhe vetëm në katin e parë por jo në katet e tjera. Janë të rralla kopshtet dhe shkollat që ofrojnë infrastrukturë të përshtatshme për fëmijët me

aftësi të kufizuara.

Të dhënat e mëposhtme, të marra nga specialistët e DAR/ZA-ve, japin këto statistika për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla:

## Transporti Distanca shtëpi-shkollë

**Grafiku 5.** Distanca shtëpi-shkollë për fëmijët me AK (e matur në metra)



Në aksin horizontal paraqitet distanca e raportuar nga DAR-et

Në aksin vertikal paraqitet përqindja e fëmijëve me AK që udhëtojnë nga shtëpia për në shkollë.

Distanca fizike nga shkolla në shtëpi, e matur në metra, që fëmijëve me aftësi të kufizuara u duhet të përshkojnë rezulton të jetë 500-2000m në 62.5% të rasteve dhe 3000-4000m në 15.6% të rasteve ndërsa 9.4% e të pyeturve i referohen distancës si normale pa e specifikuar konkretisht në njësi matëse (duke nënkuptuar një distancë që nuk i kalon 500 m).

Ka edhe raste të rralla si ai i një fëmije me aftësi të kufizuara në Mallakastër i cili duhet të përshkojë 14km për të mbërritur në shkollë.

Edhe pse 37.5% e fëmijëve me aftësi të kufizuara shkojnë në shtëpi në këmbë, në mbi 85% të rasteve ata janë të shoqëruar nga një person tjetër i cili mund të jetë një familjar ose një shok i shkollës.

Megjithatë, nga të dhënat e marra nga fokus-grupet, del se mungesa e transportit nuk shihet si një barrierë madhore në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme në qytete. Kjo barrierë duket se ndikon ndjeshëm familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat rurale, sidomos në zonat më të thella ku gjendet edhe numri më i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara që

nuk ndjekin asnjë lloj arsimimi. Për arritjen e këtyre fëmijëve ka përpjekje kryesisht nga shkollat speciale, siç është shembulli i shkollës speciale në Durrës që çdo ditë ofron transportin për një numër të madh të nxënësve të shkollës (rreth 25 nxënës) që vijnë nga zonat rurale. Por, mungesa e fondeve bën që, në përgjithësi, as shkollat speciale të mos e ofrojnë këtë shërbim për fëmijët me aftësi të kufizuara në zonat rurale dhe sidomos ata në zonat e largëta me infrastrukturë rrugore të dobët.

### **3.2.2 Gjendja fizike e godinave të kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare**

Përfaqësuesit e DAR/ZA-ve raportojnë se 35% e të gjitha godinave të kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare i plotësojnë kushtet për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këtë cilësi të godinave drejtuesit e kopshteve dhe shkollave e lidhin me rinovimin e godinave dhe ristrukturimin e tyre ndërkohë që i vetmi element i përshtatjes së mjediseve të godinave që ata përmendin janë rampat. Në fare pak raste raportohen edhe përshtatje të tualeteve.

Vëzhgimet dhe intervistat e kryera në një numër të madh kopshtesh dhe shkollash të zakonshme publike në vend tregojnë se godinat nuk janë të përshtatura dhe mikpritëse për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në shkollat e vizituara, përveç rampave që ishin të vendosura në hyrje të shkollës, elementët lehtësues mungojnë. Për këtë arsye, fëmijët me aftësi të kufizuara fizike vendosen në klasat e katit të parë të shkollës; katet e tjera nuk janë të aksesueshme.

Pjesa më e madhe e drejtuesve të kopshteve dhe shkollave nuk arrijnë të identifikojnë çfarë është e nevojshme të përshtatet në godinë për të mundësuar përfshirjen e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Infrastruktura e godinave të kopshteve dhe shkollave është kompetencë e bashkive dhe komunave të cilat në pyetësor shprehin si arsye kryesore për mungesën e përmirësimit të kushteve të infrastrukturës pamundësinë financiare.

### **Klasat dhe numri i nxënësve për klasë**

Në përgjithësi, klasat nuk përshtaten për t'u bërë më të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara (nuk kanë një vendosje të përshtatshme të bankave, dysheme jo të rrëshqitshme etj.). Në shkollat e zakonshme, përveç pak shkollave në disa qytete që janë pjesë e një projekti për arsimin gjithëpërfshirës, mungojnë klasat burimore, mjediset mbështetëse apo klasa të tjera të veçanta.

Përfaqësuesit lokalë raportojnë se kanë kërkuar mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara duke përfshirë këtu edhe hapjen e klasave burimore por ende nuk e kanë gjetur këtë mbështetje.

Klasat nuk janë të mëdha, gjë që shpesh vështirëson aksesin dhe lëvizjen për fëmijët me aftësi të kufizuar fizike; ato janë të mbipopulluara sidomos në zonat urbane ku mesatarja e përgjithshme e fëmijëve për klasë në disa raste i kalon 32 nxënës. Nuk janë të pakta rastet në të cilat numri i nxënësve në klasë shkon

mbi 40<sup>29</sup>. Në një pjesë të mirë të shkollave mësimi në klasa zhvillohet me turne. Kjo ngarkesë e bën shumë të vështirë lëvizjen dhe hapësirën personale në klasë, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike dhe pamore.

### **Mjetet, pajisjet dhe teknologjia ndihmëse**

Drejtuesit e DAR-eve pohojnë se, në mbi 60% të kopshteve dhe shkollave, mjetet mësimore nuk janë në përputhje me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe, në mbi 25% të rasteve, gjendja e mjeteve mësimore dhe pajisjeve është pjesërisht e përshtatshme.

Akomodime të tilla si instruksione në gjuhën e shenjave dhe instruksione dhe materiale mësimore në Braille për fëmijët me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe shikim nuk zbatohen.

Të dhënat e marra në fokus grupe dhe intervista sjellin edhe detaje të tjera për t'u përmendur. Në shumë raste, mësuesit përpiqen të përshtatin mjedisin dhe të përdorin pajisjet ndihmëse që mund të kenë në dispozicion si kompjuterat laptop të shkollës, makinat llogaritëse dhe programe të caktuara.

### **3.2.3 Dokumentacioni**

Mësuesit bëjnë kujdes të veçantë në mbajtjen e dokumentacionit për fëmijët me aftësi të kufizuara që u kërkohet nga drejtuesit e shkollës apo specialistët e inspektorët. Megjithatë, në shumicën e rasteve ata nuk shënojnë në këto dokumente punën reale të bërë me këta fëmijë, e janë të paktë mësuesit që shënojnë në ditar a pasqyrojnë objektivisht në fletore punën që kryejnë realisht me këta fëmijë për të identifikuar hapat dhe arritjet e tyre gjatë viteve shkollore. Edhe më i ulët është numri i atyre mësuesve të cilët dokumentojnë në një dosje të veçantë të gjithë punën e bërë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Si pasojë, në shumicën e rasteve, e gjithë përvoja dhe arritjet e fëmijës “humbasin” me ndërrimin e mësuesit. Në dëftesën përfundimtare, që është dokumenti zyrtar i vlerësimit përfundimtar, nuk pasqyrohet asgjë nga puna me objektivat në 3 nivele<sup>30</sup>; si pasojë, mësuesi nuk ka mundësi të pasqyrojë punën dhe vlerësimin për fëmijën me aftësi të kufizuara.

---

29. Sipas Udhëzimit Nr. 21, datë 23.07.2010 të MAS, “klasa e parë formohet me jo më pak se 30 nxënës ndërsa klasat e tjera formohen me jo më pak se 32 nxënës”: <http://vet.al/files/ligje%20etj/Udhezimi%20Nr%2021%20Per%20normat%20e%20punes%20mesimore%20etj.pdf> . Shifra të larta këto krahasuar me standardet evropiane në përgjithësi: <http://www.teachingexpertise.com/articles/learning-about-education-from-our-european-neighbours-3203>

30. Instituti i Zhvillimit të Arsimit sugjeron që mësuesit të hartojnë objektivat mësimore në 3 nivele. Për nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale a me vështirësi në të nxënë kërkohet që mësuesi të vendosë objektiva minimale që mbulojnë rreth 30% të objektivave të programit.

### 3.2.4 Cilësia e arsimimit në arsimin e detyruar

#### Kurrikula

Një ndër barrierat më shqetësuese për nxënësit me aftësi të kufizuara është kurrikula e kjo lidhet së pari me natyrën jo fleksibël të saj, gjë që pengon përmbushjen e nevojave të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kurrikula është shumë “e rënduar” për fëmijët e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

Një ndër pengesat kryesore për aksesin në kurrikul të fëmijëve me aftësi të kufizuara është mospajisja me materiale e mjete të përshtatshme. Pengesat bëhen edhe më të mëdha për nxënësit me aftësi të kufizuar të rënduar të cilët nuk kanë teknologji ndihmëse e cila do t’i pajiste ata me elementët e nevojshëm për pjesëmarrjen në procesin e të nxënës. Si pasojë, mësuesit e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore shpesh “hartojnë” kurrikula dhe plane mësimore duke i fokusuar objektivat kryesisht në aftësitë për jetën dhe bazat e shkrimit dhe leximit.

Një tjetër gjetje me rëndësi është edhe mungesa thuajse e plotë, si në shkollat e zakonshme ashtu edhe në ato speciale, e teksteve mësimore të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara si p.sh. tekstet me shkronja të mëdha, tesktet e thjeshtuara apo me materiale suplementare, tekstet në Braille etj. I vetmi përjashtim është instituti i nxënësve që nuk shikojnë ku përdoren tekste në Braille.

Mësuesit nuk kanë një udhëzues për përshtatjen e kurrikulës për nxënësit me aftësi të kufizuara. Mësuesit gjenden shpesh në dilemën nëse duhet ta përshtatin atë për fëmijët me aftësi të kufizuara apo të ndërtojnë diçka nga e para. Mësuesit e intervistuar shprehin vështirësitë e mëdha që hasin në këtë proces, sidomos në ciklin e lartë 9-vjeçar e veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara mendore shumëfishe apo me autizëm. Shumica e mësuesve theksojnë se kurrikula është e bazuar në përmbajtje e jo në ndërtimin e aftësive dhe e orientuar kah provimet dhe se duhet realizuar brenda një kufiri të caktuar kohor. Për disa nxënës me aftësi të kufizuara, kurrikula e ofruar në shkollat e zakonshme nuk është e përshtatshme sepse ata nuk do të jenë asnjëherë në gjendje të marrin provimet e lirit. Kurrikula kthehet kështu në një recetë për dështimin e cilësisë së arsimimit. Mësuesit sugjerojnë që për këta nxënës të ketë një tjetër kurrikul e cila t’i ndihmojë ata në aftësitë për jetën e përditshme.

Për ndërtimin e planeve individuale mësuesve u vjen në ndihmë edhe botimi “Objektivat minimale të të nxënës”<sup>31</sup>. Megjithatë, mësuesit e kanë të vështirë të përshtatin objektivat minimale të të nxënës, sidomos për nxënësit me aftësi të kufizuar të theksuar.

Aktualisht, Ministria e Arsimit është në përfundim të një procesi të gjatë të

---

31. Llambiri S. Objektivat minimale të domosdoshme të të nxënës : braktisja e fshehtë Tiranë; Tetovë Albas, 2004

hartimit të një kurrikule të re. Por, edhe pse një ndër parimet kryesore mbi të cilat mbështetet kjo kurrikulë është parimi i gjithëpërfshirjes, parim ky që synon të ndërtojë një kurrikulë e cila i krijon mundësi të barabarta për sukses individual çdo nxënësi dhe që tekstualisht shpreh se “kurrikula duhet të njohë, të pranojë, të respektojë dhe t’u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja”, duket se ajo nuk ka marrë mjaftueshëm në konsideratë nevojat mësimore të nxënësve me aftësi të kufizuara në mjediset e shkollave të zakonshme. Nga një vlerësim fillestar i dokumenteve të kurrikulës së re, vërehet se ende nuk ka një udhëzues mbi si duhet t’i realizojnë mësuesit objektivat e kërkesat e kurrikulës për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndërkohë që, nga ana tjetër, programet mësimore mbeten ende të mbingarkuara - dhe kjo rezulton kryesisht për shkak të mbizotërimit të njohurive krahasuar me proceset dhe aftësitë e të nxënësve - si dhe, në shumë raste, tejkalojnë aftësitë moshore të nxënësve për përpunimin e informacioneve.

Dështimi në mësim shfaqet në mekanizmat që përdoren për të vlerësuar arritjet mësimore. Sistemi i vlerësimit dhe provimeve nuk është i përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. Provimet dhe vlerësimet bëhen vetëm formalisht dhe provimet zyrtare të fëmijëve me aftësi të kufizuar intelektuale ka raste që plotësohen nga vetë mësuesit ose nga nxënësit e tjerë sepse teza është e njëjtë për të gjithë nxënësit dhe jo e përshtatur me mundësitë dhe nivelin zhvillimor të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Mësuesit janë konfuzë lidhur me standardet dhe kriteret të cilat duhet të mbështeten për vlerësimin objektiv të këtyre fëmijëve. Në konfidencë mësuesit na treguan raste në të cilat fëmijë me aftësi të kufizuara, edhe pse nuk dinin të shkruanin dhe të lexonin, kishin kaluar provimin e lirit dhe kishin përfunduar “me sukses” shkollën 9-vjeçare.


### **Njohja dhe ndërtimi i planeve edukative individuale**

Të dhënat e marra nga të gjitha DAR-et raportojnë se 71.9% e mësuesve i njohin dhe i hartojnë PEI-të dhe vetëm 12.5% e tyre nuk i njohin dhe nuk i hartojnë.

Vlen të theksohet se të dhënat që vijnë nga ZA-të janë cilësisht të ndryshme nga të dhënat që vijnë nga DAR-et (veçanërisht ato të ZA-ve të Lezhës, Krujës, Hasit, Kolonjës dhe Kurbinit); sipas këtyre të dhënave, PEI-të jo vetëm që nuk njihen nga mësuesit por nuk konsiderohet as e nevojshme që të njihen.

Në mbi 50% të rasteve në të cilat realizohen, PEI-të hartohen nga vetë mësuesit kujdestarë, ndërkohë që në 25.8% të rasteve hartohen nga mësuesi dhe nga psikologu i shkollës.

**Grafiku nr. 6:** Përqindja e PEI-ve sipas personave që i hartojnë



Megjithatë, ka një sërë problemesh që lidhen me hartimin e PEI-së. Rrethe të ndryshme aplikojnë formate të ndryshme, kjo në varësi të organizatës që ka kryer trajnimin e tyre; madje, në disa raste, këto formate janë të ndryshme edhe mes shkollave të të njëjtit rreth.

Cilësia e formatit në shumë raste është e dobët, nuk ka lidhje me kërkesat dhe formatin e programit e në të përfshihen pak objektiva mësimorë. Një pjesë e mësuesve (rreth 35%) nuk kanë marrë asnjë trajnim për ndërtimin e tyre, kurse pjesa tjetër, edhe pse janë trajnuar, kanë vështirësi të mëdha në këtë proces.

Të intervistuarit nxorën në pah edhe faktin se ka një dallim të madh mes objektivave të shënuar në planet individuale dhe punës reale për arritjen e këtyre objektivave. Në përgjithësi, këto plane hartohen më shumë për të qenë “në rregull” me dokumentacionin dhe inspektimet sesa për të ofruar një mësimdhënie cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

### **Organizimi i orës së mësimin dhe metodat e mësimdhënies**

Të dhënat cilësore të studimit siguruan informacion të vlefshëm mbi mënyrën e organizimit të orës së mësimin dhe metodat e mësimdhënies. Në përgjithësi, mësuesit përdorin ende metoda pasive mësimdhënieje<sup>32</sup>; detyrat për nxënësit janë individuale dhe ka pak ose aspak detyra në grupe të vogla, dyshe ose në grupe të mëdha. Mësimi zhvillohet ende me në qendër mësuesin, sidomos në zonat rurale ku mësuesit akoma përdorin stilin autoritar të mësimdhënies dhe komunikimit. Mësimi përmendësh dhe jo në mënyrë kritike, mungesa e shkëmbimit të ideve dhe

32. Metoda pasive mësimdhënieje konsiderohen metodat me në qendër mësuesin



mungesa e punës praktike janë akoma praktika të zakonshme.

Çdo orë mësimi është 45 minuta, kohë në të cilën mësuesi pyet nxënësit, shpjegon mësimin e ri dhe jep detyra. Mësuesit shprehen se e kanë të pamundur që në një kohë kaq të shkurtër të bëjnë punë të pavarur edhe me nxënësit me aftësi të kufizuara. Përshtatja e mësimin, e detyrave dhe e kërkesave të tjera për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duket se në terma realë është e pamundur. Nxënësit qëndrojnë gjatë gjithë orës së mësimin në banka, mundësisht pa zhurmë dhe pa shumë mundësi komunikimi me njëri-tjetrin dhe lëvizjeje. Një numër i madh mësuesish në kopshte dhe në ciklin e ulët të arsimit të detyruar, me qëllim mbajtjen “urtë” në klasë të fëmijës me aftësi të kufizuara, e angazhojnë atë me detyra të tilla si vizatime, shkrim e “detyra” të ngjashme thuhet gjatë gjithë orës mësimore. Ka një mungesë të theksuar komunikimi mes fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mësuesve. Kjo lidhet kryesisht jo me mungesën e vullnetit për komunikim mes tyre por me paafësinë dhe mungesën e informacionit që kanë si mësuesit ashtu edhe nxënësit e tjerë të klasës në drejtim të komunikimit efektiv dhe cilësor me fëmijët me aftësi të kufizuara. Për sjelljen e fëmijës me aftësi të kufizuara kanë “përgjegjësi” jo vetëm mësuesit por edhe nxënësit, sidomos shoku i bankës që ndërhyr vazhdimisht për të rregulluar sjelljen e fëmijës me aftësi të kufizuara. Në shumë raste, shokët jo vetëm kujdesen për sjelljen e nxënësit me aftësi të kufizuara por e ndihmojnë, të inkurajuar nga mësuesi, edhe në detyrat mësimore si p.sh. nxjerrjen e librave dhe fletoreve, fokusimin në detyrën e kërkuar etj.

Mbështetja dhe menaxhimi i sjelljes së disa nxënësve gjatë orës së mësimin është një shqetësim i madh për stafin e shkollës por edhe për prindërit dhe komunitetin. Shumica e mësuesve të intervistuar nuk kanë ekspertizën e nevojshme për të menaxhuar këto sjellje dhe shumë zona kanë mungesë ekspertësh a njësisht të specializuara pranë DAR-ve dhe ZA-ve për të menaxhuar si duhet sjelljet sfiduese. Si pasojë, pezullimet apo përjashtimet janë praktika që zënë vend gjithnjë e më shumë në shkolla, sidomos për nxënësit që nuk janë vlerësuar dhe nuk njihen ligjërisht si persona me aftësi të kufizuara.

Në përgjithësi, nxënësit me aftësi të kufizuar mbahen gjatë gjithë orës në klasë dhe, në rastet emergjente (sjellje e papërshtatshme, vajtje në tualet etj.), mësuesi ose një nga nxënësit i shoqërojnë jashtë klase. Ndonjëherë, për ta shoqëruar, thirret në ndihmë roja ose pastruesja e shkollës.

*“U përpoqa shumë t’i mësoj lexim, shkrim dhe numërim Ermalit. Falë kësaj, ai arriti deri diku sukses por më pas e pata të pamundur. Shpesh e lija të luante me lodra ose e lija të vizatonte. Në mungesë të kohës për të punuar veçmas me të, të paktën përpiqesha që ai të merrej me diçka e të mos trazonte të tjerët dhe procesin mësimor. Nuk kisha ç’të bëja tjetër në ato kushte”.*

Mësuese e ciklit fillor, Vlorë

## **Stigma dhe diskriminimi**

Fëmijët me aftësi të kufizuara përjetojnë stigmë dhe abuzim verbal në shkollë dhe në komunitetin përreth. Prindërit shprehen se nuk janë të pakta rastet në të cilat fëmijëve u vihen epitete nga më fyeset nga nxënës të tjerë. Në shumë raste, fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla të zakonshme bëhen pre e talljeve dhe sharjeve. Siç edhe u shpreh një prind i një fëmije të diagnostikuar me sindromën down:

*“Shpesh, përpara se të hyj në shkollë për të marrë djalin, fshihem te porta kryesore dhe shoh si sillen me të pa qenë e pranishme unë apo mësuesja. Nuk e keni idenë se si e shohin, sikur të vinte nga ndonjë planet tjetër. ...Një ditë u ndjeva shumë keq kur, gjatë pushimit të madh, në një moment kur ai po qëndronte me një shok klase, vjen një nxënës më i rritur i cili fillon ta thërrasë “bisha” duke qeshur me zë të lartë. ...Megjithatë, më erdhi mirë kur më vonë mora vesh se shoku i bankës së djalit kishte raportuar te mësuesja këtë incident dhe ndaj nxënësit ishte marrë masë”.*

Prind nga Tirana

Edhe motrat e vëllezërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk i “shpëtojnë dot” ngacmimeve të bashkëmoshatarëve. Prindërit gjithashtu raportojnë se marrin shpesh mesazhe të qarta ose të fshehura që shprehin keqardhje, siç edhe na tha prindi i një fëmije me autizëm: “Të gjithë më thonë ose ndryshojnë shprehjen e fytyrës për të më thënë ‘sa keq, po më vika vërtet keq’”.

### **3.2.5 Faktorët pengues në gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme**

Instrumentet e përdorura në studim na njohën me një numër të tjerë faktorësh pengues në nivel shkolle për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

#### **Faktorë që lidhen me mësuesit**

Suksesi varet nga shumë faktorë por një rol kyç në proces kanë mësuesit, aq më tepër në shkollat shqiptare ku roli i tyre është mjaft ndikues dhe direktiv ndaj nxënësve.

Të dhënat e marra kryesisht në fokus-grupe me mësuesit nxorën në pah faktorët e mëposhtëm:

- I. Mungesa e njohurive dhe praktikave integruese për fëmijët me aftësi të kufizuara.** Thujse të gjithë mësuesit e intervistuar shprehen për mangësi në njohuritë dhe praktikat që lidhen me mësimdhënien për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Mësuesit e shkollave nuk kanë marrë gjatë studimeve të tyre njohuri mbi mënyrat e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa të zakonshme. Disa nga nevojat e ngutshme për trajnim që ata përmendën kishin të bënin me:

- Njohuritë mbi mënyrën e menaxhimit të sjelljes së fëmijëve me aftësi të kufizuara e në veçanti mbi teknikat e punës për menaxhimin e sjelljes së fëmijëve me autizëm, hiperaktivitet dhe aftësi të kufizuar intelektuale.
- Marrjen e njohurive dhe plotësimin e nevojës për ekspertizë në planifikimin dhe ndërtimin e planeve të individualizuara.
- Teknikat pedagogjike për të diferencuar dhe përshtatur mësimdhënien për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Njohjen e teknologjisë ndihmëse dhe programeve të veçanta për mësimin e gjuhës së shenjave dhe të leximit Braille.

Tema të tjera më specifike me interes për mësuesit do të ishin:

- Hartimi dhe administrimi i testeve individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara bazuar në aftësitë e tyre specifike dhe nivelin e arritjeve akademike.
- Ndihma e shpejtë dhe menaxhimi i situatave emergjente (p.sh. për një nxënës me epilepsi).
- Organizimi i klasave me në qendër nxënësin, sidomos për mësuesit e ciklit të lartë të arsimit të detyruar ku kurrikula është më e ngurtë e ku shumica e nxënësve me AK fillojnë të dështojnë.
- Puna në grup me psikologët e shkollave dhe prindërit.
- Ndihma dhe planifikimi i punës për përfshirjen e fëmijëve të tjerë në ofrimin e ndihmës fëmijëve me aftësi të kufizuar, në klasë dhe në aktivitetet jashtë saj.

Të dhënat e marra nga pyetësorët tregojnë se trajnimi i mësuesve në lidhje me integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ka qenë prioritet i MAS-it dhe organizatave të tjera që punojnë në këtë fushë. Sipas të dhënave të marra nga DAR-et, të gjithë drejtuesit e kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare në zonat urbane kanë marrë gjatë 3 viteve të fundit të paktën dy trajnime që lidhen me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar, kurse rreth 80% e mësuesve raportohet të kenë marrë të paktën një trajnim.

Megjithatë, trajnimet kanë qenë kryesisht të karakterit njohës dhe ndërgjegjësues dhe vetëm në pak raste kanë qenë të fokusuara në teknika dhe praktika pune që lidhen me këta fëmijë. Mësuesit kanë njohuri të përgjithshme mbi nevojat e veçanta por kjo nuk është e mjaftueshme. Shumica e mësuesve nuk janë trajnuar me cilësi për menaxhimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, gjë që edhe ka ndikuar në cilësinë e arsimit të këtyre fëmijëve.

MAS dhe IZHA, institucioni i vetëm kombëtar përgjegjës për trajnimin e mësuesve, ende nuk kanë zhvilluar një paketë trajnimi mbi mënyrën e integritit

të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe klasa të zakonshme. Në nivel DAR-esh, legjislati u njehtë këtyre të fundit të drejtën për menaxhimin e aktiviteteve të trajnimit të mësuesve. Megjithatë, deri më tani, shumica e trajnimeve për gjithëpërfshirjen janë mundësuar kryesisht nga organizatat jofitimprurëse në marrëveshje me IZHA-n dhe autoritetet rajonale. Përfaqësues të IZHAs pohojnë se trajnimet e shkurtra të realizuara nga ky institucion gjatë vitit arrijnë të përfshijnë vetëm një numër të vogël mësuesish dhe nuk arrijnë të mbulojnë të gjitha çështjet dhe nevojat në fushën e gjithëpërfshirjes.

Në shumicën e shkollave shihet nevoja e trajnimit të mësuesve në metodologjitë e mësimdhënies efektive për nxënës të ndryshëm. Mësuesit e intervistuar shprehin se përballen me shumë sfida në mësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale.

*“Sa herë që e ngarkoj pak, ai fillon të stresohet dhe përpiqet të kafshojë veten. Më duhen minuta të tëra për ta qetësuar”.*

Mësues nga Korça

Vlen të theksohet se, në më të shumtën e rasteve, trajnimet e marra nuk janë pasuar nga një periudhë mentorimi për të vlerësuar se sa të zbatueshme janë në praktikë.

Pavarësisht se trajnimet dhe workshop-et mbeten burimi kryesor i informimit dhe rritjes së cilësisë së mësuesve për sa ka të bëjë me nxënësit me aftësi të kufizuara, mësuesit shprehin se, përveç trajnimeve, të dobishme kanë qenë edhe tekstet a broshurat informuese të OJF-ve mbi gjithëpërfshirjen, planet individuale, organizimin e shkollës dhe komunikimin me prindërit.

Për të vlerësuar situatën e kurrikulave universitare, grupi i punës intervistoi përfaqësues të fakulteteve dhe departamenteve në universitetet kryesore të vendit studentët e të cilave janë të profilizuar për të punuar në sistemin arsimor. Në përgjithësi, kryesisht gjatë vitit të fundit akademik, universitetet kanë reflektuar mbi nevojën e përfshirjes së lëndëve që lidhen me mësimdhënien për fëmijët me nevoja të veçanta në përgjithësi dhe me aftësi të kufizuara në veçanti.

Disa nga lëndët e integruara rishtazi janë: “Pedagogji speciale”, që bëhet kryesisht në nivelin master të studimeve, dhe “Aftësi e kufizuar”, që bëhet në vitin e fundit të ciklit të parë të studimeve.

Megjithatë, shumica e pedagogëve të lëndëve të mësipërme hasin vështirësi në zbatimin e modeleve dhe teorive ndërkombëtare në realitetin dhe kushtet e shkollave në Shqipëri.

Në dallim nga universitetet e tjera të vendit, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” prej vitesh është duke ofruar një nga programet më cilësore, në përputhje me përvojat dhe nivelet më të mira ndërkombëtare, në fushën e pedagogjisë së specializuar. Aktualisht, departamenti i Edukimit në këtë universitet ofron edhe

diploma të nivelit të parë dhe diploma të nivelit master në fushën e pedagogjisë së specializuar. Edhe studentët e nivelit të parë në Mësuesi (arsimi parashkollor dhe fillor) kanë pjesë të kurrikulës së tyre punën me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme.

Vlen të theksohet se, në të gjitha universitetet, po planifikohen përshtatjet e kurrikulës në drejtim të përgatitjes së studentëve të këtyre fakulteteve për të qenë të aftë të punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe përputhja e saj me tendencat e praktikat më bashkëkohore në fushën e arsimit special. Kjo tendencë nuk po pasqyrohet vetëm në universitetet e vizituara por edhe në shumë universitete të tjera private të cilat kanë vlerësuar të nevojshme pajisjen e mësuesve të ardhshëm me njohuritë dhe praktikat e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Duke përmbledhur, falë trajnimeve të marra, por jo vetëm, koncepti i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk është i panjohur për shumicën e mësuesve por, deri tani, ai nuk ka marrë vëmendjen e duhur në kurrikulën universitare për mësuesit e ardhshëm dhe nuk është zbatuar dhe koordinuar mjaftueshëm në trajnimin e mësuesve.

2. Një tjetër faktor pengues të mësuesit është **mungesa e motivimit të tyre**. Më konkretisht, pagat e ulëta, moszbatimi i ligjit për mësuesit që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasë (mësuesit thonë që nuk po marrin pagesë ekstra për punën që bëjnë me këta fëmijë, nuk përfitojnë ulje të numrit të fëmijëve në klasë etj. siç është parashikuar në ligj<sup>33</sup>) dhe mungesa e vlerësimit nga prindërit a stafi drejtues janë disa nga faktorët kryesorë demotivues.
3. Një tjetër faktor pengues për t'u theksuar lidhet me fenomenin **burn-out**. Në intervistat e shumta me mësuesit, u vu re se ata shpesh shpreheshin: “jemi të dërrmuar... tejlodhur... mbingarkuar... kur shkojmë në shtëpi nuk kemi fuqi të bëjmë asgjë...”. Prania e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në kushtet me të cilat përballen mësuesit (mungesa e kushteve dhe mjeteve, mbingarkesa mësimore dhe e numrit të fëmijëve, puna nën stres, punët e dyta për shkak të kushteve ekonomike etj.) është shpesh, siç edhe dikush prej mësuesve e shprehu, “qershia mbi tortë”.
4. Pengesë është edhe **metoda tradicionale e mësimdhënies** në shkollat e zakonshme.

---

33. Sipas dispozitave normative, mësuesit që kanë në klasë nxënës me aftësi të kufizuara duhet të marrin shtesë page, ndërsa, për çdo nxënës me aftësi të kufizuar, numri i nxënësve në klasë ulet me 3.

5. Paragjykimet e mësuesve ose prindërve të nxënësve të tjerë në klasë janë një tjetër pengesë. Disa mësues nuk besojnë në konceptin e edukimit gjithëpërfshirës dhe as në kapacitetet e potencialet e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Disa mësues shprehen: “...Këta fëmijë [fëmijët me AK] nuk janë për ne... Më mirë t'i dërgoni në shkollë speciale...”, “...Është e kotë të lodhesh me ta... Na shkon munda kot...”.
6. Së fundi, një faktor pengues janë edhe gabimet në procesin e gjithëpërfshirjes (që kanë të bëjnë me metodologjinë, cilësinë e mbështetjes, qëndrimet e stafit drejtues të shkollës etj.)

### **Faktorë pengues që lidhen me drejtuesin e shkollës**

Fokus-grupet e realizuara me drejtuesit e shkollave identifikuan pengesat e mëposhtme që lidhen me ta:

1. Mungesë e njohurive në fushën e gjithëpërfshirjes;
2. Paragjykime dhe qëndrime negative ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, sidomos fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale. Skepticizëm për të ardhmen e tyre në shkollë;
3. Aftësi të dobëta ose mungesë aftësish menaxheriale;
4. Lëvizje e shpeshtë dhe ndryshim i stafit drejtues të shkollës nga Drejtoria Arsimore;

### **Faktorë pengues që lidhen me prindin**

Edhe vetë familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara shprehën një sërë arsyesh që pengojnë suksesin e fëmijës së tyre në shkollë, ndër të cilat mund të përmenden:

1. Varfëria, kushtet e pamjaftueshme ekonomike dhe mungesa e punësimit të prindërve (edhe në shumë studime të tjera<sup>34</sup> është parë korrelacion i ndjeshëm mes faktorëve ekonomikë dhe pjesëmarrjes së këtyre fëmijëve në shkollë apo braktisjes së shkollës nga ana e tyre);
2. Distanca e madhe nga shkollë, kryesisht në zonat rurale, si dhe cilësia e rrugëve që janë plotësisht të pafavorshme për fëmijët me aftësi të kufizuara;
3. Niveli i ulët i informimit dhe i ndërgjegjësimit të prindërve lidhur me të drejtën e fëmijës së tyre për arsim;
4. Qëndrimet negative dhe turpi i prindërve për aftësinë e kufizuar të fëmijës;
5. Qëndrime dhe sjellje mbrojtëse të tejskajshme të prindërve;
6. Mospërfshirja në nivelin e duhur të prindërve dhe të komunitetit në procesin arsimor dhe gjithëpërfshirës.

---

34. [http://www.unicef.org/albania/Successful\\_experiences\\_of\\_hidden\\_drop-out\\_approach-Alb06-13.pdf](http://www.unicef.org/albania/Successful_experiences_of_hidden_drop-out_approach-Alb06-13.pdf)

### **Faktorë pengues që lidhen me vetë fëmijët me aftësi të kufizuara**

Intervistat e shumta me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe me një numër fëmijësh me aftësi të kufizuara na njohën me faktorë të ndryshëm që pengojnë qëndrimin e këtyre fëmijëve në shkollë dhe jo rrallë bëhen shkas për largimin e tyre nga shkolla. Të gjitha këto shkaqe mund të përmbledhen si më poshtë:

- Aftësitë e varfra për lëvizje dhe komunikim të fëmijës me aftësi të kufizuara;
- Vetëvlerësimi i ulët dhe frika për t'u përballur me sfidat;
- Paragjykimet që vetë fëmijët me aftësi të kufizuara kanë kundrejt fëmijëve të tjerë në shkollë (“Ata [fëmijët pa AK] nuk dinë të komunikojnë dhe të sillen me ne”, “Gjithë klasa qesh sa herë unë flas”);

### **Faktorë pengues që lidhen me nxënësit e tjerë të shkollës (pa aftësi të kufizuar)**

Në fokus-grupet e organizuara me nxënësit pa aftësi të kufizuara, ata u shprehën se janë të ndërgjegjshëm për praninë e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollë dhe se i pranojnë ata sepse kjo është një e drejtë e tyre. Ata theksuan që, në shumicën e rasteve, kënaqen me praninë e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe i mbështesin në aktivitete të ndryshme. Kështu, ata përmendën raste në të cilat shtojnë karrocën për nxënësit që kanë aftësi të kufizuara fizike, u kthejnë faqet e librit kur ata lexojnë, i shoqërojnë në mjedise të shkollës dhe kujdesen për ta në pushim të madh etj.

### **Megjithatë, ndër faktorët kryesorë të identifikuar si pengesa tek nxënësit e shkollës pa aftësi të kufizuara janë:**

- Paragjykimet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, kryesisht ndaj atyre me aftësi të kufizuara të natyrës intelektuale.
- Mungesa e njohurive dhe aftësive për të komunikuar dhe bashkëpunuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Bulizmi i ushtruar ndaj fëmijëve me AK

### **Faktorë pengues që lidhen me prindërit e fëmijëve të tjerë dhe komunitetin në tërësi**

Prindërit e nxënësve të tjerë të shkollës që nuk kanë aftësi të kufizuara janë faktor i rëndësishëm në përshpejtimin ose ngadalësimin e praktikave integruese. Duket se paragjykimet e tyre dhe mungesa e trajnimeve dhe e informacionit për këta prindër dhe për komunitetin në përgjithësi janë një faktor i madh pengues për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.

### **3.2.6 Mungesat si barriera në gjithëpërfshirje**

Përveç faktorëve të mësipërm pengues u identifikuan edhe një numër i madh mungesash në nivel shkollë të cilat përbëjnë barriera për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Ndër këto mungesa përmendim si më të rëndësishmet këto në vijim:

- mungesa e mësuesit mbështetës;
- mungesa e mësuesve të arsimit special;
- mungesa ose pamjaftueshmëria e shërbimeve të përshtatshme. Një figurë e rëndësishme është ajo e psikologut të shkollës, një shërbim i pranishëm në zonat urbane por jo në ato rurale. Por sipas mësuesve dhe prindërve, edhe në shkollat ku ky shërbim ofrohet, cilësia e tij është larg standardeve të kërkuara; kjo për shkak jo vetëm të mungesës së aftësive dhe instrumenteve vlerësuese por edhe të numrit të madh të shkollave dhe nxënësve që një psikolog duhet të mbështes<sup>35</sup>. Shkolla nuk ofron shërbime të tjera të natyrës mbështetëse ose terapeutike<sup>36</sup>;
- mungesa e strategjive mbështetëse të shkollës (mungesë e planifikimit nëpërmjet analizës së situatës);
- mungesa e burimeve, hapësirave dhe mjeteve të nevojshme;
- mungesa e aftësive teknike dhe logjistike të stafit të shkollës;
- mangësitë në koordinimin dhe bashkëpunimin e stafit arsimor në hartimin e PEI-ve, shkëmbimin e informacionit etj.);
- mungesa e fondeve të shkollës të nevojshme për të përmbushur objektivat e PEI-t.

### **3.3 Saga e dështimit - Rrugëtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme**

---

Të dhënat e marra nga pyetësorët dhe nga fokus-grupet e intervistat e shumta me të gjithë faktorët e përfshirë në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara na kanë ndihmuar të krijojmë një “hartë” të rrugëtimin të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e detyruar, nga kopshti në klasën e 9-të. Dinamikat e këtij rrugëtimi, veçoritë dhe vështirësitë e hasura dhe të kuptuarit e momenteve kyçe të tij janë gjetje me mjaft interes të cilat ndihmojnë të gjitha nivelet përgjegjëse për ta kthyer këtë udhëtim në një përvojë gjithnjë e më pozitive, ashtu siç e meriton

---

35. Për më shumë informacion mund t'i referoheni edhe studimit “Raport i vlerësimit të shërbimit psikologjik shkollor”, Tamo, A., Kamani, P., Nano, V., Tahsini, I., & Agolli, I., Tiranë, 2006.

36. Në shumë vende, shërbimet e ndryshme rehabilituese/terapeutike si p.sh. logopedia, fizioterapia, etj. ofrohen në mjediset e shkollës (në përputhje me PEI-n e fëmijës).



çdo fëmijë dhe familje. Në këtë hartë të rrugëtimit, të ndërtuar kryesisht falë fokus-grupeve me drejtues, mësues dhe prindër, gjetjet janë fokusuar kryesisht në ecurinë dhe dinamikat kryesore që shoqërojnë fëmijët me aftësi të kufizuar gjatë fazave kryesore të arsimimit të detyruar. Vendimmarrja për të filluar këtë udhëtim dhe fillimi i tij, edhe pse ndër momentet më të vështira për familjen dhe vetë fëmijën me aftësi të kufizuar e të shoqëruara me mjaft ankth, nuk lehtësohen nga shkolla e madje hasin pengesa serioze. I gjithë rrugëtimi është plot të papritura sepse shkollat nuk kanë një plan, procedura, struktura dhe shërbime të qarta në ndihmë të gjithëpërfshirjes së këtyre fëmijëve.

### **3.3.1 Mosha parashkollore**

#### **Regjistrimi në kopsht – fillimi i një udhëtimi të vështirë**

Regjistrimi i fëmijës në një kopsht publik a privat është një ndër momentet më të rëndësishme për prindërit sepse, në shumicën e rasteve, është prezantimi i parë real i fëmijës me komunitetin. Prindërit janë plot dilema për vendimmarrjen dhe, siç shprehen edhe vetë, “është një proces i mbushur me frikë dhe shpresë...”, “proces në të cilin ndihemi vetëm...”. Në qytetet më të mëdha të vendit ka qendra të ndryshme në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuar specialistët e të cilave i këshillojnë prindërit lidhur me rëndësinë e kopshteve në përmirësimin e aftësive të fëmijëve. Ndërkohë, në qytetet e vogla dhe në fshatra këto qendra dhe specialistë thuhet se mungojnë plotësisht.

Megjithatë, një numër gjithnjë e më i madh prindërisht, kryesisht në zonat urbane, janë duke vendosur t’i regjistrojnë fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara në kopshte të zakonshëm, publikë ose privatë.

Regjistrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet publike has në një numër të madh problemesh dhe vështirësish. Këto vështirësi lidhen jo vetëm me procedurat dhe dokumentacionin por edhe me një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me prindërit, stafin dhe përvojat e mëparshme.

Rrugët që prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar gjejnë për të regjistruar fëmijën janë të ndryshme: një pjesë e tyre, duke qenë të informuar lidhur me numrin e vogël të fëmijëve që përballojnë kopshtet publike, kërkojnë dhe gjejnë ndihmë në njohjet personale që kanë me stafin apo njerëz të tjerë përgjegjës në MAS dhe DAR-e; të tjerë, të bindur për pamundësinë e suksesit dhe duke pasur mundësi ekonomike, i regjistrojnë fëmijët në kopshte private ku nuk hasin probleme me regjistrimin; të tjerë provojnë t’i regjistrojnë fëmijët sipas procedurave që kërkon ligji.

Nga intervistat u vu re se një numër i madh prindërisht të fëmijëve me aftësi të kufizuar vendosin të mos japin informacion mbi aftësinë e kufizuar të fëmijës së tyre dhe kjo në përgjithësi lidhet me dy arsye kryesore: një pjesë e këtyre prindërve (në këtë kohë) janë në një fazë mohimi të plotë të aftësisë së kufizuar të fëmijës, ndërsa një pjesë më e vogël nuk informon për shkak të “...frikës së mospranimit

dhe keqtrajtimit të fëmijës...” (siç thotë një prind nga Vlora).

Një numër i vogël të intervistuarish deklarojnë se u është dashur të bëjnë presion mbi stafin e kopshtit publik për të regjistruar fëmijën e tyre të cilin nuk e kanë pranuar për shkak të aftësisë së kufizuar, mungesës së kushteve në kopshte për këta fëmijë apo numrit të lartë të fëmijëve.

*“Kam shkuar deri te një miku im në MAS për ta zgjidhur këtë punë... sepse, sapo u thosha për vështirësitë që kishte djali, fillonin e më nxirrnin lloj-lloj pretextesh për të mos ma pranuar, duke më sorollatur nga një kopsht në tjetrin”.*

Prind nga Tirana

Në pak raste, vendimi për regjistrimin në një kopsht të zakonshëm ka qenë këshillë e mjekëve dhe specialistëve të tjerë të zhvillimit, sidomos në rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore dhe gjuhësore.

Duket se më të lehtë këtë vendimmarrje e kanë prindërit të cilët kanë një përvojë të ngjashme me fëmijët e tyre me AK në çerdhe, edhe pse kalimi nga çerdhja në kopsht është një proces shumë i vështirë për pjesën më të madhe të prindërve dhe fëmijëve.

Një pjesë e prindërve, të cilët kanë mundësi ekonomike, vendosin të regjistrojnë fëmijët në kopshte jopublike. Disa nga arsyet kryesore që ata rendisin për këtë vendim janë: numri shumë i madh i fëmijëve në një dhomë në kopshtet publike, frika e neglizhimit të fëmijës dhe e pamundësisë së stafit për të punuar në mënyrë të veçantë me të, privatësia më e madhe e fëmijës në kopshtin privat etj.

Ka shumë raste prindërisht që i regjistrojnë fëmijët me AK në kopshte publike edhe pse kanë mundësi ekonomike të përballojnë një kopsht privat. Arsyet më kryesore për këtë vendim janë: besimi te kontrolli më i madh në kopshtet publike, njohja personale e edukatores ose drejtoreshës së kopshtit dhe shërbimet e specializuara si ai i psikologut dhe mjekut peditër.

Një numër i madh prindërisht, kryesisht nga qytetet e vogla dhe zonat rurale, vendosin të mos i dërgojnë fëmijët në kopsht por t'i mbajnë në shtëpi. Grupi i punës ndeshi edhe raste të prindërve me nivel të lartë arsimor dhe status të lartë shoqëror (figura të njohura dhe respektuara në komunitet) dhe nga zonat kryesore urbane të vendit të cilët vendosin t'i mbajnë në shtëpi fëmijët me aftësi të kufizuara.

### **Dokumentacioni për regjistrimin në kopsht**

Dokumentet e nevojshme për regjistrimin në kopshtet publike janë: certifikata e lindjes, certifikata e vaksinimeve dhe vërtetimi që tregon se je banor i lagjes në të cilën ndodhet kopshti publik. Prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuar nuk kanë detyrim të paraqesin dokumente që verifikojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës. Në

qytetin e Tiranës regjistrimi bëhet pranë zyrave të DAR-it. Kjo praktikë shihet si pozitive nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara sepse, në këtë mënyrë, ata mund t'i regjistrojnë fëmijët e tyre të lirë nga barrierat e ndryshme që karakterizojnë procesin në qytetet ku regjistrimi kryhet nga drejtuesja e kopshtit. Nga të kundërt, disa drejtoresha kopshti, e shohin këtë praktikë si të papërshtatshme pasi nuk u jep atyre mundësinë të refuzojnë regjistrimin në kopsht të këtyre fëmijëve.

*“Para disa vitesh i regjistronin drejtoreshat fëmijët nëpër kopshte dhe ne i shihnim vetë ata kur vinin për të bërë regjistrimin. Dhe e dallonim që ai fëmijë ishte autik dhe nuk e pranonim. Por, ne i bënim disa sugjerime, duke i thënë se janë disa kopshte të specializuara... Kur prindi ngulmonte, atëherë i thosha ‘a tregon fëmija kur shkon në tualet? ...a flet?’...që të gjenim një arsye për ta larguar. E vërteta është që jo se nuk i duam por nuk kemi fare kushte për t'i mbajtur”.*

Drejtoreshë kopshti, Tiranë

Megjithatë, nga ana tjetër, kjo praktikë ka sjellë probleme të shumta për sa i përket fillimit të kopshtit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Duke mos qenë në dijeni të aftësisë së kufizuar të fëmijës, stafi i kopshtit nuk ndërmerr hapat e nevojshëm për përshtatjen e mjedisit, përzgjedhjen e edukatores më të përshtatshme dhe me përvojën e duhur, uljen e numrit të fëmijëve në grupin ku vendoset fëmija me aftësi të kufizuar dhe sigurimin e shërbimeve të tjera të nevojshme. Kjo praktikë sjell një fillim të vështirë në kopshte për të gjitha palët, si për fëmijën me aftësi të kufizuar ashtu edhe për fëmijët e tjerë, prindërit dhe stafin e kopshtit. Në këto kushte, krijohen premisat për konflikte mes palëve dhe për një dështim të shpejtë të procesit të përshtatjes së fëmijës me aftësi të kufizuara.

### **Muajt e parë në kopsht**

Siç edhe pohojnë një pjesë e të intervistuarve, muaji i parë në kopsht, si nga ana e stafit ashtu edhe nga ajo e prindërve, konsiderohet si test apo provë për të parë se sa është në gjendje fëmija të përballojë këtë realitet të ri. Është një muaj plot të papritura, sidomos në rastet e fëmijëve që shfaqin sjellje agresive ndaj fëmijëve të tjerë dhe stafit. Ky muaj është përcaktues për shumë nga fëmijët me aftësi të kufizuar. Edukatorja, fëmijët dhe prindërit “vlerësojnë” mundësitë e suksesit dhe dështimit.

Një tjetër barrierë kryesore që fëmijës me aftësi të kufizuar i duhet të kapërcejë është kontrolli sfinkterial. Nuk janë të pakta rastet e largimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar nga kopshti publik për shkak se fëmija nuk ka fituar shprehitë bazë të vetëndihmës. Në intervistat e zhvilluara, edukatorët shprehen se “nuk jemi babysitter që të ndërrojmë pelenat e fëmijëve... sepse kopshti është për fëmijë që shkojnë vetë në banjë...”.

Të dhënat e marra nga intervistat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara e ndërrojnë të paktën një herë kopshtin e fëmijës gjatë ose pas muajit të parë të qëndrimit në kopsht. Në raste të rralla ka prindër që shprehen se kanë ndërruar të paktën 3 kopshte brenda 3 muajve të parë. Zakonisht, pas dështimit në kopshtet publike, prindërit fillojnë të zgjedhin më së shumti kopshtet jopublike.

Muajt e parë në kopsht janë një kohë konfliktesh të forta mes palëve: prindërve të fëmijëve të tjerë në kopsht, stafit dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Roli që merr stafi në këtë konflikt shpeshherë përcakton ecurinë e mëtejshme të kësaj “bashkëjetese”.

Në disa raste, sidomos nëse fëmija shfaq sjellje të papranueshme dhe të pamendueshme nga stafi, pavarësisht përpjekjeve të stafit për zgjidhje të “çështjes” brenda kopshtit, këto konflikte transportohen edhe pranë DAR-eve. Përgjithësisht, specialistët e DAR-eve përgjegjës për monitorimin e aftësisë së kufizuar në kopshte, në momentin e vendimmarrjes, i japin prioritet vazhdimin të qëndrimit të fëmijës me aftësi të kufizuara në kopsht, siç është parashikuar në ligj. Por, pavarësisht vendimit, specialistët kanë pak burime dhe mundësi për të ndihmuar kopshtin me mësuese mbështetëse, mjete a shërbime të tjera të nevojshme.

Vazhdimësia e qëndrimit të fëmijës me aftësi të kufizuara në kopsht varet nga mënyra me të cilën do të zgjidhen mosmarrëveshjet në këtë fazë të parë të frekuentimit. Nuk janë të pakta rastet në të cilat prindërit, të vënë në siklet nga këto mosmarrëveshje dhe ankesa, vendosin ta largojnë fëmijën nga kopshti. Në disa raste, drejtuesja e kopshtit vendos që fëmija me aftësi të kufizuara të kalojë nga një grup i kopshtit në tjetrin me shpresën e uljes së konflikteve. Largime të fëmijëve nga kopshti apo kërcënime për largim bëhen edhe nga prindër të tjerë të trembur nga sjellja e fëmijëve me aftësi të kufizuara (kryesisht me autizëm).

Në disa kopshte, stafet ndërmarrin hapa konkretë për punën me prindërit dhe për mënjanimin dhe zgjidhjen e këtyre konflikteve. Ka kopshte ku, përveç organizimit të bisedave individuale të stafit me prindërit, realizohen edhe takime të psikologut me ta, jepen informacione për të drejtat e fëmijëve etj. Nuk janë të pakta rastet në të cilat prindërit frikësohen se “fëmija im kopjon sjelljet e fëmijës me prapambetje” (siç thotë një prind nga Tirana). Duket se rol madhor në informimin dhe uljen e protestës tek prindërit në këtë fazë të parë ka edukatorja e grupit të fëmijëve e cila i siguron prindërit për ecurinë dhe sigurinë e fëmijëve në grup. Nuk mungojnë rastet në të cilat edukatorët, me qëndrimet dhe veprimet e tyre, përdorin protestën e prindërve për të larguar fëmijën me aftësi të kufizuara nga grupi.

Të gjithë të intervistuarit shprehin nevojën për informacion dhe udhëzim në këtë fazë të fillimit të kopshtit. Në kopshte nuk ka materiale, manuale a broshura informuese lidhur me si mund të përballohet më mirë kjo fazë e parë. Në përgjithësi, kopshtet nuk ofrojnë shërbime që lehtësojnë këtë fazë kaq të rëndësishme transicioni dhe përshtatjeje, jo vetëm për fëmijët por edhe për familjet e tyre.

Vetë anëtarët e stafit shprehen se nuk dinë çfarë mund të bëjnë për lehtësimin e përshtatjes dhe vënë në dukje mungesën e një vlerësimi të parë të standardizuar që mund t'i bëhet fëmijës në muajin e parë të hyrjes në kopsht.

Për ata prindër të cilët kanë njoftuar paraprakisht stafin lidhur me vështirësitë e fëmijës së tyre me aftësi të kufizuar, fillimi i kopshtit është më pak konfliktual. Ata përpiqen të japin informacionin e nevojshëm mbi natyrën dhe nivelin e aftësisë së kufizuar të fëmijës dhe të bëjnë koordinimin e aktiviteteve terapeutike që fëmija mund të ndjekë në qendrat e specializuara me aktivitetet që realizohen në kopsht.

Ligji parashikon që, për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara, mësuesja të ketë tre fëmijë më pak në klasë dhe që në çdo grup të mos ketë më shumë se dy fëmijë me aftësi të kufizuar. Megjithatë, kjo kërkesë e ligjit, sidomos në vitin e fundit shkollor, sipas edukatoreve, në pjesën më të madhe të rasteve nuk është zbatuar. Numri i fëmijëve për edukatore, nga 25 që është parashikuar në ligj, mund t'i kalojë 35. Në kopshtet më të frekuentuara të qendrës së qyteteve numri i fëmijëve në një dhomë me dy edukatore mund të arrijë edhe mbi 50, pavarësisht numrit të fëmijëve me AK të pranishëm në dhomë.

*“Problemi jonë është që, duke pasur shumë fëmijë nëpër grupe, ai fëmijë ngelet si i anashkaluar sepse s’mund të punosh dot, është e pamundur të punosh me të. Ose ai fëmijë autik varet se si e ka sëmundjen e tij. Shkatërron gjithçka që ti ndërton për një orë ose për një gjysmë ore me fëmijët e tjerë. Kemi pasur probleme me prindërit të cilët kanë kërkuar që t’i largojnë dhe me pak butësi, me pak shpjegim nga drejtuesja, kanë arritur të binden që këta fëmijë do jenë prapë tek ne. Janë pjesë e jona dhe ne nuk mundemi që t’i abandonojmë, t’i largojmë. Por mësuese vetëm për një individ ne asnjëherë nuk kemi pasur”.*

Edukatore kopshti në Tiranë

### **Viti i parë e në vazhdim**

Drejtueset e kopshteve dhe stafi edukator shprehen se, në përgjithësi, pas muajit të dytë, konfliktet dhe ankesat për vazhdimësinë e fëmijës me AK në kopsht zbehen. Frikët reciproke mes palëve vijnë duke u zbehur me bashkëjetesën e muajve të parë. Shpesh prindërit dhe stafi kuptojnë se fëmijët janë më pak paragjykes ndaj fëmijës me aftësi të kufizuar se ata vetë. Ka shumë raste kur fëmijët e grupit gjejnë forma dhe rrugë origjinale në komunikimin me këta fëmijë dhe mësimin e aftësive të ndryshme. Megjithatë, klima e grupit dhe qëndrimi e sjellja e fëmijëve të tjerë ndaj fëmijës me aftësi të kufizuar duket se në tërësi pasqyrojnë qëndrimin dhe sjelljen e edukatores ndaj këtyre fëmijëve.

Me përfundimin e vitit të parë të kopshtit, shfaqen çështje të tjera që kërkojnë zgjidhje. Ndryshimi i grupit është një fazë tjetër transicioni të cilës i “druhen” të gjitha palët. Në shumë raste, nëse është krijuar një ecuri e besueshmëri e mjaftueshme të

edukatorja, prindi zgjedh të mos e ndryshojë edukatoren, pavarësisht nëse edukatorja ndryshon grupmoshën apo klasën me të cilën punon. Drejtueset e kopshteve në disa raste detyrohen “të mbajnë peng” mësuesen që fëmija me aftësi të kufizuar të qëndrojë deri në fund të kopshtit me të njëjtën edukatore dhe grup fëmijësh. Por, nuk janë të pakta rastet në të cilat fëmija me aftësi të kufizuar kalon në një tjetër grup me edukatore të reja duke i nisur kështu nga e para sfidat e përshtatjes.

Fjala kyç e drejtueseve të kopshteve (dhe shkollave) për zgjidhjen e këtyre konflikteve dhe situatave të vështira është kompromisi. Drejtueset dhe stafi bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të mbajtur dhe zgjidhur brenda “mureve” të institucionit konfliktin mes palëve sepse “nuk duan që të merret vesh lart”, çka nënkupton tensionin e mosdaljes së informacionit në instanca më të larta monitoruese. Në fakt, në shumicën e rasteve, falë edhe njohjeve personale të prindërve, ia dalin mbanë që të arrijnë në kompromise, kryesisht të heshtura. Drejtueset dhe stafet e këtyre institucioneve tregojnë se të gjitha vendimet e marra për fëmijët në institucion i bazojnë tek intuata dhe përvoja e viteve dhe jo në trajnimet apo manualet udhëzuese për zgjidhjen më të mirë të problemit. Gjatë kësaj faze neglizhohen fletoret e vlerësimit dhe bëhet pak punë për përgatitjen e veçantë të fëmijës për klasën e parë.

### **Përfundimi i kopshtit**

Përfundimi i kopshtit paraqet një tjetër moment të vështirë transicioni dhe konflikti por tanimë kryesisht mes drejtueses dhe mësueses së kopshtit nga njëra anë dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar nga ana tjetër. Ligjërisht, fëmijët me aftësi të kufizuar mund të qëndrojnë në kopsht deri në moshën 8-vjeçare por, sidomos në rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale, prindi kërkon ta lërë edhe më gjatë sepse “sheh se fëmija ende nuk është gati” të përballojë programin dhe kërkesat e klasës së parë. Këtë konflikt drejtueset shprehen se, në shumicën e rasteve, e zgjidhin duke bindur prindin ose duke rënë në një kompromis “të pëlqyeshëm për të dyja palët”. Ka shembuj të rrallë kur konfliktet janë përcjellë në DAR-e dhe është kërkuar ndihma e specialistëve përkatës për këto raste.

*“Një prind nuk më la gjë pa thënë që ta mbaja fëmijën edhe pse kishte mbushur moshën e shkollës. Kur unë refuzova, ai shkoi në drejtorinë arsimore dhe unë u detyrova ta pranoj.*

*[...]*

*Ka shumë probleme. Një 8 vjeçar me një 5-6 vjeçar nuk shkojnë shumë mirë. Plus që një fëmijë autik ka një fuqi të jashtëzakonshme. Ne kemi pasur një vajzë autike që na rrëzonte edhe ne. Kishte momente të caktuara që mund të të hidhte në tokë. Imagjinoje se ç’mund të ndodhë me një fëmijë 5-vjeçar”.*

Drejtoreshë e një kopshti në Tiranë

Në përfundim të kopshtit, fëmija pajiset me një certifikatë për përfundimin e tij (si të gjithë fëmijët e tjerë). Megjithatë, puna edukative dhe arsimore e ndërtuar dhe dokumentuar në kopsht nga mësuesja e kopshtit në shumicën e rasteve nuk u përcillet prindërve dhe si pasojë as shkollës. Në këtë mënyrë humbet një informacion i rëndësishëm për këtë përvojë të parë.

### **3.3.2 Regjistrimi dhe ditët e para në klasën e parë**

Thuajse të gjithë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që u intervistuan rrëfejnë se momenti më i vështirë për ta është marrja e vendimit për fillimin e shkollës. Për shumicën e tyre, mendimi i parë është shkolla e zakonshme por shpesh rrethanat i detyrojnë të zgjedhin edhe alternativa të tjera. Ata shprehen se ky është momenti në të cilin do të donin të kishin një shërbim këshillues për këtë vendimmarrje. Akoma më i vështirë është ky çast për prindërit fëmijët e të cilëve nuk kanë ndjekur asnjë lloj forme të arsimit parashkollor por që kanë mbushur ose kaluar moshën e hyrjes në shkollë, ndërkohë që prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë ndjekur kopshtet, siç edhe shprehen, “janë stërvitur me përballjet” e hasura në vitet parashkollore.

Siç u përmend edhe në pjesën e gjetjeve për barrierat, një numër i madh prindërisht me fëmijë me aftësi të kufizuara nga zonat rurale nuk i regjistrojnë fëmijët në asnjë institucion arsimor, kurse një pjesë e tyre vendosin t’i dërgojnë në shkollat speciale të qytetit.

Procedurat dhe dokumentacioni i regjistrimit të fëmijëve në shkolla të zakonshme publike janë thuajse të njëjta me ato të regjistrimit në kopsht, vetëm se ky dokumentacion (certifikatë personale dhe certifikatë vaksinimi) dorëzohet vetëm pranë drejtorisë së shkollës. Përderisa shkollat e zakonshme janë parimisht të hapura për të gjithë fëmijët, në to mund të regjistrohet çdo fëmijë, pavarësisht nga niveli i aftësisë së kufizuar, mjafton që prindi të kërkojë “me ngulm” ta regjistrojë fëmijën aty.

Të intervistuarit sjellin raste në të cilat në shkollat e tyre janë regjistruar fëmijë me dëmtime shumë të rënda ose që shfaqnin sjellje shumë të vështira por që nuk ishin vlerësuar asnjëherë.

*“Vjet më erdhi për regjistrim një fëmijë. Prindi më tha që e kam pak të sëmurë dhe asgjë më shumë. Kur erdhi ditën e parë të shkollës u shastisëm e nuk dinim ç’të bënim. Fëmija nuk ishte në gjendje të fliste, nuk mund të qëndronte për asnjë çast në bankë dhe shpesh klithte fort e vinte duart në veshë, e donte të largohej. Mësuesja më tha: ‘me këtë e kam të pamundur të punoj’. Dhe kishte të drejtë se nuk kemi asnjë lloj kushti për këta fëmijë. Parimisht, shkollat vërtet janë të hapura për të gjithë fëmijët por, në realitet,*



*shkollat tona nuk janë të përshtatshme për këtë lloj niveli. Tani, nuk është puna t'i ngecim këtu në shkollë e pastaj le të bëhet ç'të bëhet me ta. Më mirë mos t'i pranojmë kur nuk kemi kushte sesa t'i pranojmë nga frika e ligjit dhe e shefave e pastaj të gjejmë mënyrat tona për t'i larguar. Puna është t'i fusim në shkolla, por t'u krijojmë edhe kushte"*

Drejtoreshë shkolle nga Tirana

Në përgjithësi, gjejmë të njëjtat elemente, vështirësi dhe ecuri në fillimin e shkollës së fëmijës me aftësi të kufizuara sikurse edhe në fillimin e kopshtit: refuzime të fëmijëve me aftësi të kufizuara të moderuara ose të rënda, konflikte mes prindërish, mësues të sflitur, fëmijë të papërgatitur për të përballuar kërkesat e klasës së parë, prindër që nuk pranojnë vështirësitë e fëmijës e nuk ndajnë me mësueset informacione mbi vështirësitë e fëmijës por edhe që reagojnë egër ndaj sugjerimeve të mësues për ta vlerësuar fëmijën, kërcënime për largime, kompromise mes palëve etj.

Duket se ditët e para në shkollë në përgjithësi janë një periudhë konfuzioni për të gjithë. Për mësueset pa përvoja të ngjashme të mëparshme me këta fëmijë, këto ditë mund të kthehen "në periudha ankthi dhe stresi të jashtëzakonshëm". Kategoria e fëmijëve që ato i tremb më shumë janë fëmijët me autizëm.

*"Na thonë [mësueset] kur vijnë [fëmijët me AK] ]nga kopshti, 'ububu nuk e marr, nuk e marr, kam vuajtur kaq vjet me këta dhe jam e lodhur'. Nuk është e thjeshtë të pranohen nga mësuesit këta fëmijë në klasë të parë. Ka një reaksion të jashtëzakonshëm"*

Drejtoreshë shkolle në Durrës

*"...ne, që të mos kemi konflikte mes mësuesve, e bëjmë me short se kujt do t'i qëllojë të mbajë fëmijën në klasë. Kështu asnjëra nga mësueset nuk ankohet"*

Drejtoreshë shkolle në Tiranë

*"unë ia ngarkoj këtë përgjegjësi mësueseve më të reja në shkollë sepse ato nuk protestojnë. Por, në disa raste, shoh edhe sa përvojë ka mësuesja në komunikim me prindin, çfarë karakteri ka mësuesja dhe sa di të punojë me këta fëmijë"*

Drejtoreshë shkolle në Shkodër

Drejtueset e shkollave përpiqen të zgjedhin mësueset e fëmijëve me aftësi të kufizuar në bazë të përvojës së mëparshme të mësueses, karakterit dhe mënyrës së



komunikimit të mësueses si dhe motivimit të saj. Më të lehta janë rastet kur prindi ka njohje me vetë mësuesen e cila shpreh dëshirën e saj tek drejtuesja për ta marrë këtë fëmijë në klasën e saj. Edhe në këtë rast, të gjitha vendimet për fëmijën merren me kompromis mes palëve. Shkolla nuk disponon ndonjë udhëzim, manual apo informacion a trajnim se mbi cilat ligje, kritere e parime duhet të ngrihen gjykimet e vendimmarrjes.

### ***Muajt e parë të klasës së parë***

Muajt e parë të klasës së parë përshkruhen si shumë të vështirë nga të gjithë të intervistuarit, veçanërisht nga mësueset<sup>37</sup> të cilat shpesh thonë se u duhet të qëndrojnë gjatë gjithë kohës pa dalë nga klasa për asnjë arsye, deri në fund të mësimit. Mësueset kërkojnë ndihmë kryesisht te psikologu për një vlerësim dhe për ndërtimin e një plani individual, ndihmë e cila jo gjithmonë vjen në kohën dhe cilësinë e kërkuar, e kështu shpesh mësueset mbeten të vetme në këta hapa të parë të arsimimit të fëmijës me aftësi të kufizuar. Në shumë raste, në mungesë të mësuesit mbështetës, me vendim të tijin ose me kërkesën e mësueses, prindi qëndron vetë në klasë në të gjitha orët e mësimit. Në raste të tjera, prindërit punësojnë specialistë, psikologë a mësues në ndihmë të mësueses së klasës. Pavarësisht nga situata, në shumë raste, edhe pse pa arsimin përkatës, pa trajnimet e nevojshme dhe pa ndihmën e specialistëve, mësueset fillojnë të ndërtojnë një plan individual pune të thjeshtë, të shkruar ose jo. Provë-gabimet e shumta sjellin edhe suksese, sigurisht duke lënë mënjanë dështimet.

*“Kam parë dhe përjetuar skena që nuk di si t’i përshkruaj. Jam bërë mjeke, psikiatre. Mundohem të gjej mënyra nga më të ndryshmet që të bëj diçka për këtë fëmijë por është e vështirë”.*

Mësuese në një shkollë 9-vjeçare, Tiranë

Muajt e parë të shkollës janë të ngarkuar edhe nga konfliktet me prindërit e tjerë të klasës, paparashikueshmëria e sjelljeve të fëmijës dhe mungesa e teksteve e materialeve të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjatë muajve të parë në shkollë, në përgjithësi, ndodh i njëjti fenomen si edhe në muajt e parë të kopshtit: një pjesë e prindërve, të bindur për vështirësitë me të cilat do të përballen dhe pasi kanë parë mundësitë e shkollës, vendosin të largohen nga ajo shkollë, kryesisht në drejtim të alternativave të tjera “më të sigurta” si shkollat private apo shkollat speciale.

---

37. Në të gjitha fokus-grupet e zhvilluara nuk ka pasur asnjë burrë që të ishte mësues i klasës së parë, ndaj edhe përgjigjet në këtë rast kanë ardhur vetëm nga mësuese.

### ***Cikli i ulët i arsimit 9-vjeçar***

Përfundimi “me sukses” i klasës së parë (siç e quajmë mësueset, por që në fakt nënkupton aftësinë e fëmijës për t’u përshtatur në klasë dhe për të mbijetuar) është në shumë raste tregues se fëmija do të qëndrojë edhe për pesë vite të tjera në atë klasë. Ndër gjërat që prindërit vlerësojnë te cikli fillor është edhe fakti që, gjatë gjithë arsimit fillor, fëmija ka vetëm një mësuese deri në klasën e gjashtë.

Me gjithë vështirësitë, duket se mësueset e ciklit të ulët i kanë të qarta objektivat për fëmijën deri në klasën e gjashtë: objektivi për sjelljen është që fëmija të arrijë të qëndrojë në klasë gjatë orës së mësimi kurse objektivat mësimorë lidhen me mësimin e shkronjave dhe numrave. Ato, edhe pse nuk e dinë se cili është niveli i aftësisë së kufizuar të fëmijës, edhe pse nuk i njohin praktikat pedagogjike për instruksionin e tyre, përpiqen vazhdimisht me këtë objektiv të qartë në mendje. Gjatë vitit, fillojnë të kuptojnë intuitivisht metodologjinë e mësimdhënies dhe shpejtësinë me të cilën mund të kapë fëmija informacionin e ri dhe të jenë gjithnjë e më realiste në vendosjen e objektivave mësimorë.

### ***Cikli i lartë i arsimit 9-vjeçar***

Fillimi i ciklit të lartë të arsimit 9-vjeçar është fillimi i një cikli të ri vështirësish të cilat në përmbajtje janë të ndryshme nga të mëparshmet. Edhe të dhënat e marra nga pyetëtorët dhe fokus-grupet nxorën në pah faktin se, në klasë të gjashtë një sërë fëmijësh me aftësi të kufizuara (kryesisht mendore) braktisin shkollën<sup>38</sup>. Të intervistuarit rendisin shumë shkaqe ndër të cilat përmendim si më të rëndësishmet: kurrikulën jo fleksibël, programin mësimor dhe tekstet gjithnjë e më të vështira e të pamundura për t’u arritur për nivelin e tyre duke e thelluar edhe më tej distancën me shokët, numrin e madh të mësuesve që i njohin pak fëmijët me aftësi të kufizuara, pubertetin dhe frikën e turpin e prindërve/mësuesve për sjelljet seksuale që mund të shfaqin këta fëmijë, bulizmin etj. Për këta fëmijë, programet mësimore nuk përshtaten më, PEI-të në të shumtën e rasteve nuk ndërtohen dhe raportohen edhe ngjarje në të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara fillojnë të bëjnë regres në aspektin e arsimimit. Kriteri kryesor për kalimin e lëndës është kryesisht prania fizike e fëmijës në klasë. Vlerësimet me notë bëhen kryesisht për mëshirë e për të mos e lënë në klasë. Përrjashtim bëjnë rastet në të cilat vetë prindi i kërkon mësuesve ta mbesin për një vit fëmijën që të jetë më i përgatitur në vitin e ardhshëm.

Megjithatë, nuk janë të paktë fëmijët me aftësi të kufizuara që, falë investimit të madh të të gjithë faktorëve, arrijnë të përfundojnë shkollën 9-vjeçare. Sigurisht,

---

38. Të dhënat e studimit (intervistat, fokus grupet dhe pyetëtorët) janë marrë gjatë periudhës Mars-Qershor 2012, kur cikli i ulët i arsimit 9-vjeçar përfundonte në klasën e pestë. Me miratimin e ligjit të ri për Arsimin Parauniversitar në korrik 2012 (Ligji 69/2012) sistemi arimor pësoi këto ndryshime: arsimi fillor u bë gjashtë klasë, (nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë), ndërsa arsimi i mesëm i ulët u bë tri klasë, nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

pas një rruge të gjatë e të vështirë për të gjithë. Nuk mungojnë shembujt pozitivë në të cilët, falë pasionit dhe punës së madhe të prindërve, mësuesve dhe nxënësve, fëmija me aftësi të kufizuara ka mundur të arrijë objektiva befasues. Por, për fat të keq, shumë nga ky investim i kryer për suksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk pasqyrohet në dokumentacion, duke mbetur vetëm në kujtimet më të bukura të vetë mësuesve, prindërve dhe nxënësve.

### **Po më tej...???**

Ky studim është i fokusuar vetëm në arsimin e detyruar por, në intervista, pjesëmarrësit sollën disa fakte që do të donim t'i pasqyronim shkurt në rreshtat e mëposhtëm.

Në arsimin e mesëm, edhe pse ligjërishit i mundur për çdo fëmijë, vetëm pak fëmijë me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë të pranishëm, kryesisht fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, dëgjimore ose pamore.

Shumë nga prindërit e intervistuar shprehën dëshirën për t'i dërguar fëmijët në shkolla profesionale ose alternativa të ngjashme për të mësuar një zanat por diapazoni i mundësive duket shumë i vogël. Shumica e prindërve të intervistuar u shprehën se, pavarësisht nga dëshira, do t'i mbajnë në shtëpi fëmijët e tyre sepse nuk kanë alternativa të tjera të pranueshme dhe se shkollat e mesme janë të vështira për t'u përballuar e nuk janë ende "gati" për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## **3.4 Monitorimi**

---

Monitorimi i nxënësve me aftësi të kufizuara zyrtarisht kryhet në tre nivele: në nivel qendror/kombëtar, në nivel rajonal/lokal dhe në nivel shkolle.

### **3.4.1 Monitorimi në nivel qendror**

Në organigramën aktuale të MAS-it nuk ka sektorë të veçantë për monitorimin e aftësisë së kufizuara. MAS-i prej vitesh përpiqet të mbledhë të dhëna mbi arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla. Të dhënat nga DAR-et raportohen kryesisht në kuadër të projektit "Braktisja Zero" që synon arsimimin e kategorive më në risk për braktisje të shkollës ndër të cilët edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Të dhënat e marra çdo vit nga MAS-i janë të karakterit sasior dhe e bëjnë të vështirë monitorimin e aksesit dhe cilësisë që fëmijët me aftësi të kufizuara arrijnë të kenë në arsimim.

Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) ka si mision përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në arsimin parauniversitar nëpërmjet vlerësimit të jashtëm të institucioneve arsimore. Për këtë arsye, IKAP-i inspekton çdo vit institucionet arsimore parauniversitare. Në ndihmë

të inspektimeve objektive, ky institucion ka hartuar edhe manualët e vlerësimit të kopshteve dhe shkollave pjesë e të cilave është edhe vlerësimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Çdo vit, ky institucion boton raportin e inspektimit në të cilin ka tregues edhe për gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla. Megjithatë, të dhënat rreth gjendjes arsimore të këtyre fëmijëve janë të pakta. Kjo edhe për shkak se numri i stafit të inspektoratit është shumë i vogël në krahasim me numrin e institucioneve që ai mbulon dhe ende nuk ka në strukturën e tij njësi a sektorë të veçantë për monitorimin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe asnjë specialist të fushës së aftësisë së kufizuar.

### **3.4.2 Monitorimi në nivel rajoni**

Aktualisht, numri i Drejtorive Arsimore Rajonale është 14<sup>39</sup> dhe ato shtrihen në 12 qarqe të vendit, ndërsa numri i Zyrave Arsimore është 24. DAR-et funksionojnë në çdo qark dhe varen drejtpërdrejt nga MAS-i, kurse ZA-të funksionojnë në çdo nënprefekturë dhe janë në varësi të Drejtorive Arsimore Rajonale. DAR-et janë përgjegjëse, veç të tjerash, për sigurimin e cilësisë në shkollat publike dhe jopublike ndërsa ZA-të janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ, menaxhimin e burimeve njerëzore, grumbullimin e informacionit statistikor, mbikëqyrjen e klasave dhe veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare dhe menaxhimin e burimeve financiare për disa elemente<sup>40</sup>.

Për të kuptuar rolin dhe organizimin e strukturave monitoruese në nivel rajonal (DAR/ZA-të), një seksion i pyetësorit u ndërtua me pyetje për marrjen e këtij informacioni. Të dhënat e marra në këtë pjesë të pyetësorit u eksploruan më tej edhe me fokus-grupe e intervista.

Në çdo DAR dhe thuajse në çdo ZA ka persona përgjegjës të cilët, përveç përgjegjësive të tjera, kanë edhe përgjegjësinë e monitorimit të procesit të përfshirjes dhe arsimimit të nxënësve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.

Sipas të dhënave të marra nga pyetësorët, rreth 90% e DAR-eve dhe ZA-ve bëjnë një monitorim të rregullt dhe periodik të elementëve të mëposhtëm:

1. Monitorim/verifikim të numrit të nxënësve dhe nevojave të nxënësve të transferuar në shkollat e rrethit/zonës
2. Monitorim/verifikim të pajisjeve dhe hapësirave brenda ndërtesave (kopshteve dhe shkollave) në bashkëpunim me përfaqësues të bashkive dhe komunave

---

39. Gjatë kohës së përgatitjes së këtij botimi, ZA Lushnjë u njoh si DAR për një periudhë të shkurtër kohe e më pas u rikthye në statusin e ZA-së. Megjithatë, në studimin tonë ajo është marrë parasysh si DAR.

40. <http://arkiva.MAS.gov.al/faqe.php?id1=5&id2=121&lang=en>

3. Monitorim/verifikim të dosjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla
4. Vlerësim të kërkesave për staf shtesë dhe të ardhura nga kopshtet dhe shkollat

Të dhënat e pyetësorit ofrojnë prurje për t'u vlerësuar:

Pavarësisht të dhënave të mësipërme, mbi 60% e DAR/ZA-ve nuk kanë plan të shkruar veprimi për qarkullimin e informacionit në organizatat që punojnë me këta fëmijë dhe komunitetin në përgjithësi.

Mbi 40% e tyre nuk kanë plan veprimi për monitorimin e gjithëpërfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e rrethit/zonës.

Në rreth 60% të DAR/ZA-ve, personat përgjegjës për monitorimin e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk kanë përfunduar studimet në fushën e arsimit special; njohuritë e tyre janë të përcipta, kryesisht të marra nga trajnime të shkurtra ose vizita studimore.

Pyetjes se a është e mjaftueshme koha që kanë në dispozicion për të monitoruar kopshtet dhe shkollat, të gjitha DAR-et/ZA-të i janë përgjigjur me jo, pasi personi përgjegjës duhet të monitorojë në të njëjtën kohë edhe shumë kategori të tjera nxënësish dhe çështjesh si dhe një numër shumë të madh shkollash. Kopshtet dhe shkollat private mbeten edhe më jashtë vëmendjes monitoruese, sidomos kopshtet të cilat nuk janë licencuar nga MAS-i.

Ajo që bie në sy në vlerësim janë kompetencat e pakta të DAR/ZA-ve në nxjerrjen e udhëzimeve specifike për kopshtet dhe shkollat e zonës që mbulojnë. Kjo kompetencë i është lënë MAS-it, pa marrë parasysh specifikat që mund të kenë shkollat në një rreth të caktuar. Për këtë arsye, asnjë nga DAR/ZA-të nuk ka nxjerrë në ndihmë të gjithëpërfshirjes ndonjë udhëzim të veçantë, si për kopshtet ashtu edhe për shkollat. Pavarësisht nga reforma e ndërmarrë nga MAS-i për decentralizimin në arsim (si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2004-2015), duket se ky proces në terren nuk ka dhënë ende efekte të ndjeshme.

Në shumë DAR-e, specialistët përgjegjës për monitorimin thonë se çdo vit hasen me një numër të madh konfliktesh dhe ankesash që lidhen me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilave ata, si hallka më e lartë vendimmarrëse në rreth, përpiqen t'u japin zgjidhje në kohë.

Ndërkohë, të dhënat e marra në fokus-grupe dhe intervista ofrojnë detaje edhe mbi cilësinë e monitorimit: edhe pse zyrtarisht DAR-et duhet të monitorojnë në terren të gjitha kopshtet dhe shkollat ku ka fëmijë me aftësi të kufizuara, në praktikë nuk ndodh kështu.

*“... deri më tani nuk na ka ardhur njeri nga DAR-i për të na monitoruar apo supervizuar...ata thjesht marrin raportet që u dërgojmë ne me shkrim”.*

**Drejtore shkollë, Shkodër**

*“... nëse unë raportoj në DAR si është realisht gjendja (se në realitet p.sh. kam shumë më pak fëmijë me AK që ndjekin shkollën se ata që janë të regjistruar) ka mundësi që të më ulet numri i mësuesve dhe të shkurtohen edhe më tej fondet për shkollën”*

Drejtor shkolle, Fier

### **3.4.3 Monitorimi në nivel shkolle**

Si rregull, shkollat kryejnë monitorime të brendshme dhe vetëvlerësime të përvitshme për një analizë të situatës së tyre dhe për ndërtimin e planit të punës për vitin shkollor pasardhës. Në këtë proces vetëvlerësimi, që drejtohet nga drejtori i shkollës, përveç stafit mësues, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të bordit të shkollës. Vetëvlerësimi i shkollës përfshin identifikimin e problemeve, analizën e tyre, zgjedhjen e strategjive të përshtatshme, planifikimin dhe monitorimin e punës. Pjesë e këtij monitorimi në nivel shkolle është edhe ecuria e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Intervistat e kryera në terren na njohën me një sërë problemesh në këtë nivel monitorimi. Kështu, në shumë raste, pavarësisht kërkesës së ligjit, vlerësimet e brendshme bëhen vetëm formalisht, pa kryer një analizë të plotë të gjendjes dhe problemeve. Monitorimi i cilësisë së arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë nuk përbën prioritet dhe konsiderohet një çështje periferike e pa rëndësi në një pjesë të shkollave e, në shumë raste të tjera, bordet e prindërve ose qeveritë e nxënësve<sup>41</sup> nuk përfshihen në proces. Të intervistuarit shprehen se nuk përdorin për monitorimin e brendshëm të shkollës instrumente dhe metoda objektive, me indikatorët e nevojshëm, të cilat adresojnë edhe çështjet që lidhen me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë.

## **3.5 Profile të Shqipërisë në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara**

---

Cilësia e shërbimit arsimor shpesh mund të jetë shumë më e ndryshme mes zonave të ndryshme të një vendi sesa mes shteteve të të njëjtit rajon. Nga të dhënat e marra, ekipi vuri re disa ndryshime të theksuara mes shkollave në zonat urbane dhe atyre në zonat rurale, ndryshime në realitetin arsimor të kategorive

---

41. Qeveria e nxënësve është një grup nxënësish të një shkolle, të zgjedhur me votim nga nxënësit e asaj shkolle për t'i përfaqësuar ata dhe pikëpamjet e tyre. Ajo është një formë organizimi e nxënësve për ushtrimin e të drejtës dhe përgjegjësisë të tyre pjesëmarrëse në vendimmarrje të rëndësishme të shkollës dhe jashtë saj.

të ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe ndryshime mes shkollave publike dhe shkollave private. Në këtë pjesë të gjetjeve, ekipi kërkimor ka pasqyruar disa nga dallimet më të rëndësishme të vërejtura në terren.

### **3.5.1 Cilësia e shërbimit në zonat urbane kundrejt zonave rurale**

Sipas INSTAT-it, 53.75 % e popullsisë jeton në zona urbane dhe pjesa tjetër prej 46.3 % jeton në zona rurale, shumica të thella e me terren të thyer malor. Faktori urban-rural është një ndër faktorët më të rëndësishëm dhe shqetësues në arsimin shqiptar.

Në Shqipëri, të gjitha shkollat speciale që veprojnë në vend ndodhen vetëm në qytetet e mëdha ndërkohë që pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendohet të jenë nga zonat rurale. Për më tepër, largësia e shkollave, infrastruktura jo vetëm e shkollave por edhe e rrugëve rurale në të cilat duhet të ecin çdo ditë fëmijët me aftësi të kufizuara, niveli i ulët i kualifikimit i stafit të shkollave, përzjerja e klasave, mungesa e theksuar e mjeteve dhe pajisjeve mësimore, mungesa e motivimit në stafin mësimor, mungesa e dukshme e monitorimit, mungesa e fondeve e shumë faktorë të tjerë të rëndësishëm e bëjnë arsimin e fëmijëve në zonat rurale të ketë një cilësi shumë herë më të ulët se ai në zonat urbane.

Në zonat e largëta dhe gjysmë të largëta rurale, sa më e madhe të jetë distanca nga rrugët kryesore, aq më i dobët është rrjeti rrugor. Shumë nga rrugët dytësore thuajse nuk mirëmbahen. Në disa raste, ato janë të kalueshme vetëm gjatë motit të thatë dhe vetëm me automjete të posaçme.

Sipas studimeve të ndryshme<sup>42</sup> problemi kryesor me të cilin ballafaqohen banorët e zonave rurale është varfëria. Gjithashtu, sipas të dhënave të shkollave, shifrat e regjistrimit në shkolla shpesh janë jo të njëjta me ato të vijueshmërisë së procesit mësimor. Fëmijët nga fshatrat pa shkollë fillore e vijojnë mësimin në shkollën e fshatit më të afërt. Në shumë fshatra, për shkak të numrit të fëmijëve, bashkohen klasat dhe mësuesve u duhet të bëjnë mësim në të njëjtën klasë me fëmijë të klasës së parë dhe të tretë ose të klasës së dytë dhe të katërt. Në disa raste, në të njëjtën klasë mund të gjesh nxënës nga klasa e parë në atë të katërt njëherësh.

Shkalla e braktisjes së shkollës në zonat rurale, për shkak të faktorëve të mësipërm, në studime të disa viteve më parë vlerësohet të arrijë në 25%<sup>43</sup>. Në zonat rurale janë të pakta shkollat private.

Po ashtu, edhe ¼ e mësuesve të shkollave nëntëvjeçare nuk janë të kualifikuar; numri dhe cilësia e trajnimeve të marra nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollave

42 Për më tepër shih [http://www.instat.gov.al/media/169434/varferia\\_ne\\_shqiperi.pdf](http://www.instat.gov.al/media/169434/varferia_ne_shqiperi.pdf)

43. Raporti Vjetori Statistikave për Arsimin. Ministria e Arsimit dhe e Shkencave, Republika e Shqipërisë, 2003; dhe [http://www.unicef.org/albania/sq/children\\_2398.html](http://www.unicef.org/albania/sq/children_2398.html)

është shumë e ulët<sup>44</sup>.

Kësaj panorame të zymtë në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuara i shtohen edhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me mentalitetin dhe qëndrimin ndaj aftësisë së kufizuar. Paragjykimi dhe diskriminimi ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara është më i dukshëm në zonat rurale. Edhe informacioni që kanë prindërit mbi të drejtën e fëmijëve të tyre me aftësi të kufizuara për arsim është shumë i kufizuar.


### 3.5.2 Dallimet mes kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar

Një tjetër faktor i rëndësishëm i identifikuar në studim janë edhe dallimet mes realiteteve arsimore të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Nga të dhënat e pyetësorëve dhe fokus-grupeve del qartësisht në pah se kategoria e fëmijëve me autizëm është kategoria që has më shumë vështirësi dhe sfida në arsim, jo vetëm në atë të zakonshëm por edhe në atë special.

Mbi 80% e të pyeturve raportojnë se arsimimi i fëmijëve me autizëm dhe me aftësi të kufizuara mendore është disi ose aspak efektiv. Ndërkohë, vetëm rreth 30% e të pyeturve mendojnë se arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuar fizike apo gjuhësore është disi ose pak efektiv<sup>45</sup>.

**Grafiku nr. 7:** Efektiviteti i gjithëpërfshirjes për fëmijët me aftësi të kufizuar mendore




44. [http://www.cfce.crca.al/sites/default/files/download/research/Situata%20e%20Arsimit%20ne%20Shqiperi%20\(2006\)\\_0.pdf](http://www.cfce.crca.al/sites/default/files/download/research/Situata%20e%20Arsimit%20ne%20Shqiperi%20(2006)_0.pdf); [http://www.unicef.org/albania/HDO\\_new\\_eng\\_2006.pdf](http://www.unicef.org/albania/HDO_new_eng_2006.pdf)

45. Një pjesë e fëmijëve janë diagnostikuar në qendra të specializuara në Tiranë. Për të tjerët diagnoza është vetëm e dyshuar nga mjekët e shkollës ose spitalit por nuk është e certifikuar.



**Grafiku nr. 8:** Efektiviteti i gjithëpërfshirjes për fëmijët autikë



Pjesa më e madhe e të intervistuarve u fokusuan tek rastet e fëmijëve me autizëm, puna me të cilët dukej e vështirë për të mos thënë e pamundur. Në disa prej intervistave, mësuesit shpesh e identifikonin aftësinë e kufizuar (dhe sfidat që lidhen me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar) me fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale në përgjithësi dhe më në veçanti fëmijët me autizëm.

Dallimi mes realiteteve të kategorive të ndryshme shprehet qartë në fjalët e një mësuesi të shkollës 9-vjeçare:

*“Unë i ndaj fëmijët për të cilët po flasim në dy kategori: në ata me aftësi të kufizuara dhe në ata me aftësi të pakufizuara. Ata me aftësi të kufizuara janë ata fëmijë që kanë ndonjë problem fizik a kanë probleme në të folur, por janë të urtë e të sjellshëm dhe i bëjnë të gjithë për vete. Kurse fëmijët me aftësi të pakufizuara janë ata fëmijë që nuk lënë gjë pa bërë në shkollë, nuk kanë kufij e nuk di ç’të bësh me ta. Ata bërtasin, godasin shokët, veten e mësuesin, prishin mësimin, theyejnë ç’të mundin e nuk dimë si t’i kufizojmë...”*

Mësues në Korçë

### **3.5.3 Arsimi publik kundrejt arsimit privat**

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i gjetjeve është dallimi ndërmjet arsimit publik dhe atij privat. Grupi i punës nxori në pah një sërë dallimesh mes tyre, ndër të cilat përzgjedhim si më të rëndësishmet ato në vijim:

Epërsia në cilësi e arsimit privat konsiston në sa më poshtë:

- Në përgjithësi, infrastruktura në kopshtet dhe shkollat private është më

cilësore dhe e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht në qytetin e Tiranës.

- Shumica e shkollave private ofrojnë shërbimin e transportit për të gjithë fëmijët, përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta.
- Një pjesë e madhe e kopshteve dhe shkollave private ofrojnë shërbimin ushqimor me mëngjesin dhe drekën.
- Niveli i sigurisë fizike të nxënësit në kopshtet dhe shkollat private në përgjithësi është më i lartë se në shkollat shtetërore.
- Numri i fëmijëve në kopshtet dhe shkollat private është shumë më i ulët se në ato publike, në klasa ka një numër të vogël nxënësish dhe raporti mësues-nxënës është më i ulët.
- Pjesa më e madhe e kopshteve dhe shkollave private ofrojnë qëndrime me orare të zgjata (rreth 8 orë në ditë) e në të përfshihet edhe orari i studimit pas mësimi.
- Mjetet dhe pajisjet mësimore, programet dhe tekstet shkollore janë më të larmishme.
- Bashkëpunimi ndërmjet prindërve dhe stafit të shkollës është më dinamik.
- Aksesi dhe procedurat e regjistrimit në shkollë janë të thjeshta.
- Privatësia e të dhënave mbi fëmijët është në përgjithësi më e mbrojtur.
- Në përgjithësi, stafi i shkollës është më i kualifikuar.
- Në një pjesë të këtyre shkollave është i pranishëm edhe stafi mbështetës (mësues të dytë, mjekë pediatër etj.) i cili ofron shërbimin për një numër shumë më të vogël nxënësish krahasuar me shkollat publike.

Nga ana tjetër, edhe kopshtet dhe shkollat publike kanë një sërë elementësh më pozitivë në krahasim me ato private:

- Arsimi publik është më i monitoruar në të gjitha nivelet krahasuar me atë privat (një problem më vete në këtë drejtim është fakti që në vend ka shumë kopshte por edhe shkolla private të palicencuara).
- Arsimi publik është falas dhe i mundshëm edhe për kategoritë e familjeve më në nevojë.
- Në përgjithësi, stafi arsimor i shkollave publike ka marrë trajnime të ndryshme që lidhen me aftësinë e kufizuar, trajnime në të cilat nuk ka marrë pjesë stafi i shkollave private.
- Ka përfaqësi prindërisht, senat shkollë, akses në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Raportimet e dokumentacionet (ditar, regjistër, regjistrime, dosje, fletore vlerësimi) janë shumë më të strukturuar se në shkollat private (në të cilat ndonjëherë ky informacion mungon).
- Ka raste kur mësues të kualifikuar punojnë në shtëpi me orë të zgjata me fëmijët në nevojë (p.sh. shkolla “Bajram Curri”).

### 3.6 Shkollat speciale


Në Shqipëri, arsimi special ka një historik të gjatë fillesat zyrtare dhe të organizuara të të cilit datojnë në vitet '60 të shekullit XX, kohë në të cilën filluan të hapeshin institucionet dhe shkollat e para speciale. Një studim i kryer këtë vit përshkruan në mënyrë të detajuar historikun dhe realitetin e arsimit special në Shqipëri ndër vite<sup>46</sup>. Në të evidentohen praktikat dhe përvoja shqiptare si dhe mënyrat e organizimit të arsimimit dhe trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Aktualisht në Shqipëri, në ndihmë të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka 2 institute dhe 7 shkolla speciale në qytetet më të mëdha të vendit (duke përfshirë edhe shkollën speciale të qytetit të Fierit). Fëmijët në këto shkolla janë të izoluar nga shoqëria. Pyetësorët e shpërndarë në kuadrin e këtij studimi në të gjitha shkollat speciale dhe intervistat e vëzhgimet e kryera në pjesën më të madhe të tyre kishin për synim të kuptonin gjendjen aktuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në këto shkolla dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara në to.

#### 3.6.1 Statistika për shkollat speciale


Sipas të dhënave të marra nga pyetësorët e shpërndarë në institutin e fëmijëve që nuk shikojnë dhe në institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë si dhe në shkollat speciale, numri i përgjithshëm i nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollat speciale të Shqipërisë për vitin shkollor 2011-2012 është 744.

**Grafiku nr. 9:** Raporti mes fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të zakonshme dhe fëmijëve AK që ndjekin shkollat speciale – shprehur në përqindje



46. Ndrio. M. 'E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës', World Vision 2012

**Grafiku nr. 10:** Raporti mes fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të zakonshme dhe fëmijëve AK që ndjekin shkollat speciale – shprehur në shifra



Sipas të dhënave, numrin më të madh të fëmijëve e zë kategoria e fëmijëve me aftësi të kufizuar mendore me rreth 65% të të gjithë fëmijëve.

Drejtnesit e shkollave të intervistuar vënë në dukje se numri i fëmijëve në këto shkolla ka ardhur në rritje dhe se, në dallim nga disa vite më parë, ata po vijjnë gjithmonë e më shumë nga zonat rurale ndërsa fëmijët nga zonat urbane po synojnë gjithnjë e më shumë shkollat e zakonshme ose shërbime të tjera private.

### **3.6.2 Institutet kombëtare të nxënësve që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë**

Në qytetin e Tiranës ka dy institute, respektivisht instituti i nxënësve që nuk shikojnë dhe instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë, me mesatarisht rreth 100 nxënës në secilin prej tyre. Këto janë institute kombëtare me fëmijë të verbër dhe fëmijë që nuk dëgjojnë nga i gjithë vendi. Nxënësit nga rrethet e tjera të vendit qëndrojnë gjatë gjithë kohës në këtë institut ndërsa një pjesë e nxënësve nga Tirana, me përfundimin e mësimit, kthehen pranë familjeve të tyre. Si rregull, këto shkolla ofrojnë shërbimin parashkollor dhe atë 9-vjeçar. Këto institucione kanë varësi të drejtpërdrejtë nga MAS-i dhe jo nga DAR-et.

Programi i ofruar në to është i veçantë dhe i përshtatur me nevojat dhe specifikat e aftësisë së kufizuar. Shumica e stafit është e specializuar e një pjesë e tij janë persona me aftësi të kufizuara. Programi realizohet me anë të mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme që lehtësojnë mësimnxënien për këto kategori dhe, veç të tjerash, është i përbërë nga shumë orë shtesë kryesisht për marrjen e zanateve të ndryshme.

Për t'u theksuar është edhe fakti që nxënësit e këtyre instituteve, në shumë raste, kanë protestuar edhe në media për dhunën fizike dhe psikologjike që stafi pedagogjik ka ushtruar ndaj tyre.

### **3.6.3 Infrastruktura e shkollave speciale**

Në dallim nga institutet kombëtare, shkollat speciale varen nga DAR-et e rrethëve përkatëse. Sipas të dhënave të marra nga pyetësorët, kushtet e godinave janë në përgjithësi të pranueshme. Megjithatë, vëzhgimet e kryera në terren na njohën më mirë me veçoritë e çdo shkolle.

Në përgjithësi, godinat e shkollave speciale duken të ngjashme me godinat e shkollave të zakonshme por me elementë të shtuar për lehtësimin e aksesit në to. Megjithatë, ka dallime të dukshme nga njëra shkollë në tjetrën. Kështu, shkolla speciale “Luigj Gurakuqi” në Tiranë, përveç klasave mësimore, ofron edhe mjedise të tjera të jashtme dhe të brendshme në ndihmë të fëmijëve. Mjediset e kësaj shkolle janë të aksesueshme për fëmijët, pavarësisht tipit të aftësisë së kufizuar dhe nivelit të dëmtimit. Gjithsesi, në përgjithësi shkollat speciale kanë mungesa në drejtim të infrastrukturës, hapësirave dhe lehtësisë së aksesit që nxënësit me AK kanë në to. Dallim nga kjo mesatare bën shkolla speciale e Fierit e cila nuk ofron as kushtet më minimale për arsimimin e 24 fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë këtë institucion. Hapësirat në këtë shkollë janë shumë të kufizuara, ka vetëm dy klasa në dispozicion; ka një mungesë totale të higjienës dhe bankat dhe tualetet mungojnë gjithashtu.

Shkollat speciale ofrojnë transport të përditshëm për të gjithë fëmijët, madje edhe për ata që vijnë nga zonat rurale. Megjithatë, duket se fondet e kufizuara për këtë shërbim kanë bërë që ai në disa shkolla të jetë i pjesshëm dhe i pamjaftueshëm për fëmijët e zonave rurale. Si pasojë, fëmijët në zonat rurale e kanë të vështirë të shkojnë në shkollat speciale të qytetit dhe mbeten të izoluar dhe pa asnjë shans për të ndjekur arsimin special.

### **3.6.4 Mjetet dhe pajisjet mësimore**

Mundësitë për mjete dhe pajisje mësimore në përgjithësi janë të pakta edhe pse nga shkolla në shkollë ka ndryshime. Në përgjithësi, mungojnë pajisjet ndihmëse dhe mjetet për përshtatjen e programit mësimor.

### **3.6.5 Kurrikula, programet dhe tekstet lëndore**

Shumë nga shkollat punojnë me programe që nuk janë realisht në përputhje me fokusin që këto shkolla kanë. Për fat të keq, programi arsimor për këta fëmijë nuk përfshin lëndë të dobishme si, p.sh. njohuri dhe shprehje për jetën dhe lëndë për rehabilitimin. Monitorimi evidenton domosdoshmërinë e rivlerësimit të programeve të këtyre shkollave. Të gjitha shkollat speciale kanë të njëjtën kurrikul me shkollat e zakonshme por, në këto shkolla, programi i lëndëve të çdo viti shkollor të shkollave të zakonshme shtrihet përgjatë 2 viteve shkollore.

Stafet e intervistuarat në shkollat speciale shprehen se kurrikula në shkollat speciale është një ndër vështirësitë e shumta dhe absurditetet që ata hasin në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Shumica e fëmijëve në këto shkolla nuk janë në gjendje të përmbushin as në nivele minimale kërkesat e kurrikulës aktuale. Të gjithë të intervistuarit shprehen gjithashtu se nuk kanë tekste mësimore të përshtatshme për t'u aplikuar në këto shkolla.

Mësuesit e këtyre shkollave kanë pak instrumente vlerësuese për fëmijët. Programi i individualizuar që mësuesit përshtatin për këta fëmijë është i bazuar në shprehitë e vetëndihmës dhe disa objektiva mësimorë.

### **3.6.6 Stafi arsimor në shkollat speciale**

Raporti i përgjithshëm mësues-nxënës është 1 mësues për 4 nxënës edhe pse jo gjithmonë ruhet ky raport. Në çdo klasë ka 10 deri në 12 fëmijë dhe të paktën 2 mësuese.

Pjesa më e madhe e stafit në këto shkolla nuk ka kryer studimet për arsim special. Përveç shkollës speciale të Vlorës dhe asaj të Tiranës, ku shumica e stafit ka kualifikimin e nevojshëm, në shkollat e tjera, pjesa dërrmuese e anëtarëve të stafit kanë kryer studimet në degën e mësuesisë për ciklin e ulët. Megjithatë, stafet e këtyre shkollave në përgjithësi kanë marrë trajnime specifike në fushën e pedagogjisë së specializuar.

Në shumicën e shkollave speciale mungon shërbimi mbështetës dhe specialistët e tjerë të fushës si psikologu, mjeku pediatër, logopedi etj.

### **3.6.7 Nevojat kryesore**

Si në pyetësorët e shpërndarë ashtu edhe në intervistat e kryera me stafin e shkollave speciale, në përgjithësi u shprehën këto nevoja:

- nevoja për staf të specializuar (mjekë, psikologë, logopedë)
- nevoja për bazë materiale (materiale mësimore specifike por edhe fletore, libra apo materiale higjienike)
- nevoja e përshtatjes së kurrikulës dhe botimi i teksteve mësimore të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara
- nevoja e stafit për trajnime më specifike si p.sh. trajnime për përdorimin e programeve kompjuterike specifike në dobi të nxënësve me AK)

### **3.6.8 Perceptime të stafit për rolin e shkollave speciale**

Ekipi studimor takoi një numër të konsiderueshëm drejtuesish dhe mësuesish të shkollave speciale. Në intervistat me ta u dallua se, në përgjithësi, mësuesit e perceptojnë idenë e integritit dhe gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të

kufizuara në shkolla të zakonshme si praktikë të gabuar. Tendenca e lëvizjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara drejt shkollave të zakonshme është perceptuar nga stafi si kërcënim për vendin e tyre të punës. Bashkëpunimi i shkollës speciale me atë të zakonshme thuhet se mungon e mes dy sistemeve (shkollë speciale kundrejt gjithëpërfshirëse) ka konkurrencë të heshtur pasi mësuesit e shkollave speciale nuk kanë lidhje dhe nuk bashkëpunojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara që integrohen pranë shkollave të zakonshme.

Ajo që u vu re në qytetin e Vlorës përmbledh shumë nga ky perceptim:

*“Ne si staf shkojmë në periferi të qytetit për të gjetur fëmijë me aftësi të kufizuara e për t’i regjistruar në shkollën tonë por duket e vështirë sepse shkolla si e jona kanë emër të keq e prindërit nuk duan t’i sjellin fëmijët këtu. Kjo është absurde, ne i lusim për të ardhur e nuk vijnë kurse në shkollat e zakonshme duhet të njohin njerëz që të futen se nuk është dhe aq e lehtë”*

Mësuese e shkollës speciale në Vlorë

Stafi i intervistuar mendon se këto shkolla do të jenë shumë të nevojshme edhe në të ardhmen për fëmijët me aftësi të kufizuara më të rënda pasi shkollat e zakonshme nuk do të mund të jenë të përshtatshme për këta fëmijë për një kohë shumë të gjatë.

### **3.7 Praktika pozitive në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara**

---

Ekipi i studimit, jo vetëm në analizën e pyetësorëve por edhe në intervistat e kryera si dhe vizitat në disa shkolla në rajone të ndryshme të vendit, u njoh me një numër praktikash pozitive në arsimimin e fëmijëve me AK.

#### **3.7.1 Projekti “Arsimi gjithëpërfshirës – kërkesë e mijëvjeçarit të ri”**

Në disa nga rajonet e vendit, e më konkretisht në Librazhd, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë, prej vitit 2004 aplikohet projekti “Arsimi gjithëpërfshirës si kërkesë e mijëvjeçarit të ri”, një projekt ky që vazhdon të zbatohet nga Shoqata “MEDPAK” në bashkëpunim me Save the Children dhe MAS si dhe në partneritet me Drejtoritë Arsimore të rajoneve Librazhd, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë. Projekti synon arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla gjithëpërfshirëse në rajonet Librazhd, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë.

Falë këtij projekti, gjendja arsimore e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e rajoneve të sipërpërmendura është e ndryshme krahasuar me të gjitha rajonet e tjera të vendit ku ky projekt nuk është aplikuar.

Të dhënat, nëse u referohemi rezultateve të punës së kryer në kuadrin e projekteve disaveçarë të zbatuar në rajonet e Tiranës, Korçës, Vlorës, Beratit dhe Gjirokastrës nga organizata Save the Children në bashkëpunim me Shoqatat “Ndhmoni Jetën“ dhe MEDPAK, kanë treguar se nxënësit me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në arsimin gjithëpërfshirës kanë arritje më të larta akademike, vetëvlerësim më të lartë si dhe aftësi më të mira sociale<sup>47</sup>.

Praktikat pozitive kryesore të vëzhguara në rrethet ku zbatohet projekti ishin:

- Në këto rrethe, është ngritur në DAR-et një komision i veçantë me specialistë të ndryshëm nga institucione të ndryshme (bashkia, OJF në ndihmë të familjeve) të cilët vlerësojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës dhe gjykojnë mbi nevojat e tij arsimore. Specialistët e trajnuar të këtij komisioni hartojnë një raport mbi nivelin zhvillimor të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe tipin e aftësisë së kufizuar dhe japin rekomandime për arritjen e objektivave mësimorë nga ky fëmijë.
- Në këto rajone (e veçanërisht në shkollat ku pilotohet projekti) mësuesit janë jo vetëm të ndërgjegjësuar për rëndësinë e gjithëpërfshirjes por edhe të trajnuar në hartimin e PEI-t, përshtatjen e kurrikulës etj.
- Në disa prej shkollave financohen nga vetë projekti klasat burimore si dhe mësueset ndihmëse për të punuar në mënyrë më specifike brenda shkollave gjithëpërfshirëse me fëmijët me aftësi të kufizuara.
- I gjithë komuniteti dhe klima në shkollat ku aplikohet projekti ofrojnë mbështetje në drejtim të një arsimimi cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuar (nxënësit e tjerë mbështesin dhe mirëpresin fëmijët me aftësi të kufizuar, prindërit e fëmijëve të tjerë janë në përgjithësi mbështetës, qeveritë e nxënësve kanë kryer aktivitete të cilat kanë promovuar të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke përfshirë në këto aktivitete edhe fëmijët me aftësi të kufizuara etj.)

### **3.7.2 Projekte dhe nisma të tjera**

Gjatë intervistave dhe vëzhgimeve në qytetin e Tiranës, ende ndihej jehona pozitive e projektit “Fëmijë me Aftësi të Kufizuara në Arsimin Gjithëpërfshirës” (një tjetër projekt i Save the Children dhe MAS) i cili, në kohën e aplikimit të tij (2003-2009), synonte gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në 10 kopshte dhe 10 shkolla në qytetin e Tiranës.

Pavarësisht se këto kopshte dhe shkolla nuk mbështeteshin më nga projekti, disa nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve që intervistuaam u shprehën se:

- Kopshtet dhe shkollat e pilotuara në qytet dallojnë për frymën mikpritëse

---

47. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm, Raport i hartuar për Save the Children Shqipëri, Ma. Merita Poni, Tiranë, Prill 2010



dhe praktikat pozitive të punës me fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre duke vazhduar të përfshijnë një numër gjithnjë e më të madh fëmijësh me aftësi të kufizuar.

- Mësuesit e mbështetur nga projekti me anë të trajnimeve dhe mjeteve të tjera ende vazhdojnë të punojnë cilësisht me fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Modelet e punës, materialet dhe formatet mësimore si dhe praktikat e tjera në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në përgjithësi vazhdojnë ende të ruhen, edhe pse jo me cilësinë e mëparshme.

Në kuadër të projekteve të mësipërme, Save the Children ka mbështetur identifikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara duke përdorur metodën “Portage”<sup>48</sup>. Mësuesit e arsimit parashkollor të trajnuar për të përdorur këtë metodë kanë shërbyer si vizitorë në familjet e këtyre fëmijëve duke ndihmuar drejtpërdrejt zhvillimin e tyre për t’i përgatitur të hyjnë në mjediset shkollore e parashkollore.

Këto nisma kanë bërë të mundur ndër vite përfshirjen e rreth 400 fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë arsimuar dhe arsimohen në mjediset e 34 kopshteve dhe 34 shkollave të projektit. Një numër prej 600 profesionistësh ku përfshihen mësues, specialistë të DAR/ZA-ve dhe psikologë shkollore janë trajnuar për të punuar me këta fëmijë në klasë<sup>49</sup>. Një seri botimesh kanë shpërndarë përvojat më të mira ndër rajonet, shkollat dhe kopshtet e përfshira në projekt.

Edhe Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit të Beratit, që nga viti 2004, përmes një projekti në bashkëpunim me Save the Children, ka mbështetur fuqimisht procesin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet e shkollat e këtij qyteti.

Kryesisht në Tiranë por edhe në rajone të tjera, organizata lokale dhe ndërkombëtare kanë aplikuar dhe aplikojnë projekte në drejtim të arsimit integruar ose gjithëpërfshirës, në shumicën e rasteve vetëm për kategori të caktuara të aftësisë së kufizuar. Ndër to veçojmë një projekt për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në të parë, të realizuar në Tiranë nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë në bashkëpunim me MAS-in<sup>50</sup>.

Po ashtu, në kuadër të projektit “Shansi i Dytë”, një projekt i zbatuar në të gjithë vendin, i cili synon arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën, kryesisht atyre romë, MAS ka mundësuar për disa fëmijë me aftësi të kufizuara të rënduara që një mësuese të shkojë dhe të zhvillojë mësim në shtëpinë e tyre. Megjithatë, nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar që kanë përfutur

---

48. [http://www.scalbania.org/pdf/School\\_for\\_all.pdf](http://www.scalbania.org/pdf/School_for_all.pdf)

49. [http://www.scalbania.org/pdf/School\\_for\\_all.pdf](http://www.scalbania.org/pdf/School_for_all.pdf) (fq. 8)

50. Për më shumë shih [http://wvi.org/sites/default/files/Raport\\_Rajonal\\_I\\_Alb\\_Web.pdf](http://wvi.org/sites/default/files/Raport_Rajonal_I_Alb_Web.pdf)

falë këtij projekti.

Një tjetër projekt vullnetar për t'u përshëndetur është projekti që po realizohet nga vullnetarë të organizatës World Vision të cilët po shkojnë shtëpi më shtëpi në zonat rurale të rrethit të Elbasanit për të gjetur familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe për t'i nxitur ato të arsimojnë fëmijët në shkollat e qytetit.

Në saje të shumë projekteve dhe nismave të ndryshme që MAS ka mbështetur, janë evidentuar shumë elementë të tjerë pozitivë në ndërtimin e një klime gjithëpërfshirëse:

- Ndër vite, janë rritur e zgjeruar kapacitetet e një pjese të konsiderueshme të mësuesve, drejtuesve të shkollave dhe personelit të DAR/ZA-ve nëpërmjet aktiviteteve trajnuese me tematikë mësimdhënien me në qendër nxënësin, konceptin e arsimit gjithëpërfshirës dhe mbështetjen konkrete që duhet t'u jepet fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimimin e tyre.
- Në vite, një numër i madh prindërisht, mësuesesh të shkollave dhe kopshteve dhe komunitetesh shkollore në përgjithësi janë përfshirë në aktivitetet e ndërgjegjësimit lidhur me të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës e cilësor.
- Personeli i DAR/ZA-ve, në përgjithësi, ka qenë aktiv në përmirësimin e modelit të arsimit gjithëpërfshirës në rajonet përkatëse, monitorimin në vazhdimësi të rezultateve të punës shumëvjeçare ndër fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe matjen e ndikimit që ka pasur zbatimi i arsimit gjithëpërfshirës edhe te fëmijët e tjerë.
- Falë bashkëpunimit institucional me MAS-in, modeli i arsimit gjithëpërfshirës i krijuar në projektin "Arsimi Gjithëpërfshirës" të financuar nga Save the Children dhe të zbatuar nga MEDPAK është promovuar në nivel kombëtar nëpërmjet trajnimeve, tryezave të rrumbullakëta, konferencave, udhëzimeve e shkresave zyrtare.
- Një numër i konsiderueshëm udhëzuesish janë botuar dhe shpërndarë falas në ndihmë të punonjësve të arsimit, prindërve dhe profesionistëve të tjerë të fushës.

### **3.7.3 Gjurmë të paharrueshme**

Gjatë mbledhjes së të dhënave në terren, ekipi kërkimor pati mundësinë të njihte shumë njerëz vizioni, frymëzimi dhe puna e të cilëve në drejtim të të drejtave arsimore dhe gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë lënë gjurmë. Ne u njohëm me:

- Fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët, pavarësisht vështirësive, bëjnë përpjekje të mëdha duke habitur me arritjet e tyre edhe personat më skeptikë ndaj fuqisë së filozofisë gjithëpërfshirëse.
- Prindër dhe përfaqësues të komuniteteve frymëzimi, përkushtimi dhe

- sakrifica e të cilëve është mahnitëse.
- Mësues të cilët, pavarësisht kushteve të vështira dhe mungesës së njohurive e trajnimeve, kanë punuar e ndërtuar përvoja të suksesshme me fëmijët me aftësi të kufizuara falë dashurisë për punën dhe profesionin në përgjithësi dhe në emër të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në veçanti.
  - Disa drejtues të MAS, DAR/ZA-ve dhe shkollave, specialistë e psikologë të cilët kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në promovimin dhe zbatimin e të drejtës së fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.
  - Përfaqësues të organizatave të ndryshme jo vetëm me vizionin e nevojshëm por edhe me aftësitë e përvojën e duhur për ta bërë gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të ardhmen një realitet në të gjithë vendin.

## 4. Rekomandime dhe Sugjerime

Rekomandimet e mëposhtme u jepen të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin arsimor në të gjitha nivelet, nga ai qendror në atë lokal e deri në nivel shkolle. Pjesa më e madhe e rekomandimeve i drejtohen MAS-it si institucioni kyç në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; megjithatë, ato përfshijnë në mënyrë koncize të gjitha institucionet, organizatat dhe individët përgjegjës për arsimimin e personave me aftësi të kufizuara.

### **4.1 Rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës**

**Të rishikojë dhe miratojë aktet dhe dokumentet e nevojshme për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara**

Në bashkëpunim me një sërë institucionesh dhe organizatash që punojnë në fushën e AK, MAS-i duhet të hartojë dhe miratojë një sërë aktesh nënligjore dhe dokumentesh për zbatimin e ligjit të ri për Arsimin Parauniversitar:

- *Të hartojë dhe miratojë Dispozitat Normative në përputhje me kërkesat e ligjit të ri për Arsimin Parauniversitar (duke bërë kujdes që DN të mos lenë vend për interpretime të dyfishta në çështjet e zbatimit të ligjit të ri. Është e nevojshme që këto dispozita të qartësojnë të gjitha çështjet që më parë janë kthyer në burim konflikti mes palëve).*
- Të hartojë strategji dhe një plan veprimi afatgjatë dhe specifik për përfshirjen e fëmijëve me AK në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të vendit (veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale).
- Të hartojë dhe miratojë dokumente që rrjedhin nga zbatimi i ligjit të ri si manuale procedurash për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, standarde për klasat gjithëpërfshirëse e dokumente të tjerë të nevojshëm.
- Të përmirësojë të gjitha formatet dhe dokumentet (p.sh. dëftesën përfundimtare, regjistrin, dosjet e fëmijës me AK etj.) në mënyrë të tillë që ato të reflektojnë punën dhe zhvillimin e fëmijës me AK gjatë viteve shkollore.
- Të zhvillojë politika për parandalimin e izolimit dhe veçimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar si dhe të zhvillojë mekanizmat e nevojshëm për mbrojtjen e këtyre kategorive nga diskriminimi.

## **Të riorganizojë strukturat dhe burimet njerëzore (të MAS-it dhe institucioneve në varësi të tij)**

- Të planifikojë dhe krijojë një strukturë/njësi të veçantë për monitorimin dhe koordinimin e punës për përfshirjen e nxënësve me AK në kopshtet dhe shkollat e vendit. Kjo strukturë duhet të ketë në fokus jo vetëm kopshtet dhe shkollat publike por edhe ato private.
- Institucionet kombëtare në varësi të MAS-it (IKAP dhe IZHA), përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e punës në të gjitha kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare të vendit, duhet të përfshijnë në strukturën e tyre specialistë të fushës, përgjegjësia e të cilëve të jetë e fokusuar vetëm në monitorimin dhe mbështetjen e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në kopshtet dhe shkollat e zakonshme.
- Të planifikojë përfshirjen në strukturën e DAR-eve dhe ZA-ve të specialistëve me përvojë dhe të mirëtrajnuar në fushën e gjithëpërfshirjes të cilët të mbështesin dhe monitorojnë përfshirjen e fëmijëve me AK në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të rretheve përkatëse (fillimisht në DAR-et e më pas në ZA-të kryesore, sipas planit të veprimit).
- Të emërojë mësuese ndihmëse, fillimisht në shkollat ku numri i nxënësve me aftësi të kufizuara është mbi 3, duke u dhënë prioritet shkollave të mëdha dhe të pilotuara për modelin e gjithëpërfshirjes. Në mungesë të fondeve të mjaftueshme, MAS mund të marrë në konsideratë edhe futjen e mësuesve ndihmës vullnetarë (apo burime të tjera të ngjashme) për të cilët mund të gjejë forma të ndryshme motivimi dhe vlerësimi.
- Të inkurajojë persona me aftësi të kufizuara dhe individë të tjerë të kualifikuar të aplikojnë për pozicione në fushën e arsimit duke bërë akomodimet e nevojshme për ta.
- Të krijojë këshille, komisione dhe struktura të përbashkëta me ministrinë e tjera dhe organet e pushtetit lokal me qëllim:
  - ✓ Bashkërendimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke vënë në qendër të këtyre shërbimeve shkollën gjithëpërfshirëse.
  - ✓ Hartimin dhe zbatimin e planeve të përbashkëta që lidhen me shërbimet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.
  - ✓ Zhvillimin e sistemeve të përbashkëta të monitorimit dhe informacionit si dhe ngritjen e mekanizmave të nevojshëm në mënyrë që informacioni i gjeneruar nëpërmjet monitorimit të përdoret për rishikim dhe planifikim në të ardhmen.

- ✓ Ndërmarrjen e fushatave të ndërgjegjësimit mbi të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim, të drejtën për mosdiskriminim dhe të drejta të tjera, duke synuar arritjen e të gjithë publikut në përgjithësi dhe të personave përgjegjësia e të cilëve lidhet me të drejtën për arsim të fëmijëve me AK në veçanti.
- ✓ Përshtatjen e standardeve kombëtare të aksesit dhe sigurisë në shkollat gjithëpërfshirëse.
- ✓ Krijimin e urave lidhëse mes shërbimeve të ndërhyrjes së hershme dhe kopshteve e shkollave për të lehtësuar hyrjen e fëmijëve me AK në këto institucione dhe kalimin nga një institucion te tjetri si dhe përfshirjen e hershme në arsimin parashkollor të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- ✓ Trajnimin dhe informimin e punonjësve të shëndetësisë, bashkive dhe komunave mbi respektimin e të drejtave dhe dinjitetin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

#### **Të bashkërendojë punën me Institutin e Zhvillimit të Arsimit që:**

- Të zhvillojë programe fleksibël dhe procedura metodologjike dhe të modelojë strategji e metoda cilësore dhe efikase.
- Të përmirësojë transkriptin, prodhimin dhe shpërndarjen e teksteve në Braille dhe të librave me shkronja të mëdha si dhe të mundësojë përdorimin e informacionit dhe teknologjive komunikuese.
- Të sigurojë tekste alternative dhe standarde alternative të arritjes lëndore për këta nxënës.
- Të hartojë ose rishikojë programet për identifikimin dhe ndërhyrjen e hershme që janë në përputhje me qasjen e arsimit gjithëpërfshirës dhe të bëjë hapat e nevojshëm për të siguruar akses për fëmijët me aftësi të kufizuara në programet parashkollore.

#### **Të bashkërendojë punën me Komisionin e Akreditimit të Trajnimeve dhe institucionet e tjera në varësi të saj që:**

- Të rishikojë materialet dhe modulet e trajnimit në mënyrë që ato të reflektojnë metoda arsimore gjithëpërfshirëse si dhe informacionin e nevojshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Të trajnojë të gjithë mësuesit, drejtuesit e shkollave, edukatorët dhe punonjësit e tjerë që shërbejnë në shkolla mbi metodat e arsimit

gjithëpërfshirës, duke përfshirë këtu edhe çështje apo aftësi të tilla si njohja e gjuhës së shenjave, mënyrat e menaxhimit të bulizmit, talljes apo trajtimeve të ngjashme diskriminuese dhe degraduese ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, menaxhimi i sjelljes së fëmijëve me aftësi të kufizuara etj.

Në trajnimin bazë të mësuesve, duhet të përfshihen patjetër edhe tema të tilla si:

- ✓ Mësimdhënia me në qendër nxënësin (duke theksuar mësimdhënien bashkëpunuese, punën në grupe të mëdha e të vogla, të nxënimit aktiv etj.).
- ✓ Marrja e njohurive mbi mënyrën e menaxhimit të sjelljes së fëmijëve me aftësi të kufizuara e në veçanti mbi teknikat e punës për menaxhimin e sjelljes së fëmijëve me autizëm, hiperaktivitet dhe prapambetje mendore.
- ✓ Marrja e njohurive dhe plotësimi i nevojës për ekspertizë në planifikimin dhe ndërtimin e planeve të individualizuara.
- ✓ Njohja e teknikave pedagogjike për të diferencuar dhe përshtatur mësimdhënien për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- ✓ Njohja e teknologjisë ndihmëse dhe e programeve të veçanta si p.sh. njohja e gjuhës së shenjave apo e alfabetit Braille.

Tema të tjera më specifike me interes për mësuesit do të ishin:

- ✓ Hartimi dhe administrimi i testeve individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara bazuar në aftësitë e tyre specifike dhe nivelin e arritjeve të tyre akademike.
  - ✓ Ndihma e shpejtë dhe menaxhimi i situatave emergjente (p.sh. për një nxënës me epilepsi).
  - ✓ Organizimi i klasave me në qendër nxënësin, sidomos për mësuesit e ciklit të lartë të arsimit të detyruar ku kurrikula është më e ngurtë e ku shumica e nxënësve me AK fillojnë të dështojnë.
  - ✓ Puna në grup me psikologët e shkollave dhe prindërit.
  - ✓ Ndihma dhe planifikimi i punës për përfshirjen e fëmijëve të tjerë në klasë dhe në aktivitetet jashtë saj.
- Të hartojë plane veprimi të shoqëruara me fondet përkatëse për të mbështetur në mënyrë cilësore dhe të menjëhershme trajnimin e mësuesve,

drejtuesve të shkollave, psikologëve, punonjësve socialë dhe prindërve të fëmijëve me AK.

- Të mundësojë trajnime në fushën e këshillimit për mësuesit, drejtuesit dhe psikologët, në çdo rajon të vendit, për t'i aftësuar ata në mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të ndryshme dhe familjeve të tyre.
- Të mundësojë trajnime dhe të mbështesë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**Të nxisë dhe mbështesë universitetet që përgatisin mësuesit e rinj (dhe profesionistët e tjerë që do të punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara):**

- Të rishikojë dhe përmirësojë kurrikulat dhe programet lëndore të përgatitjes së mësuesve dhe specialistëve të tjerë të edukimit për t'i pajisur ata me njohuritë, aftësitë dhe praktikat më bashkëkohore në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.
- Të rishikojë praktikat mësimore në mënyrë që të gjithë mësuesit e ardhshëm të kenë mundësi të shohin dhe të zbatojnë në terren praktikat gjithëpërfshirëse.
- Të trajnojë stafet akademike për njohjen dhe aplikimin e kurrikulave dhe praktikave gjithëpërfshirëse bashkëkohore.
- Të pajisë mësuesit e ardhshëm me njohuritë e nevojshme për kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore në fushën e gjithëpërfshirjes.

**Të mbështesë dhe nxisë Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore që:**

- Të kualifikojnë dhe trajnojnë të gjithë stafet e tyre për t'i njohur ata me filozofinë dhe praktikat gjithëpërfshirëse si dhe t'u bëjnë atyre të qartë rolin monitorues dhe mbështetës që kanë në këtë proces.
- Të njohin termat dhe kategoritë e aftësisë së kufizuar për të hartuar një bazë cilësore dhe të besueshme të dhënash mbi fëmijët me AK.
- Të parashikojnë fonde për kualifikimin e mësuesve dhe rritjen e cilësisë së punës së tyre me fëmijët AK dhe për përgatitjen e literaturës ndihmëse dhe udhëzuesve praktikë që sigurojnë procesin gjithëpërfshirës.
- Të sensibilizojnë mësuesit lidhur me rëndësinë e procesit gjithëpërfshirës.



- Të sigurojnë që vlerësimi i performancës së mësuesve në çdo rajon të përfshijë indikatorë që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës.

**Të përmirësojë infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave për të mundësuar aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe agjenci të tjera)**

- Të zbatojë standardin e ndërtimit të godinave të përshtatshme për nxënësit me AK në mënyrë që këta nxënës të kenë akses të plotë në të gjitha mjediset e shkollës, pavarësisht tipit të aftësisë së kufizuar apo nivelit të dëmtimit.
- Meqenëse MAS-i nuk disponon një instrument të veçantë për vlerësimin e aplikimit të standardeve ndërkombëtare të ndërtimit të godinave të kopshteve dhe shkollave për fëmijët me AK, fillimisht duhet të përgatitet ky instrument e më pas të përdoret si vlerësues cilësie nga institucionet monitoruese.
- Të ruajë dhe pasurojë klasat burimore ekzistuese duke i përdorur si modele për ndërtimin e klasave të ngjashme në shkolla të tjera të vendit. Të hapë klasa të reja burimore, duke filluar nga shkollat ku numri i nxënësve me AK është më i madh, bazuar në modele tashmë të aplikuara me sukses në vendin tonë.
- Të pajisë me mjetet e domosdoshme për arsimimin e nxënësve me AK të gjitha shkollat, duke filluar nga shkollat pilot.
- Të planifikojë në kohë pajisjen e shkollave pilot me teknologjinë dhe programet në ndihmë të lehtësimit të procesit të të nxënit për çdo kategori të aftësisë së kufizuar duke përfshirë edhe pajisjet Braille, programet kompjuterike etj.
- Të sigurojë mjete transporti dhe kushtet më të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara me prioritet zonat rurale.
- Në fushën e sigurimit të cilësisë, të përcaktojë indikatorët për vlerësimin e kushteve të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme.
- Të gjejë rrugët për uljen e numrit të nxënësve për klasë dhe të ulë numrin me të paktën 4 fëmijë për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara.

## **Të ndërmarrë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit**

- Të nxisë dhe planifikojë fushata ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë dhe të kuptuarin e arsimit gjithëpërfshirës. Duke qenë se ndërgjegjësimi i prindërve dhe i komunitetit në vend nuk është në nivelet e dëshiruara, këto fushata informuese duhet të synojnë arritjen e prindërve, familjeve dhe komunitetit të gjerë por edhe të institucioneve të tjera të shoqërisë.
- Të botojë materiale të thjeshta dhe praktike në mënyrë periodike në ndihmë të njohjes së konceptit të gjithëpërfshirjes dhe qasjes gjithëpërfshirëse nga ana e mësuesve, prindërve dhe komunitetit.
- Të zbatojë një fushatë informuese në shkolla duke theksuar:
  - ✓ Natyrën e arsimit gjithëpërfshirës
  - ✓ Keqkuptimet në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës
  - ✓ Barrierat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara
  - ✓ Njohjen me legjislacionin që garanton të drejtën e fëmijëve me AK për arsim gjithëpërfshirës

## **Të ndërtojë dhe mbështesë komisionet e vlerësimit pranë DAR-eve**

- Të ndërtojë komisionet e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara me ekspertë të fushave të ndryshme në të gjitha DAR-et ku ato ende nuk janë të pranishme dhe të konsolidojë më tej ato ekzistuese.
- Të ofrojë trajnim cilësor për secilin anëtar të komisionit mbi rolin dhe përgjegjësitë e tij si dhe mbi modelet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
- Të pajisë çdo komision me instrumentet dhe mjetet e nevojshme për një vlerësim objektiv (teste vlerësimi specifike, sistemin e vlerësimit ICF etj.).
- Të marrë masa që vlerësimet e kryera nga ky komision të fokusohen te ndihma ndaj mësuesve.
- Të garantojë që prindi të jetë i përfshirë aktivisht në çdo hap të procesit të vlerësimit. Komisioni duhet të ofrojë informim etik jo vetëm për familjet por edhe për kopshtet e shkollat.
- Të monitorojë procesin e vlerësimit që kryhet nga komisionet e vlerësimit.

## **Të japë mbështetje për ndërtimin e Planeve Edukative Individuale cilësore**

1. Formatet e planeve individuale duhet të njësohen dhe miratohen nga MAS-i. Me mjaft rëndësi është që në PEI të përshkruhen përshtatjet e kryera, gjë që është e nevojshme për matjen e arritjeve akademike dhe performancës funksionale.
2. Duhet të ndërtohen formularë të standardizuar për PEI-t si dhe manuale praktike udhëzuese që sqarojnë mënyrën e përdorimit të tyre në të gjitha nivelet e shkollës.
3. PEI-t duhet të ndërtohen nga ekipi multidisiplinar i ngritur në shkollë në përbërje të të cilit ka psikologë, mësues dhe prindër.
4. Duhet të bëhet kujdes që në procesin e ndërtimit të PEI-t të jenë pjesëmarrës edhe vetë fëmija me AK dhe prindërit e tij.
5. Vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara duhet të kryhet në bazë të kërkesave dhe objektivave të përcaktuar në planin edukativ të individualizuar dhe ecurisë individuale të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe jo me kritere të njëjta me nxënësit e tjerë në klasë. Edhe provimet e planifikuara ose zyrtare duhet të përshtaten me nivelin dhe kërkesat e PEI-t dhe nxënësi me AK duhet të vlerësohet në bazë të performancës për nivelin e tij.
6. PEI duhet të monitorohet dhe rishikohet në mënyrë periodike.

## **Të fillojë konvertimin e shkollave speciale në qendra burimore**

- Arsimi gjithëpërfshirës pa qendrat burimore krijon shqetësim për rajonet të cilat kanë një numër të madh fëmijësh me AK. Në shumë vende, termi “qendra burimore” është ndryshuar në “qendrat e kompetencës”. Përmes rrjetit ose ndërtimit të departamenteve (mjekësore, psikologjike, terapeutike etj.), qendrat burimore kanë zgjeruar bazat e tyre në mënyrë që të mbulojnë të gjitha nevojat e nxënësve.

Për këtë arsye MAS-i duhet të:

- zhvillojë role të reja për shkollat speciale duke i konvertuar ato në qendra burimore me një diapazon të gjerë funksionesh në dobi të mbështetjes së arsimimit të fëmijëve me AK.
- të caktojë, fillimisht në formë pilotimi, shkollat që duhet të funksionojnë si qendra burimore në të gjitha rajonet kryesore të vendit duke marrë për bazë modele tashmë të pilotuara në disa rajone të vendit nga organizatat që veprojnë në bashkëpunim me të.

### **Të zhvillojë një model të ri financimi**

- Të zhvillojë një model financimi i cili të lejojë zhvillimin e modelit gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit.
- Të mundësojë forma të veçanta të mbështetjes financiare për kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar në kopshte dhe shkolla.

### **Të mbështesë dhe zgjerojë praktikat më të mira të gjithëpërfshirjes**

- Arsimi gjithëpërfshirës ka disa vite që pilotohet suksesshëm në disa rajone të vendit. Projektet e arsimit gjithëpërfshirës janë vlerësuar pozitivisht për të gjitha objektivat e synuara. Fëmijët me AK të përfshirë në kopshtet dhe shkollat gjithëpërfshirëse kanë arritje më të larta akademike, vetëvlerësim më të lartë dhe aftësi më të mira sociale. Kjo përvojë e mbledhur gjatë viteve ka krijuar atë që mund të quhet edhe modeli shqiptar i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. MAS këshillohet të mbështesë këtë model shqiptar të gjithëpërfshirjes dhe zgjerimin e tij në rajone të tjera të vendit.

### **Rekomandime të tjera për MAS**

- Të nxisë, motivojë dhe monitorojë arsimin privat në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara (p.sh. duke i reduktuar taksat, duke i renditur më lart në rankimin e shkollave ato shkolla që pranojnë të regjistrojnë fëmijë me AK, duke i monitoruar shkollat private po aq sa ato publike etj.)
- Të mbledhë të dhëna mbi regjistrimin, braktisjen dhe kalimin e klasës nga fëmijët me aftësi të kufizuara duke i përfshirë në sistemin informatik të të dhënave dhe të specifikojë në këto të dhëna aftësinë e kufizuar dhe gjininë.
- Të përforcojë dhe rregullojë monitorimin e shkollave, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal, duke përfshirë edhe shkollat speciale e klasat burimore.
- Të mbështesë pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre në konsultime dhe procese të tjera vendimmarrëse dhe monitoruese. Të zhvillojë strategji për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit dhe familjeve në bordet e shkollave dhe qendrat rajonale të vlerësimit.

## 4.2 Rekomandime për shkollat

---

### Shkolla duhet:

- Të kryejë monitorime dhe vlerësime të brendshme periodike për një analizë të situatës së saj dhe për ndërtimin e planit të punës për vitin shkollor pasardhës.
- Të përfshijë në vetëvlerësimin e saj identifikimin e problemeve, analizën e tyre, zgjedhjen e strategjive të përshtatshme, planifikimin dhe monitorimin e punës. Pjesë e këtij monitorimi në nivel shkolle duhet të jetë edhe ecuria e nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Të decentralizohet në lidhje me vendimmarrjen dhe menaxhimin, proces me anë të të cilit mundësohet rritja e cilësisë së shërbimit në shkolla për fëmijët me AK.
- Të sigurohet se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë akses në të gjitha mjediset dhe se klima e saj është mikpritëse për ta. Aksesit mund të përmirësohet duke bërë modifikime të vogla në strukturën fizike të shkollave. Godina, klasat, libraria, tualetet dhe korridoret duhet të ndërtohen e restaurohen duke marrë në konsideratë fëmijët me aftësi të kufizuara. Duhet të theksohet se këto ndryshime janë vetëm fillimi.
- Të sigurohet që mjedisi i saj të jetë miqësor për këta fëmijë dhe stafi mbështetës dhe mirëkuptues.
- Të marrë masat për menaxhimin e momenteve transitore të fëmijëve me AK (p.sh. kalimin nga një mjedis në një tjetër) duke i dhënë rëndësi maksimale fillimit të shkollës dhe të gjitha momenteve të tjera të vështira të fëmijës në shkollë.
- Të sigurohet që fëmijët me AK janë të mirëpërfaqësuar dhe mbrojnë të drejtat e tyre në organe të tilla si qeveria e nxënësve.
- Të informojë dhe trajtojë të gjithë stafin dhe nxënësit e saj për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë.
- Të bëjë çdo vit trajnimin e mësuesve të rinj dhe riorientimin e mësuesve të vjetër mbi gjithëpërfshirjen dhe arsimin cilësor.
- Të marrë masat për ndërtimin e mekanizmave dhe krijimin e mundësive për ankimim të prindërve dhe fëmijëve me AK.
- Të marrë masa për parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit me

aftësi të kufizuara.

- Të sigurohet se prindërit janë të mirëpritur dhe janë pjesë e gjithë procedurave monitoruese dhe vlerësuese të saj si dhe e vendimeve për arsimimin e fëmijëve me AK.
- Të përfshijë prindërit në:
  - ✓ Dhënien e informacionit
  - ✓ Pjesëmarrjen në aktivitete
  - ✓ Pjesëmarrjen në dialog dhe shkëmbim këndvështrimesh
  - ✓ Pjesëmarrjen në vendimmarrje
  - ✓ Marrjen e përgjegjësisë për të vepruar

## REFERENCAT KRYESORE

---

1. Albanian Disability Rights Foundation and AMShC, The Implementation of the Action Plan of the National Strategy on People with Disabilities in 2010: Monitoring Report, May 2011
2. Booth, Tony dhe Mel Ainscow, Index for Inclusion: Developing Learning and Participation in Schools, CSIE, Bristol, revised edition 2002.
3. Closs, A., Nano, V. dhe Ikononi, E. "Unë jam si ju" Botim i Save the Children. Tiranë, 2003
4. Dethilleul, Y., Hoxha, A., Llambi, S., Gjermani, L., Kokomeri, I & Kita, L. (2000) Albania: Issues and Challenges in Education Governance. Tirana: World Bank
5. Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar, 2002
6. Ikononi Estevan, "Hartimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve për arsimim gjithëpërfshirës" 2010
7. Ligji Nr. 69/2012, Për arsimin Parauniversitar. 2012
8. Nano, V. Shkolla Shqiptare Drejt Proceseve Integruese. Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Tiranë, 2002
9. MAS. "Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2008-2013" (2004)
10. Ndrio, M. "Vlerësimi faktorëve që kontribuojnë në zbatimin praktik të arsimit gjithëpërfshirës" World Vision, Tiranë 2012.
11. Plani i Integruar i Ministrisë së Arsimit, 2010
12. Staub D. & Peck, C.A. 1994 "Four portraits of friendship at an inclusive school", Journal of the Association for Persons with Severe Handicaps 19, 314-325
13. Zela Koka, MA. Valentina Haxhiymeri, Dr. Marita Nika Flagler, Fatmir Bezati "Efektiviteti i zbatimit të kuadrit ligjor që garanton edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kushtet e arsimit gjithëpërfshirës". Raport Studimor. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me mbështetjen dhe në Bashkëpunim me Save the Children Albania, Tiranë, mars 2005
14. UNICEF, Innocenti Research Centre (2005). Children and disability in transition in CEE/CIS and Baltic states.

